

Nëntor 2019
Numri: 140
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

RINDËRRTIMI I MENDIMIT




revistaetika



progresibotime

E çfarë mund të jetë tjetër
qëndrimi indiferent,
pandjenja dhe injorant përballë
mrekullive të pafundme
madhështore, që prej
grimcës më të vogël, e deri tek
trupi më i madh, prej botës
mikro, e deri në atë makro,
të cilat ndriçojnë më së miri
mendjen dhe zemrën,
përveçse një çoroditje
dhe falimentim i mendjes!?



Profeti (a.s.), thotë:

“Ditën e Kiametit asnjë rob
nuk do të bëjë qoftë edhe një hap
pa u pyetur se ku e ka kaluar jetën
e tij, se çfarë ka bërë me dijen e
tij, se ku e ka (tuar dhe shpenzuar
pasurinë e tij dhe se ku e ka
konsumuar trupin e tij.” (Tirmidhi,

Kiamet, 1/2417)

“Allahu i Madhëruar e do të riun e
pjekur, që nuk sillet si fëmijë, që
është drejtuar kah e mira dhe ka
braktisur dëshirat e kënaqësitë (e
ulëta të egos).” (Ahmed, IV, 151.)



Çdo lajm që zbret në këtë botë nga Allahu i Lartësuar, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, është një “Lajm i Madh”. Ai formon dallgë në botën mentale të njerëzve. Së pari habi, pastaj mahnitje, pastaj mendim, pastaj, pastaj, pastaj... Çfarë duhet të bëjmë? Mos vallë duhet ta pranojmë? Apo duhet ta përgëneshetrojmë? Mos vallë duhet ta nënvlerësojmë? Mos vallë duhet ta zhdukim atë që e sjell këtë mesazh? Mos vallë duhet ta pengojmë apo duhet ta ndihmojmë atë?

Kjo gjendje hutimi në të cilën kanë rënë shumë njerëz kundrejt këtij “Lajmi të Madh” që vjen nga Zoti, tregohet kështu në Kuranin Fisnik:

“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh rreth të cilit ata kanë kundërshtime. Ani, shpejt do ta marrin vesh! Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!” (Nebe, 1-5)

Shpallja hyjnore së pari po e lëkundte njerëzimin me reformimin e mentalitetit. Kjo shpallje duke përdorur një metodë marramendëse po u jepte goditje të forta kallëpeve të mentalitetit të trashëguar nga kultura e etërve dhe formuar nga dëshirat e shfrenuara e të degraduara të nefseve. Shpallja hyjnore po e shkatërronte këtë mentalitet dhe po ndërtonte mentalitetin e duhur. Shpallja hyjnore së pari e hetonte çdo lloj mendimi që nuk përputhej me bazën e fortë të dijes, perceptimit dhe të vërtetës pothuajse në të gjitha fushat e jetës. Pas këtij hetimi, të gjitha mendimeve të humbura, të pavërteta dhe të pakuptimta ua nxirrte fytyrën e vërtetë në pah. Pastaj në vend të këtyre mendimeve ndërtonte përjasje që u kishte hije nderit dhe fisnikërisë së njeriut.

Riparimi i mentalitetit së pari bëhej në përjasjen ndaj Zotit. “La ilahe il-lallah”, domethënë, “nuk ka zot tjetër përveç Allahut” shprehte të vërtetën se të gjitha gjërat që politeistët i quanin zota, të cilat nuk ishin të vërteta, të cilat nuk kishin kuptim dhe nuk kishin asnjë gjë të përbashkët me Zotin, përbëheshin vetëm nga emërtimet. Si mund të jetë zot që e meriton adhurimin një qenie që nuk mund t’i bëjë as dobi, as dëm qoftë edhe vetes? A mund të jetë krijues një gjë që është e krijuar? Nëse formoni zota ndërmjetës që t’ju afrojnë te Allahu duke e menduar Allahun shumë larg edhe pse Ai i ka krijuar qiejt dhe tokën, atëherë dijeni këtë se Allahu është shumë afër. Andaj, Ai nuk ka nevojë për asnjë ndërmjetës për ta dëgjuar lutjen tuaj. Nëse i shenjtëroni dhe i merrni për zota engjëjt, pejgamberët, dijetarët dhe njerëzit e nderuar me mendimin për të pasur disa ndërmjetësues ngaqë frikësoheni prej ndëshkimit dhe dënimit të Allahut Teala, atëherë dijeni se edhe ky mendim i juaji është i gabuar/i humbur, sepse pa dhënë leje Allahu (xh.xh.), nuk bëhet fjalë që dikush të ketë të drejtë për të ndërmjetësuar. Prandaj, hiqni dorë edhe nga këto mendime të humbura e të pabaza dhe mos pranoni për zot askënd përveç Allahut të Lartësuar i Cili është i Mëshirshmi, Mëshirëploti, i Cili ka fuqi për çdo gjë dhe i Cili kurrë nuk ka ortak.

Nëntor 2019

VITI: XIII

NUMRI: 140

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja




10 Rruga e drejtë në mentalitet
Doç. dr. Adem Ergyl



34 Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash



14



28 Safuan ibn Assali (r.a.)
Mustafa Erish

- 5 Riparimi i mentalitetit**
Ahmet Tashgetiren
- 12 Detyra dhe qëllimi**
Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan
- 14 Feja është opium apo aksion?**
Ali Riza Temel
- 18 Mirësia në të dyja botët**
Xhafer Durmush
- 20 Dhuratat reciproke**
Shemsedin Kërësh
- 22 Roli social i adhurimeve në Islam**
Ma. Fatmir Hadri
- 25 Si i shohim ngjarjet dhe jetën?**
Ajsel Gyren
- 31 Gjuha e të dërguarve të Allahut**
Nuredin Jëlldëz
- 32 Një Ajet - Një Hadith**



20

- El-Hafidh** 42
Ilir Hoxha
- Kara Murat Pasha** 44
Dr. Ardian Muhaj
- Je i lodhur, e di** 48
Neslihan Nurturk
- Porositë e profetit** 50
Ferit Piku
- Pajtimi ndërmjet besimtarëve** 53
M. Sami Ramazanollu
- Pijet qetësuese me burim shërimi** 56
Nexhla Bash
- Gështenja dhe efektet e saj** 58
Shëndet



46 Islami në Spanjë
Një histori e copëzuar, një identitet i copëzuar
Alisia Rodriguez Mejuto



54 Çfarë faji kam unë?
Psik. Tuba Sekmen

Rindërtimi i mendimit



— Ahmet Tashgetiren —

Formati kryesor i personalitetit të një myslimani përbëhet prej rregullave që ka zbritur Allahu Teala (Kuranit Fisnik) dhe sipas personalitetit madhështor që ka ndërtuar i Dërguari i Allahut (a.s.), në bazë të dispozitave të Kuranit Famëlartë. Njeriu me “Amentunë” hyn në atmosferën e Islamit. Në këtë aspekt fillon ndërtimin e personalitetit, përparon në rrugën “ku besimi ndikon te zemrat” dhe arrin te pjekuria prej besimtari.

KUR TA SHOHIM KURANIN FISNIK SI “NJË UDHËRRËFYES I VËRTETË PËR JETËN”, DO TË DËSHMOJMË SE ATY GJENDEN PARALAJMËRIME PËR TË GJITHA PROBLEMET E JETËS. ÇDO PARALAJMËRIM ËSHTË PËR T’I ORIENTUAR DREJT RREGULLAVE HYJNORE TË GJITHA PROBLEMET TONA PSIKOLOGJIKE.



Udhëtimi i kësaj jete është i gjatë, është i mbushur me pengesa, ka shumë furtuna dhe ka shumë faktorë shkatërrues të brendshëm e të jashtëm që e tronditin vijueshmërinë e jetës së njeriut. Ky është një udhëtim kaq i rrezikshëm saqë edhe pse njeriu gjendet brenda kornizës së Islamit apo edhe pse duket se gjendet brenda kësaj të fundit, në dimensionin shpirtëror mund të shfaqet rreziku i një zbrazëtire spirituale.

Qoftë në Kuranin Fisnik apo qoftë në paralajmërimet verbale të të Dërguarit të Allahut (a.s.), është tërhequr vërejtja për këto zbrazëtira shpirtërore, për humbjet e rrugës së drejtë dhe për prishjet e formateve. Nga namazi deri te xhahadi dhe nga infaku deri te të gjitha marrëdhëniet njerëzore, paralajmërimi për të qëndruar në rrugën e drejtë në çdo aspekt, në mënyrë që të mbrohet cilësia jonë prej myslimani, gjendet në përmbajtjen e teksteve kryesore.

Allahu Teala ia ka mësuar besimtarit lutjen: “Na ruaj nga rrëshqitja e këmbëve!”, kundrejt rrëshqitjeve që mund t’i përjetojë njeriu. Edhe i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, i është lutur Zotit (xh.xh.): “Bëje të qëndrueshme zemrën time në fenë Tëndel!” Në këtë mënyrë, Pej-

gamberi na prin në aspektin e “ndjeshmërisë së zemrës” ngaqë ai vetë si njeri gjendet në pikën më të lartë të personalitetit.

Meqë bëhet fjalë për një rrezikshmëri të tillë, jemi të obliguar për të qenë të gatshëm, në mënyrë që ta mbrojmë veten. Për këtë arsye, paralajmërimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili ka ndërtuar një shoqëri myslimane sipas rregullave të Kuranit Famëlartë, duhet të jenë pikat e gatishmërisë për myslimanët në të gjitha kohët.

Në Kuranin Fisnik dhe në mënyrën që i Dërguari i Allahut (a.s.) ka ndërtuar shoqërinë, gjenden paralajmërimet dhe shpjegime të thella psikologjike në lidhje me marrëdhëniet njeri-shoqëri. Bazuar në këto që thamë, ne duhet t'i kthehemi Kuranit dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.), në mënyrë që formatin e personalitetit tonë ta mbajmë brenda kornizës së Kuranit dhe tërësisë së personalitetit që ka ndërtuar Pejgamberi. Kjo do të na japë “ndjeshmërinë/përpikërinë” ndaj rregullave. Nëse mund ta arrijmë këtë, atëherë para nesh vazhdimisht do të gjendet detyra e “riparimit të zemrës dhe mendjes”.

Nëse e shohim Kuranin Fisnik nga kjo pikë, përballë do të na dalin rregullat hyjnore nëpërmjet ajeteve që sjellin shumë “rregullime drejtimesh” dhe riparime vetëdijeje-mentaliteti në formën: “Ju mund të mendoni kështu e ashtu dhe mund të veproni sipas atyre mendimeve, por e vërteta e kësaj çështjeje është e tillë.”

Këtu mund të shtjellojmë disa pika. Për shebull, Zoti (xh.xh.), na flet për një “ditë në të cilën nuk do të kenë dobi pasuria dhe fëmijët”. Pastaj na njofton se atje duhet të shkojmë me “zemër të pastër”. (Shuara, 88) Pasuria është një potencial i kësaj bote. Edhe fëmijët janë një potencial i kësaj bote. Njeriu mund të mendojë se ky potencial mund t'i bëjë dobi edhe në ditën e gjykimit. Por ja që Fuqia e cila ka sunduar në të gjitha kohët, në një kontekst na thotë: “Mos u mashtroni”. Pra, na jep këtë mesazh: “Nëse atje nuk çoni zemrën e pastër, do të bëheni pishman, por ky pishmanllik nuk do të ketë dobi.”

Kthimi nga kibla dihet se sa disiplinë jetike që është. Ndryshimi i kibles në Epokën e Lumturisë fitoi një natyrë si ndarja e Islamit nga Ehli Kitab. Por në Kuranin Fisnik gjendet një koncept që quhet “Birr” dhe që në gjuhën tonë është përkthyer si “mirësi”. Ky koncept pothuajse shpreh veçorinë kryesore të personalitetit të myslimanit. Ja pra, neve na vjen një paralajmërim në lidhje




me çështjen për ta arritur atë: “**Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi...**” (Bakara, 177) Domethënë, të kthyerit e trupit nga kibla është i rëndësishëm, por nuk është i mjaftueshëm. Në lidhje me këtë çështje, ajeti vijon si më poshtë:

“...Por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (Bakara, 177)

Përveç të tjerash, edhe në një ajet tjetër flitet për “cilësinë e birrit/mirësisë”: “**Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë (birrin), derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.**” (Al Imran, 92) Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se ne duhet të japim. Ndërkohë na njofton se cilësia e të dhënit gjendet te “dhënia prej gjërave që i duam”.

Ja edhe një kriter tjetër: “**O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe**



Njeriu jeton në një shoqëri. Të qëndruarit larg njerëzve është i kufizuar. Islami nuk ka zbritur për të futur në sistem jetën e atyre që jetojnë vetëm në majë të malit. Edhe pse shoqëria mund të përbëhet prej besimtarëve, prapë se prapë mund të ketë probleme, tensione dhe mosmarrëveshje ndërmjet njerëzve. Allahu i Lartësuar kërkon prej besimtarëve që të ndërtojnë një shoqëri të bazuar në vëllazëri. Zoti (xh.xh.), bën paralajmërime shumë influencuese, në mënyrë që të zgjidhen problemet që mund të dalin në këtë shoqëri.

të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit...” (Bakara, 264)

Edhe një ajet tjetër i Kuranit Fisnik vendos një kriter tjetër për infakun: “Të japim prej të mirave që fitojmë. Të japim në rrugë të Allahut Teala (domethënë, të japim për hir të Zotit duke mos pritur që njerëzit të thonë se sa njerëz bujarë qe jemi). Të mos japim gjëra të dobëta që vetë nuk do t’i merrnim dot pa i mbyllur sytë.” (Shik. Bakara, 267) E gjitha kjo, sepse: **“A nuk e dinë ata se Allahu është Ai që pranon pendimin dhe bamirësinë nga robërit e Vet dhe se Ai është Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti?”** (Teube, 104; Hadid, 11) Po ashtu, sepse në themelin më kryesor të perceptimit tonë gjendet: “Çdo gjë është e Allahut Rrëskun e të gjithëve e jep Ai.” (Shik. Nur, 42; Bakara, 3) Dhe më e rëndësishmja, sepse: **“Ne i përkasim Allahut.”** (Bakara, 156) Kjo është ajo që kërkohet prej nesh.

Shfaqja e dashurisë kundrejt armiqve të Allahut (xh.xh.) dhe armiqve të besimtarëve... Të mbjellët e dashurisë kundrejt këtyre në mënyrë të fshehtë... Marrja e këtyre për miq... (Shik. Mumtahine, 60) Të kërkuarit e krenarisë dhe nderit pranë mohuesve të fesë... (Shik. Nisa, 139) A ka mundësi të ndodhin këto? A mund të përrjetojnë zemrat një rrëshqitje të tillë mentaliteti?

Zoti (xh.xh.), na tregon një për rrëshqitje të tillë të zemrave dhe na paralajmëron neve si besimtarë. Ai e cilëson këtë si “devijim nga rruga”.

(Shik. Mumtehine, 60) Pastaj thotë se “Krenaria dhe nderi i përkasin Allahut”. (Shik. Nisa, 139) Domethënë, nëse kërkojmë krenari dhe nder, duhet t’i drejtohem Allahut Teala.

“A nuk i mjafton Allahu robit të Vet?!” (Zumer, 36) Ky ajet në të vërtetë është një thirrje hyjnore që mundëson rregullimin e plotë të mentalitetit. Kurani Fisnik i paralajmëron besimtarët që të mos mbeten nën ndikimin e “atyre që i frikësojnë me diçka tjetër përveç Allahut”. Andaj, le ta pyesim botën tonë të brendshme: “A nuk është i mjaftueshëm Allahu?” A nuk është përgjigjja e kësaj pyetjeje: “La havle ve la kuvvete il-la bil-lahi’l-alijji’l-adhim.”

Pa shikoni se si e rregullon Kurani Fisnik zemrën dhe mendjen:

“(Shpërblim kanë edhe ata) të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: **“Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!”** e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”** (Al Imran, 173)

Lexojeni edhe këtë ajet: **“..Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje, qofshi edhe në këshqjellat më të forta!..”** (Nisa, 78) Nëse vdekja është një e ardhme e pashmangshme, nëse momenti i saj është në dorën e Zotit të botëve dhe nëse “Kthimi është te Ai”, atëherë “Ejne’l-meferr / Ku mund të ikim”? A është e mundur që të arratisemi prej kësaj? Çfarë mund të ndodhë nëse tentojmë për t’u arratisur? Ja pra, arratisja është e pamundur!

A më mirë të qëndrojmë në shtëpi, apo të dalim në xhihad duke flijuar pasurinë dhe jetën? Besimtari duhet ta bëjë zgjedhjen e tij. Rregulli hyjnor është krejt i qartë:

“Nuk janë të njëjtë ata besimtarë që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paaftëve, me ata që luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Allahu i ngre një shkallë më lart ata që kanë luftuar me pasurinë dhe jetën e tyre kundrejt atyre që kanë ndenjur në shtëpitë e veta. Ai u ka premtuar të gjithëve mirësi, por i ka dalluar ata që luftojnë mbi ata që nuk luftojnë me shpërblim të madh...” (Nisa, 95)

Herë pas here njeriu mund të kaplohet nga psikologjia e “dobësisë” kur “nuk jeton dot sipas rregullave hyjnore. Kurani Fisnik këtë gjendje e quan “Mustadaf”. Besimtarët në këtë gjendje thonë: “Nuk kam fuqi. Nuk mund ta zbatoj dot. Çfarë duhet të bëj?” Atëherë, shikojeni riparimin që Ku-

rani Famëlartë i bën mentalitetit në këtë çështje:

“Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me fajë, u thonë: “Ku ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në Tokë”. (Engjëjt) do t’u thonë: “A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?” Këta janë ata (njerrëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi. Sa i keq është ai vendbanim!” (Nisa, 97)

Në Kuranin Fisnik gjendet paralajmërimi: **“Vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”** (Al Imran, 102) Përse na bëhet një paralajmërim i tillë? Sepse njeriu përgjatë rrjedhës së kohës mund t’i humbasë ndjeshmëritë e tij. Ai mund ta harrojë se nga ka ardhur dhe se ku do të shkojë. Për shkak të kësaj, vdekja nuk i kujtohet apo përjeton një gjendje sikur nuk do të vdesë asnjëherë. Por ja që vdekja është e vërtetë. Mbi të gjitha, askush nuk e di kohën e ardhjes së saj. Andaj, në Kuran bëhet paralajmërimi se ajo mund të vijë në çdo moment. Engjëlli i vdekjes çdo moment mund t’i dalë përballë njeriut. Atëherë, a duhet që myslimani ta mbajë të gjallë “perceptimin e myslimanizmit”? Çfarë do të ndodhë nëse ndjekim hapat e shejtanit të mallkuar? Ndërkohë Allahu Teala thotë: **“Ai është armiku juaj. Mos shkoni pas hapave të tij.”** (Bakara, 208)

Të vdekurit si mysliman është i mundur vetëm me mbartjen e shqetësimit në zemrat tona për botën e përtejme. Ky shqetësim mund të mbartet duke i bërë ritëm të zemrës këto ajete në të cilat thuhet: **“...Ai është me ju kudo që të gjendeni...”** (Hadid, 4) Në një ajet tjetër thuhet: **“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten! Pikërisht ata janë të pabindurit (ndaj Allahut).”** (Hashr, 19) **“Atij që shmanget nga Këshilla e të Gjithëmëshirshmit (Kurani), Ne do t’ia caktojmë një djall, që do t’i bëhet shok i pandashëm.”** (Zuhruf, 36)

Pastaj, edhe këtë ajet duhet ta bëjmë drejtim të jetës sonë: **“...Mbështetuni tek Allahu! Ai është Mbrojtësi juaj. Sa Mbrojtës dhe Ndihmës i mrekullueshëm është Ai!”** (Haxh, 78) Ndër të tjera duhet të shohim se çfarë kemi dërguar për nesër dhe se çfarë do të na dalë përballë në momentet

e llogarisë. Allahu (xh.xh.), shprehet:

“O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se çfarë ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!” (Hashr, 18)

Kur ta shohim Kuranin Fisnik si “një udhërrëfyes i vërtetë për jetën”, do të dëshmojmë se aty gjenden paralajmërimet për të gjitha problemet e jetës. Çdo paralajmërim është për t’i orientuar drejt rregullave hyjnore të gjitha problemet tona psikologjike. Për shembull, në lidhje me mbajtjen e drejtësisë, thuhet:


“O ju që keni besuar! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në emër të Allahut, qoftë edhe kundër jush ose kundër prindërve dhe të afërmeve tuaj. Qoftë i pasur ose i varfër ai (për të cilin dëshmoni), Allahu është për ata vlerësuesi më i drejtë. Dhe mos shkoni pas epsheve tuaja e të shtrembëroni drejtësinë! Nëse ju ngatërroi dëshminë ose i shmangeni asaj, vërtet që Allahu e di se çfarë bëni ju.” (Nisa, 135) Në një ajet tjetër thuhet: **“Mos e përzieni të vërtetën me të pavërtetën, dhe të vërtetën mos e fshihni me vetëdije.”** (Bakara, 42)

Të bësh padrejtësi... Të bëhesh vegël e padrejtësisë. Të pandehesh se padrejtësia do të harrohet. Të kaplohesh nga një kalbje e mentalitetit duke e pandehur Allahun sikur nuk shikon... Allahu na paralajmëron:

“Mos mendo kurrësi që Allahu nuk e vëren atë që bëjnë keqbërësit! Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin).” (Ibrahim, 42)

Allahu nuk i do të padrejtët, Allahu nuk i do të padrejtët, Allahu nuk i do të padrejtët...

Njeriu jeton në një shoqëri. Të qëndruarit larg njerëzve është i kufizuar. Islami nuk ka zbritur për të futur në sistem jetën e atyre që jetojnë vetëm në majë të malit. Edhe pse shoqëria mund të përbëhet prej besimtarëve, prapë se prapë mund të ketë probleme, tensione dhe mosmarrëveshje ndërmjet njerëzve. Allahu i Lartësuar kërkon prej besimtarëve që të ndërtojnë një shoqëri të bazuar në vëllazëri. Zoti (xh.xh.), bën paralajmërimet shumë influencuese, në mënyrë që të zgjidhen



problemet që mund të dalin në këtë shoqëri. Le ta shohim se çfarë thotë Allahu Teala në ajetet e mëposhtme:

“Besimtarët janë vetëm vëllezër.” (Huxhurat, 10)

“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë.” (Al Imran, 103)

“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.” (Enfal, 46)

Myslimanizmi ynë... Mirë, por çfarë është myslimanizmi ynë? Mos vallë është një nderim kundrejt Allahut apo një mirësi? A kemi të drejtë t’ia mësojmë fenë Zotit (xh.xh.), në mënyrë që t’i lejojmë në jetën tonë gjërat e tjera? A mund të ndodhë që ta ndajmë fenë në copa, ta përdorim pjesën që na leverdis duke e konsideruar atë si rregull të “fetarizmit”, të kënaqemi me këtë, të sigurojmë të ardhura nëpërmjet fesë dhe t’ua ndryshojmë kuptimin ajeteve të Allahut Teala? Zoti (xh.xh.), na paralajmëron:

“Ata e quajnë si favor për ty që kanë pranuar Islamin. Thuaju: “Mos e quani si favor për mua se keni pranuar Islamin; përkundrazi, Allahu ju ka dhuruar mirësi dhe ju ka udhëzuar në besim, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” (Huxhurat, 17)

“Thuaju: “Vallë, a do ta njoftoni Allahun për fenë tuaj, ndërkohë që Ai di gjithçka që përmbajnë qiejt dhe Toka?! Allahu është i Dijshëm për çdo gjë.” (Huxhurat, 16)

“Por ata (popuj ku u çuan të dërguarit) u ndanë në grupe në çështje të fesë së tyre. Çdo grup ishte i kënaqur me atë që kishte.” (Mu’minun, 53)

“Me të vërtetë, ti s’ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Te Allahu është puna e tyre e pastaj Ai do t’u tregojë çfarë patën punuar.” (En’am, 159)

“...Mos i këmbeni shpalljet e Mia me një vlerë të vogël...” (Bakara, 41)

Nëse shoqëria në të cilën gjendemi përjeton kon-

fuzion në besim edhe pse është shoqëri islame dhe nëse ajetet e Allahut (xh.xh.), diskutohen nga njerëz që nuk i kanë njohuritë e duhura, atëherë çfarë duhet të bëjmë? Mos vallë duhet të zhytemi edhe ne në ato debate, apo duhet të bëjmë ndonjë gjë tjetër? Allahu Teala na paralajmëron në lidhje me këtë çështje:

“Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si ata. Allahu do t’i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit.” (Nisa, 140)

Përveç të tjerash, bëhet fjalë edhe për kaplimin nga një prishje për të vepruar sikur Allahu ka një fe më vete dhe Pejgamberi ka një fe tjetër më vete duke bërë kështu ndarje ndërmjet Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Edhe në lidhje me këtë çështje, Allahu i Madhëruar na paralajmëron:

“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.” (Nisa, 150-151)

Kurani Fisnik ka ardhur për ta shpëtuar njeriun, i cili ka në të gjithë damarët e tij padrejtësinë dhe injorancën, nga esfeli safilin / fundi i xhehenemit dhe për ta lartësuar te pjekuria ahseni takvim / e krijimit në formën më të bukur. Edhe i Dërguari i Allahut, (a.s.), u dërgua për t’i bërë përsëri njerëz sipas Kuranit Fisnik një shoqëri që i kishte kaluar hienat në vrasje dhe që i hante vëllezërit e vet nëse ishin të pafuqishëm. I Dërguari i Allahut (a.s.), prej asaj shoqërie nxori një shoqëri tjetër që u bë prijëse në moralin e lartë njerëzor. Pejgamberi e bërë këtë punë duke i pastruar ata dalë nga dalë, sepse njeriu herë pas here mund të përjetojë rënie. Ne jemi njerëz, jo engjëj.

Andaj, Kuranin Fisnik duhet ta lexojmë me këtë përpikëri dhe të Dërguarin e Allahut (a.s.), duhet ta shohim me këtë ndjeshmëri. Kurani Famëlartë po na thërret. Kur të lexojmë Kuran dhe kur të lexojmë hadithet e të Dërguarin e Allahut (a.s.), duhet t’u hedhim një sy librit të veprave tona, gjymtyrëve tona dhe zemrës sonë. Nëse kemi ndonjë gjë që nuk përputhet me rregullat, duhet të përpiqemi ta pastrojmë dhe riparojmë atë. Ja, kjo është rruga për të dalë me faqe të bardhë para Allahut (xh.xh.).



Kruga e drejtë në mentalitet

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Çdo lajm që zbret në këtë botë nga Allahu i Lartësuar, siç shprehet edhe Kurani Fisnik, është një “Lajm i Madh”. Ai formon dallgë në botën mentale të njerëzve. Së pari habi, pastaj mahnitje, pastaj mendim, pastaj, pastaj, pastaj... Çfarë duhet të bëjmë? Mos vallë duhet ta pranojmë? Apo duhet ta përgënjeshtrojmë? Mos vallë duhet ta nënvlerësojmë? Mos vallë duhet ta zhdukim atë që e sjell këtë mesazh? Mos vallë duhet ta pengojmë apo duhet ta ndihmojmë atë?

Kjo gjendje hutimi në të cilën kanë rënë shumë njerëz kundrejt këtij “Lajmi të Madh” që vjen nga Zoti, tregohet kështu në Kuranin Fisnik:

“Për çfarë e pyesin ata njëri-tjetrin? Për Lajmin e madh rreth të cilit ata kanë kundërshtime. Ani, shpejt do ta marrin vesh! Sigurisht që shpejt do ta marrin vesh!”
(Nebe, 1-5)

Shpallja hyjnore së pari po e lëkundte njerëzimin me reformimin e mentalitetit. Kjo shpallje duke përdorur një metodë marramendëse po u jepte goditje të forta kallëpeve të mentalitetit të trashëguar nga kultura e etërve dhe formuar nga dëshirat e shfrenuara e të degraduara të nefseve. Shpallja hyjnore po e shkatërronte këtë mentalitet dhe po ndërtonte mentalitetin e duhur. Shpallja hyjnore së pari e hetonte çdo lloj mendimi që nuk përputhej me bazën e fortë të dijes, perceptimit dhe të vërtetës pothuajse në të gjitha fushat e jetës. Pas këtij hetimi, të gjitha mendimeve të humbura, të pavërteta dhe të pakuptimta ua nxirrte fytyrën e vërtetë në pah. Pastaj në vend të këtyre mendimeve ndërtonte përjasje që u kishte hije nderit dhe fisnikërisë së njeriut.

Riparimi i mentalitetit së pari bëhej në përjasjen ndaj Zotit. “La ilahe il-lallah”, domethënë, “nuk ka zot tjetër përveç Allahut” shprehte të vërtetën se të gjitha gjërat që politeistët i quanin zota, të cilat nuk ishin të vërteta, të cilat nuk kishin kuptim dhe nuk kishin asnjë gjë të përbashkët me Zotin, përbëheshin vetëm nga emërtimet. Si mund të jetë zot që e meriton adhurimin një qenie që nuk mund t’i bëjë as dobi, as dëm qoftë edhe vetes? A mund të jetë krijues një gjë që është e krijuar? Nëse formoni zota ndërmjetës që t’ju afrojnë te Allahu duke e menduar Allahun shumë larg edhe pse Ai i ka krijuar qiejt dhe tokën, atëherë dijeni këtë se Allahu është shumë afër. Andaj, Ai nuk ka nevojë për asnjë ndërmjetës për ta dëgjuar lutjen tuaj. Nëse i shenjtëroni dhe i merrni për zota engjëjt, pejgamberët, dijetarët dhe njerëzit e nderuar me mendimin për të pasur disa ndërmjetësues ngaqë frikësoheni prej ndëshkimit dhe dënimit të Allahut Teala, atëherë dijeni se edhe ky mendim i juaji është i gabuar/i humbur, sepse pa dhënë leje Allahu (xh.xh.), nuk bëhet fjalë që dikush të ketë të drejtë për të

ndërmjetësuar. Prandaj, hiqni dorë edhe nga këto mendime të humbura e të pabaza dhe mos pranoni për zot askënd përveç Allahut të Lartësuar i Cili është i Mëshirshmi, Mëshirëploti, i Cili ka fuqi për çdo gjë dhe i Cili kurrë nuk ka ortak.

Fusha tjetër e rregullimit të mentalitetit është në përqasjen ndaj pejgamberit. Njerëzimi në shumicën e rasteve nuk e ka pranuar se mund të vijë një njeri si pejgamber (si i Dërguar i Allahut). Njerëzimi ka menduar se nëse do të ishte e nevojshme për të ardhur ndonjë profet, atëherë ky duhet të vinte prej engjëjve. Njerëzit e kanë parë me habi pejgamberin njeri që hante e pinte si ata dhe që ecte nëpër tregje. Në të vërtetë, kjo përqasje është rezultat i mos-konceptimit të drejtë edhe të Krijuesit të Lartësuar, edhe të njeriut, sepse Allahu Teala vazhdimisht ka zgjedhur të dërguar prej engjëjve e prej njerëzve. Zoti (xh.xh.), ka dëshiruar që ata të cilët do t'ua çojnë njerëzve shpalljen hyjnore të jenë nga mesi i tyre, sepse, po të dërgoheshin engjëj si pejgamberë, atëherë njerëzit do të justifikoheshin duke thënë se nuk mund ta zbatojnë fenë ngaqë nuk janë të përsosur si engjëjt. Andaj, vetëm një njeri mund t'ia tregonte njerëzimit se si mund të zbatoheshin të vërtetat hyjnore. Zoti shfaqti mrekulli nëpërmjet duarve të pejgamberëve, në mënyrë që njerëzit t'i pranonin ata. Për shkak të këtyre gjendjeve të jashtëzakonshme, ndërmjet atyre që i pasonin pejgamberët u shfaqën prirjet për t'i bërë zota profetët siç ka ndodhur me Isain, (a.s.). Edhe ky ishte një devijim mental dhe shpirtëror. Shpalljet hyjnore zbritnin njëra pas tjetrës me qëllim për t'i rregulluar sërish edhe këto gabime, sepse edhe pejgamberët ishin robërit e Zotit (xh.xh.). Ata kurrë nuk mund të ishin zota. Misioni parësor i tyre ka qenë shfaqja e një shembulli të bukur të nënshtrimit ndaj Zotit kundrejt njerëzve.

Një pjesë e rëndësishme e rregullimit të mentalitetit ishte në lidhje me faktin që njeriu ta pozicionojë veten në një pozitë të duhur. Njeriu nuk është një gjallesë si gjallesat e tjera. Njeriu është një qenie e veçantë dhe fisnike që është dërguar në tokë me një mision shumë më specifik. Ai nuk është krijuar për argëtim. Andaj edhe nuk është lënë pa përgjegjësi. Njeriu i është dhënë detyra për të bërë rregullime në tokë dhe i është kërkuar të bëhet mëkëmbës që do t'i zbatojë ligjet e Allahut (xh.sh.). Njeriu përgjatë kryerjes së kësaj detyre sublime është obliguar që të adhurojë jo të tjerë, por vetëm Allahun Teala, i Cili është Zoti i botëve. Atëherë, ajo që i takon njeriut për të bërë është që ta mbrojë këtë fisnikëri. Andaj njeriu nuk duhet ta flijojë veten për një gjendje të mjerueshme aq sa mund të bjerë edhe më poshtë se kafshët ndërkohë që ka një pozitë të cilën

e lakmojnë edhe engjëjt, sepse çdo gjë i është lënë amanet njeriut. Toka i është lënë amanet njeriut. Qielli i është lënë amanet njeriut. Prandaj, detyra e njeriut nuk është që t'i prishë tokën e qiejt, por që t'i dalë për zot amanetit sipas urdhrave të vullnetit të Zotit (xh.sh.).

Në periudhat kur njeriu nuk e ka vlerësuar veten me një përqasje të shëndoshë, ka përjetuar ndotje mentaliteti dhe është zhytur në shumë padrejtësi. Gruan e ka përçmuar, ka rënë deri në atë gjendje të ulët saqë t'i varrosë të gjalla në tokë fëmijët vajza, të dobëtin e ka skllavëruar dhe nuk e ka konsideruar njeri, të fortin gjithmonë e ka pranuar si të drejtë, të vobektin e ka parë si të padrejtë, i pasuri është bërë Karun, ai që kishte në dorë forcën e pushtetit është bërë Faraon dhe zot... Në këtë mënyrë, të gjitha vlerat pothuajse janë shkatërruar. Ja pra, shpallja hyjnore në të gjitha këto fusha i ka vendosur në vendin e tyre çdo gjë dhe çdo njeri. Revelata hyjnore i ka caktuar mentalitetit itinerarin e drejtimit duke i treguar se si duhet ta shohë njeriun, pasurinë, pronën dhe jetën. Dijsa, urtësia dhe drejtësia kanë formuar shtyllat kryesore të sistemit të vlerave.

Sipas mentalitetit të prishur, jeta e kësaj bote është çdo gjë. Sipas tij, e gjithë jeta fillon dhe mbaron këtu. Vdekja për të është fundi. Për shkak të kësaj, ky mentalitet mendon: "Atëherë, të gjitha kënaqësitë duhet të përjetojnë në këtë botë dhe duhet të formohet një jetë me në qendër unë." Ndërsa "Lajmi i Madh" e ka tronditur këtë mentalitet pa horizont dhe shterpë duke mos e konsideruar vdekjen si stacioni i fundit dhe duke e përkufizuar atë si një urë e ndërmjetme që zgjatet drejt një jete të re dhe të përhershme. Dikujt që kishte marrë në dorë disa kocka të bëra pluhur dhe që pyeti: "Kush mund t'i ringjallë këto kocka tani?", i dha këtë përgjigje: "Do t'i ringjallë pikërisht Ai që i ka krijuar për herë të parë." Në këtë mënyrë, dhomave të mbyllura të këtij mentaliteti u hapi dritaret e ndriçimit nga ku mund të shikonte horizontet e përhershmerisë.

Po, shpallja hyjnore ka injektuar një mentalitet të ri dhe e ka sistemuar përsëri botën e ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve. Ajo ka treguar se si duhet të shikohen toka, qielli, bimët, kafshët, qeniet e dukshme dhe bota e padukshme. Ajo ka treguar se cilat vlera duhet t'u jepen këtyre. Ajo ka treguar se cili veprim është i drejtë, se cili virtyt moral është i shëndetshëm, se cila rrugë të shpie te qëllimi i vërtetë, etj. Ajo i ka shpjeguar të gjitha këto në një mënyrë krejt të qartë. Edhe në ditët e sotme, nëse i duhet një riparim mentalitetit të botës moderne që i ka humbur dëlirësia, që është ndyrë, që ka degraduar dhe që është degjeneruar, atëherë referenca e vetme për këtë është feja islame.

Detyra dhe Qëllimi

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Sot jemi me datë 21 shtator të vitit 2017. Është ditë e enjte. Kemi hyrë në vitin 1439 hixhri, domethënë kemi hyrë në vitin e ri hixhri. Ky shkrim është përgatitur që në ato ditë, por ja që vetëm tani është mundësuar që t'i shkojë në dorë lexuesit.

Gjithmonë kur hyjmë në vitin e ri, gjëja e parë që vjen në mendje është vlerësimi i të kaluarës dhe planifikimi i të ardhmes. Vlerësimi dhe planifikimi në fjalë janë të vlefshëm edhe për individin, edhe për umetin. Kjo është pikërisht si pritja për faljen e të kaluarës dhe për hapjen e një dere të re mëshire e pranimi në fazën e ndërrimit të identitetit.

Amr ibnu'l-Asi, Allahu qoftë i kënaqur me të, u bë mysliman me vonesë. Para se t'i jepte besën të Dërguarit të Allahut (a.s.), shprehu shqetësimin e thellë që kishte brenda duke thënë: “Çfarë do të ndodhë me mëkatet e mia që i kam bërë në të kaluarën? A do të falen?” Pejgamberi (a.s.) e përgëzoi me përgjigjen: “*Pranimi i Islamit i fshin mëkatet që janë bërë më parë.*”¹

Po në të njëjtën mënyrë është dhënë përgëzimi se edhe hixhreti² dhe pendimi³ e pastrojnë njeriun nga mëkati i gabimeve që ka bërë përgjatë jetës në të kaluarën. Padyshim se për çdo mëkat ka edhe pendim. Ndërkohë, pendimi është i vlefshëm deri në frymën e fundit në planin individual dhe deri në kiamet në planin e umetit. Pendimi për shkujesjen është zgjimi dhe të vepruarit me zgjuars. Ndërsa pendimi për dembelizmin është përveshja e kraheve për t'ju futur punës.

E VËRTETA AKTUALE

Myslimanët e ditëve të sotme në çdo vend të botës ku gjenden kanë probleme të mëdha mentale, shkencore, administrative, politike dhe praktike. Ata jetojnë në mjedise plot me vështirësi. Sikur të mos mjaftonin problemet që kanë, mbi kokën e tyre gjenden edhe fuqitë e rendit të ri botëror. Ato i shohin myslimanët si të rrezikshëm. Për këtë arsye, dëshirojnë t'i neutralizojnë, madje edhe t'i zhdukin nga faqja e dheut. Tirania globale në ditët e sotme u është drejtuar e tëra myslimanëve.

Nga ana tjetër, myslimanët përgjatë gjithë historisë kanë gjetur mundësinë për t'i zgjidhur problemet e tyre brenda kornizës së Librit të Allahut dhe Sunetit të Resulullahut (a.s.). Edhe problemet e përditshme mund të zgjidhen brenda kornizës së këtyre dy burimeve bazë. Për t'ia dalë mbanë kësaj, kurrë nuk duhet të shfaqim plogështi, por duhet të përparojmë shkencërisht dhe të përvetësojmë një sjellje me

1. Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV 199, 204-205.

2. Ahmed ibn Hanbel, Musned, IV 199, 204.

3. Hiljetu'l-Evlja, I, 270.

personalitet. Myslimanët janë të detyruar të gjejnë një zgjidhje legjitime së pari ndërmjet tyre dhe pastaj kundrejt botës së jashtme për problemet me të cilat gjenden ballë për ballë nga aspekti i mendimit, vlerësimit dhe veprimit. Në të kundërt, Allahu na ruajt, mund të privohen apo të bëjnë një mëkat të madh siç është humbja e rrugës së Allahut (xh.sh.). Allahu na ruajt, përgjegjësia për një situatë të tillë kurrë nuk është vetëm e armiqve të jashtëm, por përkundrazi është edhe e atyre që e humbin rrugën e Zotit (xh.xh.).

Ne duhet ta pohojmë se për fat të keq nuk po shikohet ndonjë përpjekje, mirësi apo bashkim deri në atë masë që t'u ketë hije pohimeve që bëjnë shumë njerëz dhe grupe kurdo që u jepet mundësia se gjoja kanë qëllime të mëdha.

Kjo gjendje negative që po vihet re pothuajse në çdo klasë të shoqërisë, veçanërisht bie shumë në sy në fushën e fesë. Këtu mund të përmendim mësimin, praktikimin dhe marrëdhëniet njerëzore. Në shoqëri po bëhen disa veprime të cilat janë pothuajse si britmat e një rënieje nga brenda.

Në shumicën e fushave ku janë të nevojshme përpjekjet për të arritur qëllimet e mëdha dhe serioze të cilat mund të marrin kohë më shumë se jeta e njeriut, po shfaqen mangësi vetëdijesimi dhe veprimi si plogështi e pakuptimtë, preokupimi me gjëra boshe dhe të mjaftuarit me hapa të vegjël e të thjeshtë.

Ata që marrim edukim fetar duke filluar nga medresetë, numri i të cilave është shtuar ndjeshëm kohët e fundit, fakultetet e teologjisë, etj. patjetër duhet të synojnë për t'u bërë ndër myslimanët më të mirë. Synimi për të cilin po flasim është të trashëguarit e dijes profetike. Madje, ata duhet të edukohen me njetin e arritjes së pjekurisë për t'u bërë i dërguari i të Dërguarit të Allahut.

NJË E VËRTETË HISTORIKE

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), po e dërgonte Muadh ibn Xhebelin (r.a.), në vitin e nëntë të hixhretit si i ngarkuar me detyrë në Jemen, ndërmjet tyre ndodhi kjo bisedë. Pejgamberi (a.s.), i tha: *“Pa më trego, si do të gjykoresh për një çështje juridike?”* Muadh ibn Xhebeli (r.a.), iu përgjigj: *“Do të gjykoj me Librin e Allahut.”* Resulullahu (a.s.), e pyeti: *“Çfarë do të bësh nëse nuk e gjen (përgjigjen) në Librin e Allahut?”* Muadhi (r.a.), ia ktheu: *“Atëherë do të gjykoj me Sunetin e të Dërguarit të Allahut.”* Profeti (a.s.), e pyeti përsëri: *“Çfarë do të bësh nëse nuk e gjen (përgjigjen) edhe në Sunetin e të Dërguarit të Allahut?”* Muadh ibn Xhebeli (r.a.),

iu përgjigj: *“Do të bëj ixhtihad dhe do të gjykoj me mendimin tim.”*

Pas kësaj përgjigjeje të Muadh ibn Xhebelit (r.a.), i Dërguari i Allahut, (a.s.), u gëzua, i ra në kraharor Muadhit dhe e shprehu kënaqësinë e tij duke thënë: *“Falënderimi qoftë për Allahun i Cili e ka udhëzuar të dërguarin e të Dërguarit të Allahut në një rrugë prej të cilës është i kënaqur Resulullahu.”*⁴

Siç shihet qartë edhe në këtë hadith, shprehjen “i dërguari i të Dërguarit të Allahut” e ka përdorur pikërisht vetë Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të.

AKTUALITETI I VITIT 1439 HIXHRI

Të rinjtë, pra vajzat dhe djemtë që marrin edukim fetar duhet t'i bëjnë vetes një llogari shumë serioze për sa i përket aspektit të “detyrave dhe qëllimeve”. Ata duhet t'i kërkojnë dhe t'i gjejnë mënyrat për ta shtuar cilësinë dhe dijen brenda kornizës së dëshiruar, në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet për të cilat folëm më sipër. Kjo është një përgjegjësi emergjente që nuk mund të lihet për më vonë.

Udhëheqësit që kanë pushtetin dhe përgjegjësinë për t'i vlerësuar mundësitë materiale dhe shpirtërore të umetit, nuk duhet të pandehin se brezat e rinj po edukohen duke marrë diploma. Ata duhet të hetojnë nëse brezat e rinj i kanë arritur standardet e edukimit të vërtetë. Ata duhet të përpiqen për t'i gjetur zgjidhje kësaj çështjeje nga kjo pikë. Andaj, kjo duhet të jetë “detyra dhe qëllimi” i parë i tyre.

Myslimanizmi gjithmonë inkurajon përsosmërinë dhe fluturimin drejt horizonteve të reja e të pastra. Andaj, le ta përsërisim edhe një herë se të vërtetat e botës së brendshme dhe asaj të jashtme vendosin si detyrë dhe qëllim para të rinjve myslimanë që po edukohen në ditët e sotme, arritjen e pjekurisë për t'u bërë trashëgues të Pejgamberit dhe të dërguar të të Dërguarit të Allahut.

Punimet e lidhura me një vendosmëri që synon arritjen e kësaj pjekurie, do të jenë një faktor shpirtëror i rrënjësor që do ta shtojë përsosmërinë e informimit dhe cilësinë e organizatave civile në dhënien e edukimit fetar. Së fundi, ai që fiton do të jetë i gjithë umeti i Muhamedit (a.s.). Si thoni? A nuk ia vlen ta provojmë? Të mos harrojmë se vetëm njerëzit e mëdhenj dhe njetet e sinqerta rendin pas qëllimeve të mëdha.

4. Ebu Davud, Akdije 11; Tirmidhi, Ahkam, 3; Darimi, Mukaddime 20; Ahmed ibn Hanbel, Musned, V, 230, 236, 242.



Feja është opium apo aksion?

— Ali Riza Temel —

Titulli i këtij materiali mund t'i duket i çuditshëm lexuesit mysliman. Mbi të gjitha, një pyetje e tillë është krejt e pabazë për Islamin i cili simbolizon kryengritjen dhe rezistencën kundrejt të gjitha besimeve të humbura dhe besëtytnive që e skllavërojnë mendjen dhe zemrën e njeriut. Në të vërtetë, përpjekja e të gjithë pejgamberëve mund të përmblihet si rezistencë kundrejt shtypjes, padrejtësisë, shfrytëzimit dhe kolonializmit. Pejgamberët të cilët kanë qenë të ngarkuar me detyrën për t'i dhënë fund skllavërimit të njeriut, për t'i barazuar të gjithë në nënshtrim kundrejt Krijuesit, për t'i dhënë vlerë dinjitetit të njeriut, për t'i hequr të gjitha pengesat që e pengojnë përparimin shpirtëror e material dhe për t'i dhënë kuptim jetës e vdekjes, janë reformatorët më të mëdhenj të historisë. Ata kanë bërë kryengritje qoftë edhe të vetëm kundrejt sistemeve të forta dhe kanë luftuar në mënyrën më dinjitoze për sundimin e të vërtetës. Ata sakrifikuuan edhe jetën e tyre për këtë mision. Për këtë arsye, mbetën ballë për ballë me komplete dhe tortura marramendëse.

Edhe pse e vërteta është e tillë, fenë që është dinamizmi më i rëndësishëm dhe burimi i aksionit, disa mashtrues që hiqen si fetarë e kanë shndërruar në opium për t'i mashtruar masat dhe për ta thyer rezistencën e njerëzve kundrejt padrejtësive. Karl Maksi ka thënë se feja është shndërruar në opium nga klasa borgjeze për t'i mashtruar punëtorët. Nga njëri aspekt ka shprehur të vërtetën.

Të përkufizuarit e fesë si opium mund të shtjellohet nga dy aspekte. Allahu, kaderi dhe besimi në botën tjetër janë qetësues të posatshtëm dhe një burim i rëndësishëm ngushëllimi për dhimbjet dhe vuajtjet. Ky ndikim qetësues dhe ngushëllues i fesë nuk bëhet shkak për mekje, por përkundrazi bëhet shkak për të parandaluar rënien morale e shpirtërore dhe për ta bërë njeriun rezistent e të qëndrueshëm. Edhe tevekkuli/mbështetja te Zoti e bën njeriun të fuqishëm ngaqë është besim dhe mbështetje te Allahu.

Nga ana tjetër, feja po përdoret për t'i mashtruar masat dhe për ta thyer rezistencën e njerëzve kundrejt padrejtësive siç e kemi shprehur më sipër. Përveç të tjerash, ndjenjat fetare po përdoren për t'i orientuar njerëzit te qëllimet e gabuara. Disa persona dhe grupe që u janë shpërlarë trutë me premtimin e xhenetit, janë shndërruar në organizata terroriste dhe kriminale. Hashhashët janë shembulli më tipik për këtë. Këta njerëz dhe grupe që truri u është shpërlarë me fenë e shndërruar në opium, po i bëjnë krimet duke i perceptuar si ibadet. Ata po bëhen rreziku më i madh për fenë e vërtetë dhe shoqërinë. Masat pothuajse po hipnotizohen prej tyre.

Shkrimtari i njohur Tolstoi e shpjegon kështu këtë çështje: "Disa nuk i besojnë asnjë gjëje dhe me këtë ndjejnë krenari. Disa të tjerë hiqen sikur u besojnë atyre gjërave që u leverdisin dhe që i kanë bërë ma-

sat të binden për t'iu besuar nën petkun e besimit. Ndërsa shumica dërmuese që mbetet, e pranon si besim hipnotizimin që u është bërë dhe i binden si skllevër çdo gjëje që ua kërkojnë udhëheqësit e tyre jobesimtarë.”

Përgjatë gjithë historisë islame nuk kanë munguar asnjëherë tentativat për ta nxjerrë fenë nga të qenët e saj e vërteta më dinamike e jetës, për ta bërë atë opium, përrallë, melankoli, besëtytni e iluzion dhe për ta shndërruar atë nga aksion në opium.

Edhe në historinë tonë të afërt dhe në ditët e sotme i kemi dëshmuar dhe po i dëshmojmë tentativat për t'i mashtruar njerëzit me fenë, Zotin, Kuranin, Pejgamberin, ëndrrat, Mehdiun, shehlerët dhe mrekuillitë. Personat që janë bërë idhuj me anë të disa mënyrave misterioze, me intriga djallëzore dhe me metodat e shenjtërimit, janë shndërruar në njerëz të padiskutueshëm. Për këtë arsye, çdo fjalë, veprim dhe shenjë e tyre konceptohet pothuajse si shpallje hyjnore. Këta lloj njerëzish me dijeni apo pa dijeni po përdoren si vegla nga imperialistët për të shkatërruar umetin. Shembujt më aktivë të këtyre janë Kesnizani në Irak, Kadriu në Pakistan dhe Feto në Turqi. Këta njerëz hipokritë, shtirësa, tradhtarë dhe skizofrenë e kanë shkatërruar umetin me paratë dhe ndihmat që kanë marrë prej vetë umetit, i kanë zhvlerësuar vlerat e shenjta dhe e ka shndërruar Islamit në një helm dhe drogë vrasëse edhe pse ai në fakt i jep gjallëri njerëzimit. Këta të poshtër që po e shfrytëzojnë Islamit për interesat dhe të ardhmen e tyre me mashtrime dhe komentime në kundërshtim të plotë me mendjen, logjikën, natyrshmërinë njerëzore, Kuranin dhe Traditën profetike, po i shkaktojmë dëme umetit dhe Islamit më shumë se ateistët ngaqë intrigat e tyre i bëjnë të kamufluara me petkun e fesë.

Personat apo grupet që e kanë shndërruar në terror xhihadin apo që e mohojnë krejtësisht atë edhe pse xhihad do të thotë përpjekje për të vënë drejtësinë, janë fatkeqësia kryesore e umetit.

Gulam Ahmeti synoi t'i bënte myslimanët e Indisë t'i bindeshin imperializmit anglez duke thënë se nuk ka xhihad në Islam. Nëpërmjet këtyre organizatave vegla si Isisi, Alkaida, Boko harami etj. e kanë bërë Islamit identik të njëjtë me terrorin edhe pse Islam do të thotë paqe siç kuptohet nga vetë emri.

Muhamed Ikbali, i cili është një burrë i mendjes dhe i zemrës që mori përsipër detyrën për zgjimin e umetit kundër imperializmit, thotë si më poshtë për fenë e shndërruar nga aksioni në opium:

“Ç’është kjo fe që të vë në gjumë? Mos vallë është magji? Mos vallë është drogë? Mos vallë është ilaç? Mos vallë është fe?

Një fe që është në kundërshtim me Sunnetull-

llahun, ligjet e krijimit, mendjes së shëndosh dhe zemrës së pastër, nuk mund të jetë fe. Feja është ajo që i ka prishur mashtrimet e magjistarëve. Të gjithë e dimë se si i ka mposhtur magjistarët Musai dhe se si ata iu dorëzuan atij. Feja është rigjallërim. Edhe ringjalljen pas vdekjes e kemi mësuar nga feja. Të qenët dinamik dhe i gjallë në kuptimin e vërtetë përgjatë jetës është i mundur vetëm me besimin dhe fetarizmin e vërtetë. Fuqia shtytëse e të gjitha lëvizjeve për pavarësi në të gjitha vendet islame është Islami dhe shpirti i xhihadit. Konceptet luftëtar dhe dëshmor janë konceptet bazë të kësaj lufte/përpjekjeje.

Një mysliman i vërtetë është një ushtri më vete. Shikoni çfarë thotë muxhahidi i vërtetë, Muhamed Ikbali: “Ky rob modest që i ka dalë kundër shoqërisë, nuk ka gjë tjetër përveç dy fjalëve: La ilahe il-lall-llah, Muhammedun Rasulull-llah!”

Kuranin që ka zbritur për të na dhënë jetë, po na e këndojnë te koka kur ndërrojmë jetë. Andaj, të mos kërkojmë kënaqësi nga besimi përderisa gjendemi në robëri edhe nëse e mësojmë krejt Kuranin Fisnik përmendësh. Le ta mprehim veten si shpatë. Pastaj le të hidhemi në krahët e kaderit. Madje, le ta hedhim edhe veten në krahët e kaderit, sepse esenca jonë nuk është e keqe. Shehadeti dikur ka qenë një fuqi që sundonte në këtë botë. Ndërsa sot është vetëm temë e shkencës së Kelamit. Nëse përkulemi para të tjerëve, atëherë as zemra, as mendja nuk janë më tonat. Përderisa të kemi në dorë shkopin “La ilahe il-lall-llah”, do t'i shkatërrojmë të gjitha magjitë.

Ne kemi nevojë për të besuar përsëri dhe për ta ripërtërirë besimin, në mënyrë që Islami të shndërron nga opium në aksion. Në ajetin Fisnik thuhet: “**O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë...**” (Nisa, 136) Fakti që në ajet u thuhet besimtarëve që të besojnë, është shumë interesant. Kjo do të thotë se besimi vazhdimisht duhet të mbahet i gjallë dhe duhet të ripërtërihet në çdo moment. Gjithashtu interesant është edhe fakti se Hasan Ali Nedvi ka shkruar një libër me titull “Përsëri në Islam” dhe Mevdudi ka shkruar një libër me titull “Ejani të bëhemi myslimanë”.

Islami është aksion. Kurani Fisnik është i mbushur plot me fjalët “amel, fiil, sa’j dhe kesb”. Umeti i një Pejgamberi që thotë: “Është mashtruar ai që i ka dy ditë njëlloj.”, është i detyruar të jetë dinamik. Ai që fle, nuk bën gjë tjetër përveçse sheh ëndrra. Andaj, ne jemi të detyruar të largohemi nga bota e ëndrrave dhe të kthehemi te e vërteta, natyrshmëria njerëzore, mendja e shëndoshë dhe te zemra e pastër me kokën lart në qiell dhe këmbët në tokë.



Mirësitë e shumta të Zotit

— Idris Arpat —

“Kur Ne dërguam te ty një grup xhindesh për të dëgjuar Kuranin, ata, kur erdhën, i thanë njëri-tjetrit: “Heshtni!” Dhe kur përfundoi (leximi), ata u kthyen te populli i tyre si këshillues. Ata thanë: “O populli ynë! Ne dëgjuam një Libër të shpallur pas Musait, i cili vërteton shpalljet para tij, udhëzon nga e vërteta dhe tregon rrugën e drejtë.

O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të Allahut dhe besojini Atij! Ai (Allahu) do t’jua falë gjynahet tuaja dhe do t’ju shpëtojë prej dënimit të dhembshëm. Ndërsa ata që nuk i përgjigjen thirrësit të Allahut, nuk do të mund t’i ikin Atij në Tokë; për ata s’ka mbrojtës tjetër, përveç Tij. Ata janë në humbje të madhe.” (Ahkaf, 29-32)

Profesori ynë, Hajretin Karamani na jep një këshillë të tillë: “Për ata që më dëgjojnë kam tri sugjerime. Këto sugjerime janë si ato që mësuesi ia jep nxënësit të tij. Këto sugjerime janë si më poshtë:

Vazhdoni ta lexoni Kuranin Fisnik me përkthimin e tij. Kurani Famëlartë le të hyjë në jetën tuaj ditore.

Jetën, fjalët dhe moralin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), lexojini një herë për çdo vit nga i njëjti libër apo nga libra të ndryshëm.

Preokupohuni me letërsi dhe art.”

Një personalitet i nderuar që ia ka dedikuar jetën mirëqenies së Umetit të Muhamedit si Profesor Hajretini, sigurisht që do të thotë gjëra për të cilat beson se janë të rëndësishme. Për këtë arsye, dëshiroj të mendojmë goftë edhe pak mbi këto tri sugjerime.

Leximi i Kuranit Fisnik së bashku me përkthimin e tij në një kohë të përshtatshme, sigurisht që do t’i japë begati jetës së përditshme të një muslimani dhe

do t’ia zbukurojë atë. Përveç të tjerash, preokupimi me fjalën e Allahut Teala tërheq kënaqësinë e Zotit (xh.xh.). Kjo i jep njeriut prehje shpirtërore. Andaj, njeriu do të rehatohet duke thënë: “Po e vlerësoj kohën.” Si rezultat, rregullat që duhet t’i zbatojë në jetë gjithmonë i mban në mendje dhe i kujton ato që ka harruar. Pastaj, merr informacione të reja dhe fillon të ndjejë gjëra të bukura. Në këtë mënyrë, ai i shikon anët pozitive dhe ato negative të tij duke e testuar veten me Kuranin Fisnik. Këto veprime sjellin lartësimin dhe përparimin në aspektin shpirtëror.

Kur mesazhi i Zotit të merret seriozisht, edhe mirësitë e Tij do të jenë më të shumta, sepse vlerësimi i mesazhit tregon marrjen seriozisht të atij që e ka dërguar mesazhin.

Të njëjtën temë e shpjegon kështu edhe profesori ynë i ndjerë, Bekir Topallogllu:

“Nëse e pranojmë se kemi njëqind detyra kundrejt Kuranit Fisnik, atëherë pesë për qind e këtyre është që ta lexojmë atë pa gabime, sipas rregullave të texhvidit dhe mundësisht me makam. Gjashtëdhjetë për qind është përpjekja për ta kuptuar atë pjesë të Kuranit që e lexojmë. Ndërsa tridhjetë e pesë për qind që mbetet është përpjekja për ta zbatuar dhe për ta predikuar Kuranin.”

Profesori i nderuar mendoi se i ka ndarë kaq pjesë të madhe të kuptuarit të Kuranit ngaqë ai nuk mund të zbatohet pa u kuptuar. Ndërkohë, ai vetë e ka pas bërë zakon leximin e Kuranit Fisnik. Madje, ai bënte një hatme në muaj.

Në çdo hatme që bënte, përpiquej për të gjetur ndonjë zgjidhje për çështjet e njerëzimit. Në këtë mënyrë, nga

njëra anë pastrohej shpirtërisht me mëshirën hyjnore dhe nga ana tjetër përpiquej për të zbuluar të dhënat hyjnore dhe zgjidhjet për çështjet njerëzore.

Profesori i ndjerë që në krye të vitit 1970 ka shkruar një libërth me titull “Xhematet e Kuranit”. Në këtë libërth pati theksuar rëndësinë e përpjekjeve për ta kuptuar Kuranin në mënyrë të përbashkët nga grupe që përbëheshin prej tri-pesë vetave. Në këtë libërth ai pati përdorur shprehje të tilla: “Nëse njërit prej nesh nuk i vjen në mendje diçka, atëherë i vjen tjetrit. Në këtë mënyrë, mësimi bëhet edhe më i begatshëm.”

Edhe profesori ynë i ndjerë, Musa Topbashi, Allahu e mëshiroftë, e ka pas bërë zakon që të lexonte dhjetë faqe në ditë nga Kurani Fisnik. Kur u sëmur dhe arriti deri në atë gjendje sa që nuk lexonte dot, e vazhdoi këtë traditë të tij duke dëgjuar nga kasetofoni. Unë kam njohur edhe myslimanë që thoshin: “Babai për pesëdhjetë vjet me radhë ka lexuar nga pesë faqe prej Kuranit së bashku me përkthimin e tyre.” Këtu le të përmendim edhe fjalën e poetit të famshëm Junus Emresë: “Kush nuk di të lexojë Kuran, është sikur nuk ekziston në këtë botë.”

Këtu duhet ta theksojmë fort se mendjet e edukuara shumë mirë dhe zemrat e thelluara në dije vazhdojnë të bëjnë kërkime të mëdha dhe të meditojnë rreth Kuranit Fisnik. Nëse Kurani do t’u japë zgjidhje të reja çështjeve të njerëzimit deri në momentin e fundit, atëherë do të thotë se kemi nevojë të jashtëzakonshme për këto kërkime dhe meditime. Siç është e rëndësishme që fjalën e vërtetë ta shprehim në mënyrë të saktë, po ashtu e rëndësishme është që edhe ta kuptojmë dhe komentojmë saktë. Nëse përfitojmë edhe nga dijet e tjera brenda kornizës së tërësisë “shqiptim, kuptim, qëllim”, mund të arrijmë të përqasje dhe zgjidhje mjaft të bukura. Nëse në mendje na vjen një kuptim i ri, atëherë këtë duhet ta konsiderojmë si një mirësi të Allahut (xh.sh.).

Për sa i përket shprehjes: “Jetën, fjalët dhe moralin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), lexojini një herë për çdo vit...”, sigurisht që edhe kjo do të ketë shumë dobi. Jeta e Pejgamberit (a.s.), është zbatim i Kuranit Fisnik. Domethënë, jeta e Pejgamberit është praktikimi i Kuranit. Resulullahu (a.s.), është bërë shembulli i shkëlqyer për ne ngaqë ka bërë një jetë nën kontrollin e Allahut Teala dhe ngaqë gabimet i janë rregulluar nga Zoti i Lartësuar. Përpjekja për të jetuar si Profeti (a.s.), është konsideruar si argument për dashurinë ndaj Allahut. Kjo përpjekje bëhet shkak për faljen e mëkateve tona. Në jetën e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të, sigurisht që do të gjejmë shumë parime në lidhje me çdo fushë të jetës sonë. Nëse do ta ndjekim atë vazhdimisht, kjo do të thotë se do të bëhemi besimtarë me cilësi të larta dhe njerëz plot mëshirë.

Ne e dimë se nuk ka fjalë mbi Kuranin Fisnik dhe jetë më të mirë se ajo e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Andaj, tashmë le të flasim për preokupimin me art dhe letërsi.

Allahu i Lartësuar siç na ka bërë mirësi duke na dërguar shpalljen hyjnore, na ka bërë mirësi edhe nëpërmjet figurave të mëdha, zemrave të gjera dhe aftësive që vështirë të kënaqen me pozitën në të cilën gjenden.

Për shkak se njerëzit me krijim të lartë nuk mund të kënaqen me një jetë të zakonshme, detyrimisht do të fillojnë të bëjnë kërkime e studime. Këto kërkime e studime vazhdojnë përgjatë gjithë jetës. Këta njerëz gjithmonë digjen e përvëlohen me një mallëngjim të madh. Të mos harrojmë se “mallëngjimi ynë është lutja”. Lutja është një dialog ndërmjet Allahut dhe robit. Allahu Teala nuk rri indiferent kundrejt kërkesës së robit. Për këtë arsye, asnjëherë nuk i lë pa rezultat kërkesat dhe përpjekjet e sinqerta të tij.

Me këto dëshiroj të them:

Prej gjuhës dhe lapsit të njerëzve të mëdhenj gjithmonë do të rrjedhin fjali të reja e të ngrohta, fjalë me kuptime të larta, rregulla dhe zbulime që hapin horizonte të tjera. Këto e përparojnë dhe e lartësojnë jetën. Për këtë arsye, e kemi për detyrë që të meditojmë rreth kësaj bote. Ky meditim do të na lidhë me figurat më të mëdha dhe me zemrat më të ngrohta e të gjera. Në këtë mënyrë, perceptimi dhe bota jonë do të rregullohen.

Ne duhet t’i lexojmë shkrimtarët kryesorë të botës dhe duhet t’i ndjekim universitetet që kanë bërë emër. Të gjithë librat lexohen për të kuptuar sa më mirë vetëm një libër (Kuranin).

Le të marrim dije, sepse fjalët më të ndritura, më të ngrohta dhe më të dobishme janë fjalët e atyre që vështirë të kënaqen me pozitën në të cilën gjenden. Ndërsa ata që kënaqen me pozitën e tyre, vazhdojnë t’i përsërisin gjërat e njohura dhe të xhirojnë në të njëjtin vend. Meqë ra fjala, këtu le të kujtojmë një urtësi të të ndjerit Xhemil Meriçit:

“Në botën tonë kulturore le të vijmë erëra nga mjediset e të gjitha kulturave të botës, por ato nuk duhet të na lëkundin.” Andaj, me dorën e djathtë duhet të kapemi fort ndaj Kuranit e Sunetit dhe me dorën e majtë duhet të studiojmë çdo gjë që gjendet në këtë botë. Vetëm në këtë mënyrë mund ta mbajmë gjallërinë e botës sonë të dijes. Por ja që për fat të keq, kokat e lindjes sot për sot vazhdimisht po shkojnë pas gjërave të njohura, kurse kokat e perëndimit po rendin pas eksplorimit të gjërave të reja. Këtu mendoj se do të ishte e drejtë nëse do të them edhe këtë të vërtetë tjetër:

“Nëse përdorni vetëm fuqinë fizike, bëheni punëtorë. Nëse fuqinë fizike e përdorni së bashku me fuqinë e mendjes, bëheni mjeshtër. Nëse këtyre dy fuqive u shtoni edhe fuqinë e zemrës, atëherë bëheni artist.”

Mbartja e vazhdueshme e gjërave në rend të ditës është e mundur nëpërmjet artit. Zbukurimi i jetës dhe i botës është në raport të drejtpërdrejtë me këtë. Siç shprehet edhe Dyxhane Xhyndiogllu: “Qëllimi nga ibadeti dhe veprat është zbukurimi i kësaj bote dhe moralit.”

Mirësia në të dyja botët

— Xhafer Durmush —

Në suren Bakara thuhet: **“...Disa njerëz thonë: “Zoti ynë, jepna të mira në këtë botë!” Por, për këta, s’ka asnjë të mirë në botën tjetër. Por ka dhe të tjerë që thonë: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit (të Xhehenemit)!” Këtyre do t’u jepet shpërblim për atë që kanë bërë. Allahu është i shpejtë në llogari.”**¹

Përmbajtja e këtij ajeti lutjeje që e dhamë më sipër, në Ruhu’l-Bejan është dhënë në këtë formë: “Përmendeni shumë Allahun dhe kërkonini prej Tij lumturinë e të dy botëve.” Kuptimi leksikor i fjalës “hasene” që përmendet në ajetin fisnik është “mirësi”. Gjithashtu kjo fjalë shpreh edhe të gjitha mirësitë që e gëzojnë njeriun kur i arrin ato. Por nëpër librat e tefsirit i janë dhënë kuptime të ndryshme fjalës “hasene”, pra mirësive që kërkohen për këtë botë dhe atë të përtejmen. Nisur nga këto komentime, “hasene” në këtë botë është shëndeti, pasuri e mjaftueshme për të kaluar jetën dhe suksesi në punë të dobishme që robërit e devotshëm i kërkojnë Allahut Teala. Ndërsa “hasene” në botën tjetër shpreh sevapin dhe xhenetin.

Transmetohet se kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, dëgjoi që dikush prej saha-

bëve ishte sëmurë, shkoi dhe e vizitoi. Sahabi i sëmurë ishte dobësuar shumë dhe pothuajse ishte bërë sa një fëmijë. Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), qëndroi për një kohë pranë tij, e pyeti: “A i ke bërë lutje Allahut në lidhje me ndonjë çështje?” Sahabi i sëmurë u përgjigj duke i thënë: “Po, i kam bërë një lutje të tillë: Atë me çfarë do të më ndëshkosh në ahiret, mos e lër për atje por ma jep që në këtë botë!” Pas kësaj përgjigjeje që mori, i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tërhoqi vërejtjen këtij sahabi duke i thënë që të mos lutej kështu. Pastaj e këshilloi që t’i lutej Zotit në këtë formë: “*All-llahumme rabbena atina fi’-d-dunja haseneten ve fi’-l-ahireti haseneten ve kina adhabe’n-nar.*” Domethënë, “O Zoti ynë! Na jep mirësi në këtë botë dhe në botën tjetër! Na mbro nga ndëshkimi i xhehenemit!”² Transmetohet se ky sahab i cili e zbatoi këshillën e Resulullahut, (a.s.), u shërua pas pak kohësh.

Enesi (r.a.), i cili i ka shërbyer dhjetë vjet të Dërguarit të Allahut (a.s.), ka thënë se Resulullahu më së shumti këtë lutje ka pas bërë.³ Për këtë arsye, kjo lutje ka zënë vend ndërmjet lutjeve që bëhen në namaz dhe është shndërruar në një pjesë të pandashme të jetës së ibadetit.

Nëse mund ta përmbledhim me një fjalë të vetme jetën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili e ka thënë shpesh herë këtë lutje që përbën temën tonë, sigurisht se kjo fjalë nuk mund të ishte tjetër përveçse “mirësi”, sepse e gjithë jeta e tij ishte mirësi kundrejt të gjithëve duke mos ia dashur askujt të keqen. Pra, jeta e Pejgamberit ishte bujari, falje, fytyrë e qeshur dhe gjuhë e ëmbël. Jeta e Pejgamberit ishte preokupim me mirësi dhe këshillim për bamirësi.

I Dërguari i Allahut (a.s.), kish-te një mëshirë aq të madhe saqë i përfshinte në falje edhe ata që e luftonin. Kur ajeti fisnik na më-son se duhet të kërkojmë mirësi për të dy botët, me sa duket këtë na tregon. Ja, ky është morali i Kuranit. Këto janë mësimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Mys-limanizmi para së gjithash është të qenët i mirë.

Jeta e kësaj bote, siç shprehet edhe vetë i Dërguari i Allahut (a.s.), *“është një hije nën të cilën pushon udhëtari që është nisur për rrugë të gjatë”*.⁴ Ndërsa jeta e botës së përtejme e cila është e përhershme, do të marrë for-më sipas veprave që kemi bërë. Domethënë, botën e përtejme do ta gjejmë të gatshme para nesh si produkt i jetës së kësaj bote. Nisur nga ky aspekt, mbushja e jetës së kësaj bote me mirësi është aq shumë e rëndësishme saqë nuk mund të neglizhohet, sepse të gjitha ato që do të bëjnë, mirë apo keq, nesër do t'i gjejnë përballë pa u humbur asgjë qoftë edhe sa një grimcë.⁵

Atëherë, ajo që na takon është që të veprojmë me vetëdijen se jeta e kësaj bota dhe e botës tjetër janë plotësuese të njëra-tjetrës dhe se të dyja fitohen së bashku. Kjo botë është vendi i punës dhe fitimit. Andaj, jeta e kësaj bote duhet të shndërrohet në mundësi për lumturinë e ahi-retit.

Këtu para së gjithash urdhërohet që të kërkojmë mirësi për je-tën e kësaj bote. Kjo për mendi-min tonë është e rëndësishme. Edhe një diçka tjetër që bie në sy është kjo: Fjala “hasene” që në shqip e përkthejmë mirësi është një fjalë që i përfshin të gjitha virtytet. Gjithashtu, në ajetin fisnik tregohet edhe rëndësia e lutjes që është momenti i për-gatitjes shpirtërore dhe mentale

në rrugën që e shpie njeriun te lumturia e të dyja botëve. Për mendi-min tonë, edhe kjo është e rëndësishme. Nisur nga këto që thamë, të gjitha veprat që bëhen do të kenë kuptim aq sa të pajisen me lutje dhe nijet të pastër.

Tashmë mund të themi: Punët tona absolutisht duhet të jenë në nivelin e pjekurisë që përputhet nga përkufizimi i fjalës “hasene”. Veprat tona duhet të cilësohen si “mirësi” në sytë e njerëzve dhe si “hasene” te Allahu (xh.xh.).

Mirësitë janë si zogjtë që fluturojnë me dy krahë. Mënyra për t'i bërë ato që të fluturojnë (që të pranohen nga Zoti) është që t'i bëjmë me vetëdijen: “Në ahiret do të jap llogari.”

■ **REFERENCAT:** 1) Bakara, 200-202. 2) Shik. Muslim, Dhikr, 23; Tirmidhi, Deavat, 71/3487. 3) Buhari, Tefsir, 38; Deavat, 55. 4) Shik. Tirmidhi, Zuhd, 44 (2378). 5) Shik. Zilzal, 7-8.

LEXO MENDO

KUSH DO TË JENË SHOKËT E TU?

Në suren Nisa thuhet: *“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, do të jetë me ata të cilëve Allahu u ka dhënë shumë dhunti: me profetët, me të sinqertët, me dëshmorët dhe me të drejtët! Eh sa shokë të mrekullueshëm janë këta!”*⁶

Ky ajete fisnik ka zbritur për shkak të atyre që tha Theubani (r.a.), i cili e shikonte i mërziur dhe i dëshpëruar në fytyrë të Dërguarin e Allahut (a.s.), edhe kur gjendej në kuvendin e tij.⁷ Theubani (r.a.), ia shprehu kështu të Dërguarit të Allahut (a.s.), shkakun e mërzi-jes dhe brengosjes së tij: “O i Dërguari i Allahut! Çdo moment që kaloj pa ty për mua është një ndarje më vete. Përderisa kjo është gjendja ime në këtë botë, atëherë mendoj duke u shqetësuar se në botën tjetër do të jem në një gjendje edhe më të vështirë. Ti atje do të jesh bashkë me pejgamberët. Ndërsa për mua nuk është e qartë se ku dhe në çfarë gjendjeje do të jem.” Pasi i dëgjoi këto fjalë, i Dërguari i Allahut (a.s.), i dha këtë përgjigje: *“Njeriu do të jetë me atë që e do.”*⁸

Ja pra, ky ajete fisnik dhe përgëzimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), aq sa e qetësuan zemrën e Theubanit, janë bërë dritë shprese edhe për besimtarët që e duan Pejgamberin (a.s.). Ndoshta edhe më e rëndësishmja, ato na mundësojnë që t'i kërkojmë llogari vetes dhe t'i bëjmë një vlerësim të përgjithshëm gjendjes sonë.

Pyetjet që duhet t'ia parashtrojmë vetes sot janë: Me kë shoqëro-hemi? Kë e duam për hir të Allahut? Kush janë ata për të cilët mërzi-temi kur nuk i shohim për pak kohë? A njohim njerëz shembullorë me të cilët nuk çmallemi dot edhe pse gjendemi pranë tyre?

Unë mendoj se kemi nevojë të menjëhershme për një “kontroll dashurie dhe interesimi”, sepse njeriu mund t'ua fitojë zemrat vetëm atyre për të cilët përpiqet. Këtu përfshihen edhe miqtë.

■ **REFERENCAT:** 6) Nisa, 69. 7) Vahidi, Esbabu'n-Nuzul, fq. 168-169. 8) Bu-hari, Edep, 96.



Dhuratat reciproke

— Shemsedin Kërësh —

Hibe do të thotë të japësh pa pritur ndonjë shpërblim. Atij që jep shumë i thuhet “vehhab”.¹ Hibe dhe hedije janë dy fjalë që kanë të njëjtin kuptim. Në Kuranin Fisnik flitet në lidhje me vendimin e mbretëreshës se Sebesë, Belkisës për t’i dërguar dhuratë Sulejmanit (a.s.).² Edhe kërkesa e një gruaje për t’u martuar me të Dërguarin e Allahut (a.s.), pa meher është shprehur me fjalën “hibe”.³ Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Përgjigjuni ftesës, pranojeni dhuratën dhe mos u gjuani myslimanëve në fytyrë.”*⁴ Gjithashtu ka thënë: *“Merreni gjënë që ju jepet pa e kërkuar, sepse ajo është rrësku që ua ka dhënë Allahu.”*⁵ Ndërsa veprimet që mund të konsiderohen si kërkim të kthimit prapa të dhuratës, nuk janë konsideruar të pranueshme.⁶

Kur bëhet fjalë për “hibe” në ditët e sotme, nënkuptohet dhënia dikujt e një pasurie që ka vlerë të madhe. Ndërsa kur bëhet fjalë për “hedije/dhuratë”, nënkuptohet diçka që dikush e ka blerë me para për t’ia dhënë dikujt tjetër. Praktika në Sunet ka disa ndryshime me praktikën e sotme. Në periudhën kur ka jetuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), hedije i thuhej një ushqimi apo robe që më së shumti jepej nga shtëpia, që kishte dobi për njeriun dhe që nuk merrej duke paguar para. Kur thuhej hedije, më shumë se një kujtim, nënkuptohej diçka që kishte dobi konkrete. Për shembull, edhe një tas me supë që fqinji mund t’ia jepte fqinjit të tij quhej “hibe” dhe “hedije”. Resulullahu (a.s.), ka kërkuar që të mos nënçmohet edhe tasi me supë që jepet dhuratë.⁷ Pejgamberi (a.s.) i urdhëronte njerëzit që t’i jepnin njëri-tjetrit dhurata dhe të shkëmbenin vizita me të afërmit.⁸ I Dërguari i Allahut (a.s.) dhe sahabët nuk i jepnin dhurata njëri-tjetrit gjëra që jepen sot si dhuratë. Ata përpiqeshin që gjëja e dhuruar të ishte diçka që plotësonte ndonjë nevojë. Për shembull, të ishte diçka për t’u ngrënë, për t’u pirë apo për

t’u veshur. Pejgamberi shprehej se gjërat e tilla e shtojnë dashurinë ndërmjet njerëzve.⁹

Në Epokën e Lumturisë dhuratat që merreshin me para ishin shumë të kufizuara. Dhëniet e dhuratave në mënyrë të ndërsjellë nuk ishte e nevojshme që patjetër të bëheshin me diçka materiale. Edhe kalimi i kohës me njëri-tjetrin konsiderohej si dhuratë. Në ditët e sotme pothuajse të gjitha dhuratat bëhen me para apo me gjëra që merren me para. Ndërsa në Epokën e Lumturisë përafërsisht qind për qind e dhuratave ishin në formën e ndihmës. Njerëzit për të bërë dhurata nuk e ndjenin të nevojshme që të dilnin nga shtëpia, të shkonin në treg dhe të blinin ndonjë gjë. Dhuratë bëhej çfarëdo që mund të gjendej në shtëpi. Në të vërtetë, kjo gjendje tregonte një shoqëri të natyrshme në të cilën ndihma reciproke ishte në shkallën më të lartë dhe në të cilën paraja përdorej pak.

Muhaxhirët shkuan te i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, dhe i thanë se ensarët i kanë marrë të gjitha sevapet për shkak të mirësive që kishin bërë. Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj kështu atyre: *“Edhe ju keni pjesë në atë sevap përderisa të luteni për ata dhe t’i falënderoni.”*¹⁰

I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka pranuar qumështin e devesë që iu dha si dhuratë.¹¹ Resulullahu (a.s.), e pranonte mishin që i jepej. Ai shkonte kur ftohej për të ngrënë ushqim. Madje, ai shkonte edhe nëse ftohej për të ngrënë supë.¹² Miqtë duhet ta posedojnë një afrimitet aq të sinqertë saqë t’i thonë njëri-tjetrit për t’ia dhuruar atë që dëshirojnë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka kërkuar mish nga kafsha që është therë dhe nuk ka hezitur ta bëjë këtë.¹³ Pejgamberi (a.s.) ka kërkuar qumësht prej njerëzve dhe pasi ka pirë vetë ia ka dhënë edhe atij që gjendej në krahun e djathtë të tij.¹⁴ I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka ngrënë mishin e lepurit të kapur përgjatë gjuetisë dhe që iu dhurua atij. Ai nuk hezitoi aspak për ta marrë atë.¹⁵

LLOJET E DHURATËS

Dhënia si dhuratë e një kafshe me qumësht dhe e një vreshti në proddhim, në mënyrë që të përfitojë marrësi, janë konsideruar prej veprave të mira që bëhen shkak për hyrjen në xhenet.¹⁶ Kafshës me qumësht që dhurohet, në mënyrë që të përfitojë marrësi, i thuhet “meniha”. Në Sunet gjendet edhe praktika “Umra” e cila do të thotë që dikush t’i japë dikujt tjetër një pasuri të paluajtshme si shtëpia apo diçka tjetër të ngjashme me të për ta përdorur sa të jetë gjallë.¹⁷ Gjithashtu në Sunet gjendet edhe praktika “Rukba” e cila mbart kuptimin që dikush t’i thotë dikujt tjetër në lidhje me një pasuri të paluajtshme si shtëpia apo të ngjashme me të: “Nëse unë apo ti vdes, kjo pasuri le të jetë e atij që do të mbetet gjallë.”¹⁸ Këto dy praktika janë debatuar nga aspekti i jurisprudencës islame. Imamllarët e medhhebeve kanë bërë studime në lidhje me to. Këtu ka një çështje që dëshirojmë ta shtjellojmë. Praktika Umra dhe Rukba nga një aspekt i ngjasojnë praktikës Meniha. Ndërkohë që në praktikën Meniha jepet një lopë apo dele me qumësht që të përfitojë marrësi, në praktikën Umra dhe Rukba jepet shtëpi në të cilën mund të banohet. Në ditët e sotme gjenden baballarë të cilët ua ndajnë shtëpitë fëmijëve të tyre. Ndërsa për shtëpinë në të cilën gjenden vetë, vendosin kushtin për të banuar pa qira përderisa të jenë gjallë. Andaj duket mjaft e logjikshme që fëmijët të zbatojnë praktikën “Umra” për prindërit e tyre që nuk kanë shtëpi.

Të Dërguarit të Allahut, (a.s.), iu është dhuruar djathë dhe gjalpë. Edhe ai i ka pranuar ata.¹⁹ Resullullahu (a.s.), e ka ngrënë atë që ishte dhuratë dhe nuk e ka ngrënë atë që ishte lëmoshë.²⁰ Ai nuk e ka refuzuar parfumin që iu bë dhuratë.²¹ I Dërguari i Allahut (a.s.), i la të lirë robërit nga fisi Hevazin pas kërkesës së parashtuar prej tyre. Falja e lirisë këtyre robërve ishte një dhuratë për ata.²² Shkëmbimi i dhuratave në mënyrë të vazhdueshme është prej traditës së Pejgamberit (a.s.).²³ Nëse babai dëshiron t’i japë diçka njërit prej fëmijëve të vet që është në nevojë, por shqetësohet në mos xhelozojnë fëmijët e tjerë, atëherë mund të veprojë në këtë mënyrë: Atë pjesë të pasurisë mund t’ia shesë një miku të tij duke mos ia marrë kundërvlerën. Ndërsa miku ia dhuron atij që ishte në nevojë.²⁴ Në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), është përjetuar një ngjarje e tillë. Pejgamberi nuk u ka dhënë aprovim

baballarëve që u japin pasuri disa prej fëmijëve të tyre dhe i bëjnë të xhelozojnë fëmijët e tjerë.²⁵ Një grua që ndan të njëjtin bashkëshort me një grua tjetër mund t’ia falë asaj një ditë prej atyre ditëve që burrit i takon të jetë me të.²⁶ Edhe ndarja e një pjese të kohës për dikë është dhuratë. Dhuratat duhet t’i japim duke filluar që nga fqinji më i afërt.²⁷

I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk e ka aprovuar marrjen e dhuratës nga nëpunësi i shtetit. Madje, e ka kritikuar ashpër atë që vepron kështu në këtë çështje.²⁸ Pejgamberi (a.s.) në një lloj mënyre i ka imponuar vajzën dhe dhëndrin e tij (Fatimenë dhe Aliun) që t’ua jepnin të tjerëve si dhuratë gjërat prej stolive që kishin në shtëpinë e tyre.²⁹ Shteti mund t’i dhurojë shtëpi një familjeje në nevojë.³⁰ Në dasmë mund të merren amanet nga dikush velloja e nuses dhe rrobat e dhëndrit për t’i përdorur.³¹ Ai që e jep rrobën e vet për t’u përdorur në këtë mënyrë, fiton sevape. Ebu Bekri (r.a.), i ka kryer premtimet që i Dërguari i Allahut (a.s.), nuk i ka kryer dot sa ishte gjallë. Në këto premtime gjendeshin kërkesat për dhurata.³²

Megjithëse dhurata dhe lëmoshja ngjajnë me njëra-tjetrën nga disa aspekte, kanë edhe anët e ndryshme të tyre. Dhurata që jepet për të fituar sevap është si lëmoshja. Andaj, atij që e jep këtë lloj dhurate i jepet sevapi i lëmoshës.³³ Dhurata nuk është farz, por është nafile pikërisht si lëmoshja. Ndërsa kur thuhet sadaka/lëmoshë farz, bëhet fjalë për zekatin dhe lëmoshën e fitrit. Nëse mbartet qëllimi për të nderuar me diçka për shkak të nderimit që ka shfaqur dikush, kjo është dhuratë. Ai që merr lëmoshë nuk ka ndonjë detyrim për të dhënë diçka për ta nderuar dhënësin e lëmoshës.

Përfundim: Në ditët e sotme dhuratat janë shndërruar në gjëra që merren pothuajse vetëm me para. Andaj, traditën për dhënien e dhuratave në mënyrë reciproke duhet ta bëjmë më të thjeshtë, më modeste dhe në një mënyrë që e plotëson ndonjë nevojë të caktuar. Praktikën në lidhje me dhënien e dhuratave në mënyrë të ndërsjellë duhet ta përshtatim me traditën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Dhuratat e ndërsjella nuk duhet t’i japim në ditë që nuk u përkasin traditave të myslimanëve si viti i ri, ditëlindje, etj. Ne duhet ta kuptojmë frymën profetike që gjendet në esencën e dhënies së dhuratave në mënyrë të ndërsjellë.

■ **REFERENCAT:** 1) Ibn Manzur, Lisanu’l-Arab, I, 803. 2) Nemi, 35. 3) Ahzab, 50. 4) Musned, I, 404 (hadithi nr: 3838); Hejsemi, IV, 52; Taberani, Mu’xhemu’l-Kebir, X, 197 (hadithi nr: 10444); Ibn Hibban, Sahih, XII, 418 (hadithi nr: 5603). 5) Bejhaki, es-Sunenu’l-Kubra, Hibat, 17 (hadithi nr: 11823). 6) Muslim, Hibat, 1. 7) Buhari, Hibe, 1. 8) Bejhaki, es-Sunenu’l-Kubra, Hibat, 1 (hadithi nr: 11725). 9) Bejhaki, es-Sunenu’l-Kubra, Hibat, 1 (hadithi nr: 11727). 10) Bejhaki, es-Sunenu’l-Kubra, Hibat, 14 (hadithi nr: 11814). 11) Buhari, Hibe, 1. 12) Buhari, Hibe, 1. 13) Buhari, Hibe, 2. 14) Buhari, Hibe, 3. 15) Buhari, Hibe, 4. 16) Buhari, Hibe, 33. 17) Buhari, Hibe, 30. Muslim, Hibat, 28-29. 18) Bejhaki, es-Sunenu’l-Kubra, Hibat, 8 (hadithi nr: 11770). 19) Buhari, Hibe, 5. 20) Buhari, Hibe, 5. 21) Buhari, Hibe, 7. 22) Buhari, Hibe, 8. 23) Buhari, Hibe, 9. 24) Buhari, Hibe, 10. 25) Buhari, Hibe, 11. 26) Buhari, Hibe, 12. 27) Buhari, Hibe, 14. 28) Buhari, Hibe, 15. 29) Buhari, Hibe, 25. 30) Buhari, Hibe, 29. 31) Buhari, Hibe, 32. 32) Buhari, Hibe, 16. 33) Buhari, Hibe, 28.



ROLI SOCIAL

i adhurimeve në Islam

— Ma. Fatmir Hadri —

Feja, gjatë gjithë historisë ka qenë një nga institucionet më të rëndësishme që ka prekur/ndikuar individët dhe shoqëritë. Sipas sociologut Joesph Fitcher, institucionet themelore që përbëjnë një shoqëri përgjithësisht janë familja, arsimiti, feja, ekonomia, politika dhe koha e lirë. Këto gjashtë institucione janë elementet që përbëjnë, rrethojnë shoqërinë dhe sigurojnë mbijetesën e shoqërisë.¹ Anën teorike të fesë e përbën besimi kurse anën praktike e përbejnë adhurimet. Këto dy elemente kryesore përbëjnë një tërësi të pandashme. Për këtë arsye, aspektet teorike e praktike të besimit dhe adhurimit janë të ndërlidhura mes vetes ose plotësuese ndaj njëra tjetrës. Me fjalë të tjera, feja bëhet objektive që nga ndarja e përvojës individuale me të tjerët dhe fiton një natyrë sociale.

Feja si një institucion socio-kulturor që prek si individët ashtu edhe shoqëritë është një faktor që drejton sjelljen e njerëzve në jetën e përditshme. Brenda sistemit shoqëror, çdo gjë (e hapur ose e

fshehur) ka një rol. Asnjë fakt / vlerë sociale nuk është bosh dhe pa kuptim. Atëherë besimet dhe adhurimet e shoqërisë kanë një rol të hapur, dhe shpesh të fshehur. Roli parësor i besimeve fetare është shprehja e parimeve themelore të një feje.

Feja është një lidhje shpirtërore me të shenjtën dhe është një fakt që ka shumë role shoqërore. Përveç kryerjes së adhurimeve si detyrë dhe obligim, ajo gjithashtu ka një numër rolesh që i manifeston si të fshehura dhe të hapura për individin dhe shoqërinë. Adhurimet në një anë i edukojnë individët ndërsa në anën tjetër e rregullojnë strukturën shoqërore në shoqëri.

Allahu xh.sh në Kuranin e Madhërishëm shprehet kështu: Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe japin zekatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.² Kurse Muhamedi (a.s.) thotë: Pastërtia është gjysma e besimit.³ Kush beson

1. Joesph Fitcher, Sosityoloji Nedir? Çev. Nilgün Çelebi, Attila Kitabevi, Ankara, 1994, s. 123.

2. Bekare, 277.

3. Muslim, Taharet, 1.

në Allahun dhe botën tjetër, le ta gostit mysafirin e tij. Kush beson në Allahun dhe botën tjetër të kujdeset për të afërmit e tij. Kush beson në Allahun dhe botën tjetër, ose të flasë mirë, ose të heshtë!⁴ Këto thënie tregojnë se adhurimet/veprat e mira mund të konsiderohet si mjete për të ushqyer besimin dhe për të lavdëruar moralin. Prandaj me adhurim nënkuptojmë bindje, nënshtrim ndaj urdhrave të Krijuesit. Sepse adhurimi është një qëndrim dhe sjellje që synon të paguajë borxhin e mirënjohjes ndaj Allahut dhe të tregojë dashuri dhe përkushtim. Në kuptimin sociologjik, është dimension i pasqyruar ose shprehja e përvojës fetare.⁵

ADHURIMET KONTRIBUJNË NË INTEGRIMIN SHOQËROR

Pa dyshim se adhurimet në një anë sistemojnë lidhjet e individëve me Allahun kurse në anën tjetër individët i integrojnë në shoqëri. Këtë integrim mund ta vërejmë edhe në fiset më primitive por edhe në vendbanimet e ndërtuara rreth një tempulli. Ceremonitë, simbolet, organizimet fetare janë tipare integruese të fesë. Rituale fetare dhe ceremonitë e kryera bashkërisht nga të gjithë anëtarët e shoqërisë sigurojnë kohezionin shoqëror midis individëve. Këto përmirësojnë frymën në grup dhe në këtë mënyrë feja siguron stabilitetin dhe vazhdimësinë e shoqërisë.⁶

Prandaj aq sa është i rëndësishëm në adhurime personaliteti dhe ndërgjegjja po aq i rëndësishëm është edhe shoqëria. Sepse thelbi i adhurimit nuk është në formën e tij, por në dimensionet e tij individuale dhe shoqërore. Ngase disa adhurimet mund të kryhen individualisht dhe disa prej tyre duhet të kryhen me shoqërinë. Si për shembull, namazi i së premtes dhe bajramit, kryerja e haxhit janë disa adhurime që duhet të kryhen së bashku me shoqërinë. Individu fiton një ndjenjë uniteti dhe solidariteti gjatë kryerjes së këtyre adhurimeve. Prandaj ky lloj i adhurimeve ia mundëson individit të integrohet në shoqëri ku me këtë individ heq dorë nga ndjenja e mbylljes dhe e vetmisë. Adhurimet individin jo vetëm që e afrojnë me Krijuesin, por gjithashtu e afrojnë edhe me njerëzit e tjerë. Fiset Evs dhe Hazreth që vazhdimisht ishin në konflikt me njëri-tjetrin në Medine iu përgjigjën ftesës së profetit që të bëhen mysliman dhe në këtë mënyrë ata u integruan në bashkëpunim me njëri tjetrin.

4. Buhari, Nikah 80, Edeb 31, 85, Rikak 23; Muslim, Iman 74, 75, 77.

5. Elmalılı Muhammed Hamdi Yazır, Hak Dini Kur'an Dili, İstanbul, 1935, C. I, s. 95.

6. Y. Mustafa Keskin, "Din Toplum İlişkileri Üzerine Bir Genelleme", Dinbilimleri Akademik Araştırma Dergisi, IV, Samsun, 2004, s. 14.

Ata u angazhuan rreth këtij parimi, u bënë vëllezër dhe me sinqeritet morën pjesë në integritetin shoqëror. Shpallja e profetit (a.s.) si vëllezër Ensarët dhe Muhaxhirët është hapi i parë drejt integritetit shoqëror. Menjëherë pas kësaj, në kohën e profetit (a.s.) ndërtimi i xhamisë këshillimi dhe menaxhimi i të gjitha ngjarjeve, realizimi i adhurimeve kolektive, prania e individëve në faljen e namazeve me xhemat luajtën rol të rëndësishëm në integrimin shoqëror. Faljet kolektive të së premtes, lutjet e hatmeve, takimet, mexhliet etj. tregojnë se feja është një element që mbron dhe mbështet integritetin shoqëror.⁷ Adhurimet kolektive kontribuojnë në arritjen dhe forcimin e barazisë sociale. Ndhimojnë integrimin shoqëror ku eliminohen ndjenjat dhe dallimet midis adhuruesve siç janë autoriteti, pozicioni ose epërsia racore.

Mund të thuhet se të gjitha urdhërimet, ndalimet, rekomandimet, namazi, agjërimi, zekati, haxhi, sakrificat, domethënë të gjitha adhurimet, të cilat janë përmendur në Kuran, janë faktorë për arritjen e integritetit shoqëror. Me faljen e namazit 5 herë në ditë njerëzit sigurohen të jenë së bashku pesë herë në ditë dhe kjo siguron bashkësi dhe integritet. Gjithashtu edhe agjërimi është i rëndësishëm për integrimin e njerëzve që kanë dallime ekonomike midis tyre. Në veçanti, gjatë agjëritit të pasurit e vlerësojnë më mirë situatën e të varfërve dhe kjo i nxitë më shumë t'ju ndihmojnë aty dhe në këtë mënyrë të sigurojnë një bashkim midis tyre. Kur mendojmë rëndësinë e zekatit nga pikëpamja e integritetit shoqëror shihet se ka një rëndësi të madhe nga pikëpamja e atij që e jep dhe atij që e merr. Allahu nuk i ka krijuar të gjithë njerëzit me të njëjtat aftësi dhe fuqi; ka dallime në fuqinë financiare të njerëzve si dhe në strukturat e tyre fizike. Njerëzit; ose janë të pasur, ose të varfër ose të mesëm.⁸ Shkurtimisht siç shihet në adhurimin e integritetit shoqëror, socializimi, uniteti, solidariteti dhe bashkimi janë pothuajse si çimentoja e një ndërtese.

ADHURIMET LARGOJNË NGA E KEQJA

Adhurimet individin e largojnë nga të këqijat. Prandaj adhurimet njerëzit i drejtojnë drejtë të mirës. Allahu i Plotfuqishëm dëshiron që myslimanët t'i bënë pastër me adhurime si dhe t'i plotëson bekimet e Tij mbi ata. Tendencat dhe sjelljet ekstreme si urrejtja, armiqësia, arroganca, tallja, alkooli, droga,

7. Bünyamin Ayhan, "Olaganüstü Durumlarda Toplumsal Dayanısma ve Bütünselmeye Basının Katkısı: Milli Mücadele Dönemi Türk Basını", s. 81.

8. Özcan Güngör, "Kuranda Sosyal Bütünselme", Diyanet İlimi Dergi, C. 40, Sayı: 3, Ankara, 2004, s. 14.

prostitucioni pengojnë vërejtjen e të drejtës si dhe parandalojnë kryerjen e veprimeve dhe sjelljeve të mira dhe të duhura. Këto sjellje bëjnë që zemrat të verbohën dhe ndërjegjija të errësohet. Prandaj secili prej adhurimeve në fenë tonë ndihmon në pastrimin e personit nga pikëpamja shpirtërore.

Në Kurani Allahu xh.sh thotë: (O Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kurani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irrituarat, e përmendja e Allahut është më e madhja (e adhurimeve); All-llahu e di ç'punoni ju. ⁹ Profeti (a.s.) njerëzit që falin namazin, agjërojnë dhe bënë punë të mira nga qëndrimet dhe sjelljet e tyre jo-fetare, jo korrekte në raport me njerëzit i paralajmëron kështu: Ka prej njerëzve që agjërojnë por që fitimet e tyre janë vetëm uria dhe etja.¹⁰ Përsëri në hadithet tjera profeti (a.s.) thotë kështu: “Agjërimi është mburojë, prandaj mos të abuzojë njeri, as mos të bjerë në injorancë! Edhe nëse dikush e sulmon a e shan, le t'i thotë: Unë jam agjërueshëm! ose Të agjërosh, nuk është vetëm të largohesh nga ushqimi e pija. Por, të agjërosh është kur largohesh edhe nga kacafytjet e fjalët e kota. ¹¹ Nga ajeti dhe hadithet e cekura më lartë kuptojmë se adhurimet e mbrojnë individin nga emocionet e dëmshme si dhe e parandalojë ata nga sjelljet e këqija. Kjo behet shkak që jeta sociale dhe kulturore të rregullohet brenda shoqërisë.

Gjithashtu adhurimet kanë efekte rregullatore, stabilizuese dhe drejtuese në karakterin njerëzor. Të gjitha adhurimet vetëdijen njerëzore e drejtojnë në të mirë dhe kjo vetëdije ata i bënë të pjekur, të drejt dhe të sillen bukur. Andaj personi që beson dhe adhuron Krijuesin e tij me vetëdije të plotë, vetvetiu do t'ju shmanget të gjitha mëkateve dhe të këqijave. Në saje të kësaj fiton mbështetje të madhe shpirtërore, forcon personalitetin, përmirëson durimin, filozofinë pozitive të jetës si dhe gëzimin.

ADHURIMET MËSOJNË NDARJEN, SOLIDARITETIN DHE NDIHMËN

Njëra nga adhurimet që i përfiton të mira individit dhe shoqërisë është ndjenja e ndarjes dhe solidaritetit. Sepse sa më shumë që ndajnë njerëzit lumturia rritet, solidariteti forcohet. Ato rrisin lumturinë në shoqëri. Shembull, Zekati, bamirësia, sakrifica dhe punët tjera të mira sikur këto, me kuptimin e plot të fjalës janë prej adhurimeve që mësojnë dhe jetësojnë ndihmën, solidaritetin dhe ndarjen. I dërguari i Allahut (a.s.) duke thënë: “Nuk është besimtar i

vërtetë ai që ngopet i tëri përderisa fqinji i tij i afërm është i uritur!” na ka treguar rendësin e ndihmës, solidaritetit dhe ndarjes¹².

Kurani vazhdimisht përsërit urdhrin: Faleni namazin, jepni zekatin”. Ky urdher tregon dhe shfaq unitetin e shpirtit dhe e trupit në një vend.

Për të ruajtur ekzistencën shoqërore në mënyrë të shëndetshme, ekuilibri shoqëror dhe paqja duhet të ruhen dhe faktorët që mund të shkaktojnë tensione emocionale midis individëve duhet të eliminohen. Është e natyrshme që në një shoqëri të ketë të pasur dhe të varfër. Por, nëse nuk u ndihmohet të varfërve dhe nëse nuk respektohen të drejtat e tyre atëherë shkaktohen tensione sociale-ekonomik.

Gjithashtu therja e kurbanit është një adhurim në të cilin shembulli i solidaritetit shoqëror dhe solidaritetit në Islam shihet në mënyrën më të mirë dhe më konkrete. Qindra mijëra kafshë theren çdo ditë në tokë, dhe kryesisht njerëzit e pasur përfitojnë prej tyre. Kurse nga therja e kurbanit përfitojnë të varfëritë dhe nevojtarët. Ndarja e kurbanit zhvillon/rrit ndjenjën e ndarjes dhe bujarisë të të pasurve kurse shkatërron paragjykimet kundër të pasurve që mund të bëhen nga të varfëritë. Kjo midis të pasurve dhe të varfërve zhvillon ndjenjat reciproke të dashurisë dhe respektit; siguron paqe dhe qetësi sociale; si dhe paqe dhe siguri shoqërore; në këtë kontekst, therja e kurbanit siguron realizimin e drejtësisë sociale. Kurhani, është një burim potencial i fuqisë që përfaqon tërë shoqërinë. Ashtu siç ringjallet jeta ekonomike me atë, ashtu me anë të sakrificës/therjes, plotësohen sado pak nevojat e nevojtarëve dhe nga kjo sigurohet një ekuilibër i brendshëm.


Si përfundim, edhe pse të gjitha adhurimet në Islam kanë të bëjnë kryesisht me individin, prapë se prapë ana tjetër e medaljes ka të bëjë me shoqërinë. Adhurimet, që janë elementet e domosdoshme të jetës fetare pas besimit, pasqyrojnë aspektin e marrëdhënies midis njeriut dhe Allahut, të cilat çojnë në botën e jashtme, dhe gjithashtu janë të rëndësishme për sa i përket rregullimit të marrëdhënieve të njeriut me shoqërinë. Ngase siç thamë edhe më herët, disa adhurime kryhen sipas gjendjes së kohës dhe hapësirës, e kjo i mundëson individit të marrë pjesë në shoqërizim dhe integritet shoqëror. Namazet kolektive zhvillojnë një ndjenjë të bashkëjetesës dhe vëllazërimit tek njerëzit dhe mësojnë ndarjen dhe solidaritetin shoqëror. Kështu që adhurimet kontribuojnë në socializmin e individit.

9. Ankebut, 45.

10. Ibn Maxhe, “Sijam”, 21.

11. Buhari, “Saum”, 2, 9; Muslim “Sijam”, 164.

12. Muslimi, Iman, 74.



SI I SHOHIM NGJARJET DHE JETËN?

ME FALËNDERIM, DURIM APO KUNDËRSHTIM?


— Ajsel Gyrgen —

Kundrejt fatkeqësive duhet të shfaqet durim dhe kundrejt mirësive duhet të bëhet falënderim ndaj Zotit (xh.xh.). Por ne e shohim jetën nga këndvështrimi i durimit ose nga ai i falënderimit në raport me faktin nëse i perceptojmë si fatkeqësi apo mirësi ngjarjet që i përjetojmë. Le ta shprehim më qartë: Në të vërtetë, a e kuptojmë se raskapitemi, tensionohemi dhe për shkak të këtyre edhe dëshpërohemi kur i shohim nga këndvështrimi i durimit shumë ngjarje me të cilat mund të bëheshim të lumtur po t'i shikonim nga këndvështrimi i mirësisë?

“Ne e dërguam Musain me shenjat Tona (dhe i thamë): “Nxirre popullin tënd nga errësira në dritë dhe përkujtoju atyre ditët e Allahut!” Vërtet, në këtë ka shenja për çdo njeri që është i durueshëm dhe falënderues.” (Ibrahim, 5)

Me siguri që e kujtoni historinë e Pollyannas që luante lojën e lumturisë duke e parë me pozitivitet jetën dhe ngjarjet. Këtë histori e kemi lexuar në fëmijëri. Pra, vajza e vogël që gjente një anë pozitive e cila e bënte të lumtur për çdo ngjarje që përjetonte dhe që në këtë mënyrë ia dilte mbanë për të marrë kënaqësi nga jeta. Këtë këndvështrim sot mund ta shprehim: “Të bëhesh i lumtur duke menduar pozitivisht për anën e mbushur të gotës ngaqë është gjysmë e mbushur, në vend që të bëhesh pesimist duke parë gjysmën boshe të saj.” Në të vërtetë, këndvështrimi që myslimani ka kundrejt ngjarjeve dhe jetës kështu është, apo thënë ndryshe, kështu duhet të jetë. Kur myslimani të përballlet me një ngjarje që e vë në pozitë të vështirë, e di se kjo është një sprovë dhe duron. Në Kuranin Fisnik gjenden shumë ajete që flasin për durimin. Ajeti i 5-të i sures Ibrahim që e kemi dhënë të përkthyer më sipër, na tregon se durimi dhe falënderimi janë të ndërthurur me njëri-tjetrin. Le ta shpjegojmë pak më shumë:

Disa komentues të Kuranit Fisnik duke u nisur nga shprehja: “Vërtet, në këtë ka shenja për çdo njeri që është i durueshëm dhe falënderues.”, e cila përmendet në fund të ajetit fisnik që e kemi dhënë më sipër, kanë thënë se koha e cila synohet në shprehjen “ditët e Allahut” që përmendet po në këtë ajet, është edhe periudha e vështirë që Beni Israilët (çifutët) e kanë kaluar nën zullumin e Faraonit, edhe periudha kur kanë shpëtuar prej tij dhe kanë arritur lumturinë.



*Kur besimtari
përballet me një
ngjarje që e vë
në pozitë të vështirë,
e di se kjo është një
sprovë dhe duron.*

*Kurse ne ia bëjmë zeher jetën
vetes dhe jetojmë të tensionuar
ndërkohë që kemi mundësi
ta shohim pozitivisht atë
dhe të bëhemi të lumtur.*

Nëse do të shohim mesazhin që na jep sot ky ajet, kuptohet se ditët e Allahut janë ose ditë të vështira në të cilat kërkohet të bëjmë durim, ose ditë të këndshme në të cilat kërkohet të bëjmë falënderim. Këtë detaj na e jep shprehja: “Çdo njeri që është i durueshëm dhe falënderues.” Domethënë se jeta jonë nganjëherë kalon me durim dhe nganjëherë tjetër kalon me falënderim ndaj Zotit (xh.xh.). Në të vërtetë, ajo që kërkon Allahu Teala prej nesh është që të arrijmë lumturinë e përhershme në botën e përtejme duke u shpërngulur me fitim nga kjo botë pasi të bëjmë durim kundrejt fatkeqësive dhe ta falënderojmë Atë për mirësitë.

Sigurisht që kundrejt fatkeqësive duhet të shfaqet durim dhe kundrejt mirësive duhet të bëhet falënderim ndaj Zotit (xh.xh.). Por ne e shohim jetën nga këndvështrimi i durimit ose nga ai i falënderimit në raport me faktin nëse i perceptojmë si fatkeqësi apo mirësi ngjarjet që i përjetojmë. Le ta shprehim më qartë: Në të vërtetë, a e kuptojmë se rraskapitemi, tensionohemi dhe për shkak të këtyre edhe dëshpërohemi kur i shohim nga këndvështrimi i durimit shumë ngjarje me të cilat mund të bëheshim të lumtur po t’i shikonim nga këndvështrimi i mirësisë? Këtë le ta shpjegojmë edhe me një shembull. Më ka treguar një shoqe:

“Kur e mora vesh se isha shtatzënë me fëmijën e pestë, pothuajse përjetova një gjendje shoku. Presioni që më bënin njerëzit përreth kur isha shtatzënë me fëmijën e katërt, ma pati nxirë jetën. Kishte prej atyre që më thoshin: “Mjerë për ty! Sa gjynah!” Kishte edhe prej atyre që përpiqeshin të më gjenin rrugëzgjidhje sikur unë nuk dija asgjë. Po ashtu kishte edhe prej atyre që e tepronin dhe më qortonin duke më thënë: “Si mund të bësh kaq shumë fëmijë në këtë kohë?” Në fakt, fëmijën e katërt ia patëm kërkuar vetë Zotit (xh.xh.). Ndërsa fëmijën e pestë Zoti i Madhëruar na e fali pa e kërkuar ne.

Në fillim qava, por pastaj fillova ta ngushëlloja veten. Merrja frymë thellë dhe thosha: “Sprovë nga Zoti!” Në këtë mënyrë përpiqesha ta qetësoja veten. Edhe një ditë tjetër kur e ndjeva veten keq, mora frymë thellë dhe thashë: “Sprovë nga Zoti!” Në ato momente ndjeva një frymëzim që më erdhi nga Allahu dhe që mu duk sikur më ra një tokmak në kokë: “Çfarë është ajo që ti e konsideron sprovë? Zoti të ka dhënë një fëmijë si mirësi, ndërsa ti e quan sprovë. Ç’është ky gjykim i tillë? A e kënaq Allahun ky lloj të gjykuari? Nëse të jep një fëmijë sakat, atëherë do ta shohësh se çfarë është sprova.”

Në ato momente u ndjeva sikur më kishin goditur në kokë. Menjëherë u pendova, i kërkova falje Allahut (xh.xh.), dhe nuk thashë qoftë edhe një herë tjetër: “Sprovë nga Zoti!” Falënderimi i takon Zotit të Lartësuar që edhe fëmijën e pestë ma fali me shëndet të plotë.

Nëna që na e tregoi këtë shembull së pari e kishte parë ngjarjen nga këndvështrimi i durimit. Pastaj Allahu Teala ia kishte mundësuar që ta shikonte nga këndvështrimi i falënderimit. Ndërsa për njerëzit që nuk mund t’i shohin ngjarjet nga këndvështrimi i durimit dhe falënderimit, ka edhe një alternativë tjetër. Kjo alternativë tjetër është kundërshtimi i Zotit. Këndvështrimi i kundërshtimit të Zotit është shumë i gjerë. Dimensioni i kësaj gjerësie ndryshon te të gjithë në raport me besimin dhe guximin që kanë. Dikush i vret njerëzit pa iu trembur syri, dikush tjetër shkatërron pa pasur frikë, etj.

Në të vërtetë, në jetën tonë ka shumë gjëra që ne i konsiderojmë të këqija ndërkohë që janë mirësi. Le të japim edhe një shembull tjetër: Gruaja që e ka fëmijën e vogël, në mëngjes e përcjell bashkëshortin e saj për në punë. Pastaj e pastron fëmijën që zgjohet akoma pa e mbledhur ajo shtëpinë, i jep gjë dhe përpiqet ta vërë në gjumë, në mënyrë që të bëjë punët e shtëpisë. Në momentin kur mendon se e ka zënë gjumi, ajo përpiqet ta vendosë në shtrat, por përsëri fillon t’i japë gjë fëmijës ngaqë menjëherë zgjohet dhe fillon të qajë. Ngaqë e përsërit disa herë këtë, koha e drekës pothuajse vjen. Ndërkohë fëmija akoma kërkon gjë.

Tashmë kjo nëna ose do ta shohë çështjen nga këndvështrimi i durimit duke i ekzagjeruar në sytë e saj punët që ka për t’i bërë dhe do të hyjë në tension, ose do të luajë si një fëmijë me foshnjën e saj e do të kënaqet me të duke thënë: “Punët do t’i bëj kurdo që të mundem. Ndërsa fëmija do të rritet. Edhe këto ditë do të kalojnë.” Domethënë, ose do të lodhet dhe tensionohet duke e parë ngjarjen nga këndvështrimi i durimit, ose do të bëhet e lumtur duke e parë atë nga këndvështrimi i falënderimit.

Tani po më vjen sikur po i dëgjoj ato që thonë: “Shtëpia është rrëmujë. Erdhi koha e drekës, por ushqimi akoma nuk është bërë. Bashkëshorti do të

vijë pas pak për të ngrënë dhe do të më bërtasë duke më thënë: 'A edhe një pjatë ushqim nuk mund ta bësh?' Ndërsa ti na thua që të luajmë si fëmijë me foshnjën." Përgjigjja ime për këto zonja është:

"Keni të drejtë, por a ndryshon rezultati nëse nxeheni dhe tensionoheni? A fle fëmija dhe a nuk bërtet bashkëshorti nëse tensionoheni?" Këtu ka dy alternativa: Ose do të nxehesh dhe do të shkatërrosh veten, ose do të ndjesh lumturi duke e rritur fëmijën me puthje e kënaqësi. Ndërkohë gjendet edhe një alternativë e tretë e cila është që ta shikosh këtë çështje nga këndvështrimi i kundërshtimit të Zotit. Andaj mund të zgjidhni kë të dëshironi.

Ne ia bëjmë zeher jetën vetes dhe jetojmë të tensionuar ndërkohë që kemi mundësi ta shohim pozitivisht atë dhe të bëhemi të lumtur. Le ta shohim edhe këtë tablo: Zonja e shtëpisë që përipiqet për ta fshirë dhe pastruar shtëpinë në mëngjes, i bën këto punë duke u ankuar. Nga ana tjetër bërtet duke iu nxehur fëmijëve që e bëjnë shtëpinë rrëmujë dhe u thotë: "Mos vallë babai juaj ka ndonjë shërbëtorë që i bën këto punë?.." Në këtë mënyrë, i nxehet edhe bashkëshortit të saj që nuk e ndihmon në punët e shtëpisë.

Këto lloje ankesash janë shndërruar në zakone klasike të shumë zonjave. Tani ejani dhe ta shohim së bashku ngjarjen nga këndvështrimi i falënderimit. Këto zonja duhet të mendojnë së mbi të gjitha kanë shëndetin dhe fuqinë për ta pastruar shtëpinë. Po ashtu, duhet ta mendojnë edhe faktin se kanë edhe një shtëpi në të cilën mund të banojnë. Përveç të tjerash, duhet ta falënderojnë Zotin që u ka dhënë edhe fëmijë. Siç dihet, fëmijët do të bëjnë të tyren. Këto zonja kanë edhe një bashkëshort që në mëngjes shkon në punë dhe në mbrëmje kthehet në shtëpi. Andaj, nuk duhet ta harrojnë se mirësitë kanë edhe vështirësitë e veta.

Një grua që i kishte vdekur bashkëshorti gjendej e vetme në shtëpi ngaqë fëmijët i kishte të martuar. Ndërkohë, ajo kishte frikë të qëndronte vetëm në shtëpi. Andaj natën në përgjithësi shkonte te shtëpia e fëmijëve të saj. Ajo gjithmonë qante e qante. Një zonjë tjetër që ishte po në të njëjtën gjendje, i kishte thënë:

"A ke shtëpi? A ke pension?" Kjo i ishte përgjigjur: "Po, i kam." Zonja tjetër ia kishte kthyer: "Atëherë përse qan vazhdimisht? Edhe unë jam në të njëjtën gjendje me ty, por me thënë të drejtën jam shumë e lumtur. Kur dua, shkoj dhe shtrihem për të fjetur. Kur dua ngrihem dhe fal namaz nate. Në mëngjes ngrihem kur të dëshiroj dhe përgatis ushqimin. Pënderisa Allahu të mi lërë këmbët e duart që t'i shërbej vetes, nuk shkoj të qëndroj te fëmijët. Biri më thotë: "Nënë, dimrit të paktën rri te ne." Allahu na ruajt! Më mirë preferoj të jetoj e lirë në shtëpinë time se sa në atë zhurmë që bëjnë njerëzit kur ngrihen në mëngjes."

Siç e shikojmë edhe nga kjo bisedë që ka ndodhur ndërmjet këtyre dy zonjave që ishin në të njëjtën gjendje, por që i kishin të ndryshme këndvështrimet, njëra qante vazhdimisht ngaqë i shikonte ngjarjet nga këndvështrimi i durimit, kurse tjetra kënaqej nga të qenët e lirë duke i parë ngjarjet nga këndvështrimi i falënderimit ndaj Zotit (xh.xh.).

Një fjalë e urtë thotë: "Njeriu nuk mund të vdesë me atë që vdes." Po! Ne mund të mërzitemi për atë që ka vdekur, por deri kur mund të mbajmë zi? Ne do të jetojmë aq sa Allahu do të na japë jetë. Kur t'i plotësojmë ditët e jetës, atëherë që të gjithë do të largohemi nga kjo botë. Secili prej nesh ka vendin e tij. Ndarja është e hidhur, por një mikështa ime thoshte: "Allahu mos na dhëntë ndarje në ahiret!" Sa metodë e mrekullueshme për të ngushëlluar! Ja pra, edhe kjo është një lloj mënyre për t'i parë ngjarjet nga këndvështrimi i falënderimit, apo jo?

Ndërsa tani në fund dëshiroj të jap edhe shembullin e një gruaje të moshuar që e shikonte jetën nga këndvështrimi i falënderimit ndaj Zotit (xh.xh.). Ajo e shikonte jetën kaq shumë nga ky këndvështrim saqë prej falënderimit nuk i jepej mundësia për të menduar rreth durimit. Ajo jetonte e vetme në shtëpinë e saj. Ajo kishte thyer edhe këmbën. Për shkak se nuk i kishte zënë mirë, kishte mbetur sakt. Te tualeti që e kishte në qoshen tjetër të oborrit, arrinte të shkonte zvarrë ngaqë ulej mbi një shilte të mbështjellë me najlon. Një dhomë të shtëpisë e kishte mbajtur për vete, ndërsa dhomat e tjera ia kishte dhënë me një qira të ulët një çifti të varfër. Të gjithë të ardhurat e saj përbëheshin nga kjo qira. Ajo nuk ankohej asnjëherë për fëmijët që secili prej tyre gjendej në botën e vet. Një herë e patëm vizituar përgjatë festës së Bajramit të Fitrit. Babai im e pyeti: "Si jeni zonjë?" Ajo u përgjigj: "Elhamdulillah!" Këtë falënderim e shoqëronte buzëqeshja që iu shfaq në fytyrë, drita që i shkëlqente në sy dhe toni i zërit që dëshmonte për ndjenjën e falënderimit që kishte në zemër. Pastaj shtoi: "Agiërimin e kam mbajtur përgjatë gjithë Ramazanit. Namazin e teravive e kam falur. Kuranin e kam lexuar. Çfarë t'i kërkoj më shumë Allahut, zotëri?" Ky ishte momenti kur fjalët merrnin fund...

Nëse këtë e përkufizoj si marrje kënaqësie nga falënderimi ndaj Zotit (xh.xh.), mendoj se nuk e ekzagjeroj. Këtë e them ngaqë ajo kishte shumë gjëra në jetën e saj për të cilat mund të ankohej. Madje kishte aq shumë saqë nuk mund t'i numëronim. Edhe pse kanë kaluar më shumë se tridhjetë vjet, akoma nuk e harroj dot këtë ngjarje. Duke shpresuar që t'i kuptojnë mirësitë që posedojnë ata të cilët shfaqin mosmirënjohje ndaj Zotit (xh.xh.), edhe pse notojnë në mirësi, ju kërkoj që t'i këndonin një Fatiha shpirtit të kësaj zonje për të cilën fola në shembullin e fundit.



Mirë se erdhe nxënës i dijes:

Safuan ibn Assali

- R A D I J A L L A H U A N H U

— Mustafa Erish —

Safuan ibn Assali (r.a.), ishte një sahab që fitoi lavdërimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili i tha: “Mirë se erdhe nxënës i dijes!” Ai ishte një nxënës i dijes që transmetoi hadithin fisnik për fshirjen e mesteve përgjatë marrjes së abdestit!.. Ai ishte një fatlum që i shërbeu të Dërguarit të Allahut (a.s.), në luftë dhe në paqe duke i hedhur ujë në duart e begata të tij për të marrë abdest!..

Safuan ibn Assali (r.a.), i përkiste degës Beni Dahir të fisit Murad që jetonte në anët e Jemenit. Se si është bërë mysliman dhe se kur është njohur me të Dërguarin e Allahut (a.s.), nuk dihet. Në literaturën islame thuhet se ka transmetuar njëzet hadithe dhe se ka marrë pjesë në dymbëdhjetë luftëra së bashku me Resulullahun, (a.s.). (Ibn Sa’d, VI, 103; Isabe, III, 353.)

Ndërmjet haditheve që ka transmetuar, më i njohuri është transmetimi në lidhje me fshirjen e mesteve, me mirësinë e dijes dhe me pendimin. Këtë hadith fisnik në të cilin shpjegohen këto tri tema së bashku, e ka transmetuar Zirr ibn Hubejshi (r.a.), i cili ka qenë prej tabiinëve. Në veprën me titull “Përktimi dhe Shpjegimi i Rijazu’s-Salihin” ky hadith fisnik transmetohet kështu së bashku me shpjegimet përkatëse:

Zirr ibn Hubejshi, rahmetull-llahi alejh, ka thënë: “Shkova te Safuan ibn Assali (r.a.), për ta pyetur

se si fshihen mestet (me dorë të lagur kur merret abdest). Ai më pyeti: “O Zirr! Përse ke ardhur?” Unë iu përgjigja: “Për të marrë dije.” Ai më tha: “Engjëjt i mbulojnë me flatrat e tyre ata që mësojnë dije ngaqë i pëlqejnë.”

Unë i fola atij për pyetjet që më preokuponin mendjen. Ndër të tjera i thashë: “Mendja më është bërë lëmsh në lidhje me fshirjen e mesteve pas (prishjes) së abdestit të madh dhe të vogël. Andaj kam ardhur të të pyes nëse ke dëgjuar gjë për këtë çështje ngaqë je prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.).”

Safuan ibn Assalit (r.a.), i pëlqeu kjo pyetje. Ai mu përgjigj duke më thënë: “Po, kam dëgjuar. Kam qenë në një luftë së bashku me të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Ai më ka urdhëruar që të mos i nxjerr mestet tri ditë e tri net, t’i fshij mestet kur të marr abdest pas prishjes së abdestit të madh e të vogël dhe pas gjumit dhe që t’i heq kur të bëhem xhunub.” (Tirmidhi, Taharet, 96.)

Zirr ibn Hubejshi (r.a.), i tha Safuan ibn Assalit (r.a.): “A e ke dëgjuar atë të thotë diçka rreth dashurisë?” Safuani (r.a.), i tha: “Po, e kam dëgjuar. Kur një ditë gjendesha pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), erdhi një beduin dhe bërtiti me një zë të çjerrët: “O Muhamed!” Edhe Pejgamberi ynë i dashur

i tha atij pothuajse me të njëjtin ton zëri: “Eja!”

Unë u ktheva nga beduini dhe i thashë: “Turp të kesh! Gjendesh para të Dërguarit të Allahut. Ule zërin! Allahu e ka ndaluar t’i flasësh me zë të lartë.” Beduini tha: “Për Zotin nuk e ul zërin.” Pastaj u kthye nga i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: “Çfarë thua për dikë që i do disa, por që nuk ka kaq mirësi sa të gjendet së bashku me ata?” Pejgamberi, (a.s.), i tha: “Njeriu në ditën e kiametit do të jetë me ata që do.”

Zirr ibn Hubejshi (r.a.), ishte një bedevi prej brezit të tabiinëve dhe që jetonte në shkretëtirë. Edhe pse ka jetuar në periudhën e xhahilijetit dhe në periudhën e Islamit, nuk e ka parë dot të Dërguarin e Allahut (a.s.). Por ai është takuar me sahabë të mëdhenj si Omeri, Aliu, Osmani dhe Ubej ibn Ka’bi, radijall-llahu anhum. Zirr ibn Hubejshi (r.a.), ka transmetuar hadithe nga ata. Kur shkoi në Medine, u takua me Safuan ibn Assalin (r.a.) dhe e pyeti nëse e kishte parë apo jo të Dërguarin e Allahut (a.s.). Safuan ibn Assali i tha se kishte marrë pjesë në dy mbëdhjetë luftëra së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.).

Zirr ibn Hubejshi (r.a.), e la jetën e shkretëtirës dhe u përpoq t’i plotësonte mangësitë e tij duke marrë dije nga sahabët që takonte. Kur shkoi te Safuan ibn Assali (r.a.), Safuani e pyeti se përse kishte ardhur. Zirri (r.a.), iu përgjigj duke i thënë se kishte shkuar për të marrë dije. Safuan ibn Assali (r.a.), së pari deshi ta përgëzonte për këtë veprim të bukur. Pastaj i tregoi një hadith që fliste për vlerën e marrjes së dijes të cilin e kishte dëgjuar vetë pikërisht nga i Dërguari i Allahut (a.s.).

Zirr ibn Hubejshi (r.a.), e pyeti nëse kishte dëgjuar apo jo ndonjë hadith nga i Dërguari i Allahut (a.s.), në lidhje me çështjen e dashurisë. Safuan ibn Assali (r.a.), nuk u mjaftua vetëm duke i treguar hadithin që e kishte dëgjuar nga Pejgamberi (a.s.), por i tregoi edhe se si e kishte dëgjuar atë nga Resulullahu (a.s.). Safuan ibn Assali (r.a.), i tha:

Një beduin që nuk e njihnte mirësjelljen dhe edukatën ngaqë jetonte në shkretëtirë, deshi ta pyeste Profetin, (a.s.), në lidhje me një çështje që ishte kureshtar. Për shkak se nuk e dinte se si duhej t’i fliste të Dërguarit të Allahut (a.s.), i tha duke bërtitur: “O Muhamed!” Safuani e paralajmëroi atë dhe i tha se Kurani Fisnik i ka ndaluar sjelljet e ashpra të këtij lloji. Atij i kujtoi ajetin: **“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe**

mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëritjetrin...” (Huxhurat, 2) Pastaj e këshilloi që ta ulte zërin. Ndërsa beduini, për shkak të karakterit të ashpër, u betua: “Për Zotin, nuk e ul zërin.”, për t’i treguar atij se askush nuk mund ta ndalonte për ta pyetur Pejgamberin (a.s.), në lidhje me çështjen që dëshironte ta mësonte.

Pejgamberi ynë i dashur, i cili ishte shumë i mëshirshëm ndaj umetit, e kuptoi se beduini nuk dinte gjë për këtë ajet fisnik. Për shkak se nuk dëshironte që ai të binte në mëkat, e ngriti tonin e zërit si beduini dhe i tha: “Eja!”

Beduini duke menduar se nuk do të gjendej dot së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe sahabët në ahiret, e shprehu problemin e tij duke pyetur: “Çfarë thua për dikë që i do disa, por që nuk ka kaq mirësi sa të gjendet së bashku me ata?” Përgjigjja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), ishte aq e ngrohtë sa që u dha shpresë të madhe të gjitha zemrave besimtare:

“Njeriu në ditën e kiametit do të jetë me ata që do.”

Ky hadith fisnik që shikohet se është transmetuar më vete nga tre sahabë, tregon se dashuria ndaj të Dërguarit të Allahut (a.s.), mund ta ngrejë njeriun në grada shumë të larta.

Sipas transmetimit të Enes ibn Malikut (r.a.), një beduin e pyeti të Dërguarin e Allahut (a.s.): “Kur do të bëhet kiameti?” Resulullahu (a.s.), ia ktheu: “Çfarë ke përgatitur për kiametin?” Beduini iu përgjigj: “Kam përgatitur dashurinë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij.” Nisur nga kjo përgjigje, i

Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha: *“Atëherë do të jesh me atë që do.”*

Allahu qoftë i kënaqur me ata beduinë! Po të mos i pyesnin këto pyetje që kishin në mendje, shumë zemra të djegura nuk do të freskoheshin në këtë mënyrë dhe nuk do të gjallëroheshin me dritën e shpësës. Sahabët e nderuar u gëzuan jashtë mase kur e dëgjuan këtë hadith fisnik. Madje sipas Enesit, radijall-llahu anhu, nuk janë gëzuar kështu me asnjë gjë tjetër përveç nderimit me Islam. Enesi (r.a.), e ka shprehur si më poshtë gëzimin e tij:

“Unë e dua Allahun, të Dërguarin e Tij, Ebu Bekrin dhe Omerin. Edhe pse nuk i bëj dot ibadetet dhe veprat madhështore që kanë bërë ata, shpresoj të jem bashkë me ata.”

Domethënë se dashuria ka një fuqi të jashtëzakonshme që i gjallëron zemrat e sëmura dhe që e

Safuan ibn Assali (r.a.), ishte një sahab që fitoj lavdërimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili i tha: “Mirë se erdhe nxënës i dijes!” Ai ishte një nxënës i dijes që transmetoi hadithin fisnik për fshirjen e mesteve përgjatë marrjes së abdestit!.. Ai ishte një fatlum që i shërbeu të Dërguarit të Allahut (a.s.), në luftë dhe në paqe duke i hedhur ujë në duart e begata të tij për të marrë abdest!..

shpie njeriun me siguri te qëllimet të cilat arrihen me vështirësi. Lum për ata që e duan Allahun dhe të Dërguarin e tij me gjithë zemër!.. (Përkthimi dhe Shpjegimi i Rijazu's-Salihin, vëll. 1, fq. 196-205.)

Edhe një hadith tjetër që e ka transmetuar Safuan ibn Assali (r.a.), është siç vijon. Një çifut i tha një shoku të vet çifut: “Eja të shkojmë te ky Pejgamberi!” Që të dy shkuan te i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e pyetën për nëntë shenjat e përbashkëta ndërmjet myslimanëve dhe çifutëve. Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), u dha përgjigje, i puthën duart e këmbët dhe i thanë: “Dëshmojmë se ti je një Pejgamber i vërtetë.” (Tirmidhi, Isti'zan, 33; Ibn Maxhe, Edeb, 16; Musned, IV, 240.)

Në shpjegimin e këtij hadithi fisnik thuhet: Në këtë hadith që Imam Neveviu (r.a.), e ka marrë nga Suneni i Tirmidhiut, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka shpjeguar nëntë gjërat që ia pyetën çifutët dhe një çështje që ata e mbanin të fshehtë. Për këtë arsye, ata i puthën duart dhe këmbët. Këta janë dhjetë urdhrat që ata i dini shumë mirë. Në nëntë prej këtyre myslimanët dhe çifutët kishin të përbashkëta. Ndërsa njëra u përkiste vetëm çifutëve. Mesa mësojmë nga hadithi, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u ka thënë atyre:

“Mos i bëni shirk Allahut me asnjë gjë, mos vidhni, mos bëni imoralitet, mos e vritni njeriun me të padrejtë ngaqë Allahu e ka bërë haram këtë, mos shkoni te dikush i fuqishëm për të vrarë ndonjë tjetër, mos bëni magji, mos e hani kamatën, mos shpifni për një grua të martuar e të ndershme duke thënë se është e pandershme dhe mos ikni nga mejdani i luftës në momentin kur beteja bëhet ashpërsohet. Po ashtu, mos shfaqni mangësi në respektin ndaj ditës së shtunë që është obligim veçanërisht për çifutët.” (Përkthimi dhe Shpjegimi i Rijazu's-Salihin, vëll. 4, fq. 596-597.)

Në literaturën islame thuhet se Safuan ibn Assali, radijall-llahu anh, në periudhën e fundit të jetës ka shkuar në Kufe. Ndërsa për jetën e tij pas shkuarjes në Kufe nuk ka asnjë të dhënë. Gjithashtu nuk gjendet ndonjë e dhënë në lidhje me faktin se ku dhe kur ka ndërruar jetë. Vetëm transmetohet se ndërmjet atyre që kanë marrë hadithe nga ai është edhe sahabi i njohur Abdullah ibn Mes'udi (r.a.) dhe tabiinët si Zirr ibn Hubejshi (r.a.) e Abdullah ibn Seleme (r.a.). (Isabe, III, 353.)

Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu na dhëntë përpjekjen dhe singëritetin e Safuan ibn Assalit (r.a.), i cili ishte udhëtar i dijes dhe na bashkoftë me të në xhenet! Amin!

Të gjithë nënat dhe baballarët, mësuesit, udhëheqësit, imamlarët dhe muezinët që sot dhe nesër janë të ngarkuar me detyrën për ta vazhduar kauzën e pejgamberëve, janë të obliguar për të ndjekur këtë rrugë. Shprehjet që përdoren, fjalët që zgjidhen dhe metodat që preferohen nuk duhet të përbëjnë justifikim për njerëzit që e kanë shkatërruar ahiretin e tyre.

Zoti (xh.xh.), e ka krijuar njeriun në formën që ka dëshiruar. Allahu i ka dhënë formë strukturës fizike të njeriut. Ai ia ka vendosi organet e brendshme. Truri dhe sytë, veshët e gjuha që janë të lidhur me trurin, janë vepër e Atij. Edhe njeriut të parë, edhe fëmijës së fundit të këtij njeriu është Allahut që ua ka dhënë formën. Ne e besojmë këtë, elhamdulillah. Në të njëjtën kohë ka edhe një të vërtetë tjetër që e besojmë: Krijimi dhe formimi që Allahu i Lartësuar i ka bërë njeriut është një urtësi. Çdo gjë që Zoti (xh.xh.), ia jep njeriut është urtësi. Për asgjë nuk bëhet fjalë të jetë pa urtësi. Njeriu të cilin e emërtojmë si të shëndetshëm dhe njeriu të cilin e quajmë “me aftësi të kufizuara”, gjenden brenda kornizës së të njëjtës urtësi.

Edhe vlerat që diskutohen si psikologji e njeriut gjenden brenda fushës së kësaj urtësie. Çdo gjë që i përket njeriut si buzëqeshja, nervat, reagimet, dëshpërimet, mungesa e durimit apo vetë durimi, qeshja, qarja, dashuria, urrejtja, sjellja sikur është dikush tjetër kur ka uri dhe çdo gjë tjetër e ngjashme me këto, janë prej veprave të Zotit që i bën me vullnetin e Tij dhe duke i mbështetur te ndonjë urtësi. Ne kështu besojmë. Përderisa të mos besojmë në këtë mënyrë, nuk mund ta pranojmë se kemi një besim të plotë. Allahu Teala nuk bën ndonjë vepër me mangësi. Ai nuk bën asnjë gjë pa urtësi. Të gjithë njerëzit që nga njeriu i parë e deri te njeriu i fundit gjenden brenda këtij rregulli.

Njeriu inatçi, njeriu që nuk dëshiron të dëgjojë, njeriu që nuk kupton, njeriu që nuk dëshiron të kuptojë, njeriu që e ka bërë dembelizmin stil jete, njeriu që është i rritur në moshë por që truri i ka



Pija

e të dërguarve të Allahut

— Nuredin Jëlldëz —

mbetur i vogël dhe njeriu që zemra e tij akoma nuk e ka arritur pjekurinë, janë njerëz që i ka krijuar Allah (xh.xh.). Këta njerëz Allahu Teala i ka krijuar në të njëjtat toka me njeriun që i ka sytë e lagur prej lotëve nga frika ndaj Zotit, me njeriun që e ka zemrën e butë, që e ka veshin e hapur ndaj zërit dhe që përpiqet të kuptojë. Të gjithëve u ka dërguar të njëjtin peygamber. Të gjithë i ka ftuar të i njëjti xhenet.

Pikërisht këtu është edhe urtësia. Sipas nesh në pah ka dalë një situatë e ngatërruar, ndërsa sipas Atij ka dalë një plan i mrekullueshëm prej detit të urtësisë. Zoti (xh.xh.), ka nxjerrë para peygamberëve që i ka dërguar si përfaqësuesit e Tij, shoqëri që formoheshin prej njerëzve ngjyra-ngjyra. Pastaj i ka urdhëruar peygamberët që t'u flasin masave të gjera në të cilat gjendeshin ata që dëgjonin dhe ata që nuk donin të dëgjonin, ata që shikonin dhe ata që nuk donin të shikonin, ata që ishin të shëndetshëm dhe ata që ishin me aftësi fizike të kufizuara, ata që mund të shikonin përpara dhe ata që nuk dëshironin të shikonin përpara. Edhe peygamberët u folën atyre pa bërë ndonjë ndarje. Ndërsa llogarinë nëse janë kuptuar apo jo ato që kishin folur, ia lanë në dorë Allahut (xh.xh.). Peygamberët e kishin primare kryerjen e detyrës.

Paqja e Allahut qoftë mbi ata! Të dërguarit e Allahut nuk bënë ndarje ndërmjet njerëzve që kishin përballë dhe zgjodhën gjuhën më të përshtatshme e më të ëmbël për ta. Ata i formonin fjalitë duke i zgjedhur fjalët një nga një. Ata bënë kujdes ndaj çështjeve që duheshin shpjeguar menjëherë dhe ndaj atyre që duheshin shtyrë për më vonë. Në

këtë mënyrë, nuk mbeti asnjë njeri mbi sipërfaqen e tokës që mund të ankohej me të drejtë prej peygamberëve në audiencën e Allahut Teala. Në sajë të përpikërisë në gjuhë dhe metodë që përdorën peygamberët, gurët u vendosën në vendin e tyre. Kështu u shfaq urtësia e Allahut në krijim.

Të gjithë nënat dhe baballarët, mësuesit, udhëheqësit, imamllarët dhe muezinët që sot dhe nesër janë të ngarkuar me detyrën për ta vazhduar kauzën e peygamberëve, janë të obliguar për të ndjekur këtë rrugë. Shprehjet që përdoren, fjalët që zgjidhen dhe metodat që preferohen nuk duhet të përbëjnë justifikim për njerëzit që e kanë shkatërruar ahiretin e tyre. Njerëzit duhet të ftohen te feja e Allahut duke mos bërë lëshime e neglizhime te kjo e fundit dhe duke përdorur metodat më magjepsëse. Sigurisht se nuk është e lehtë t'ia dalim mbanë në këtë kauzë. Për të arritur suksesin në këtë çështje duhet durim, qëndrueshmëri dhe kohë e gjatë. Peygamberët që na kanë prirë, nuk kanë nxituar. Ata nuk janë plogështuar dhe nuk janë dorëzuar kundrejt reagimeve negative. Paqja e Allahut qoftë mbi ata! Libri ynë i shenjtë, Kurani na i ka treguar historitë e atyre, në mënyrë që t'i marrim për shembull. Ata i ka bërë shembull për prindërit. Veçanërisht hoxxhallarët dhe mësuesit e kanë kusht që t'i marrin për shembull ata. Nëse nëna dhe babai përdorin gjuhën e peygamberëve, do të marrin ndihmën e Allahut (xh.xh.). Kjo është e vlefshme edhe për hoxxhën, edhe për mësuesin. Meqë rruga jonë është rruga e atyre, atëherë edhe metoda që duhet të përvetësojmë është metoda e atyre.

“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”

(Ali Imran, 110)

Ky ajet, përkrah vlerësimit që i bën bashkësisë islame për statusin madhështor që zotëron në krahasim me bashkësitë e tjera, e ngarkon edhe me përgjegjësi. **“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”** Bashkësia islame duhet ta vlerësojë dhe respektojë nderimin që i bën Allahu duke e konsideruar si bashkësinë më të dobishme të gjithë njerëzimit. Në të njëjtën kohë kjo bashkësi islame është e ngarkuar edhe me detyrën për të udhëhequr njerëzimin drejt paqes universale. Por që bashkësia islame të arrijë këtë pozitë duhet të plotësojë disa kushte sepse kjo pozitë i mund të meritohet vetëm mbas përpjekjeve të mëdha. Bashkësia islame nga pikëpamja e teorike (besimi) dhe sistemi social që ka është plotësisht e denjë për këtë pozitë por nuk mjafton vetëm kjo, përkrah kësaj për të përfaqësuar denjësisht vullnetin e Allahut në tokë duhet zotëruar dhe zhvilluar më tej shkenca dhe teknologjia dhe çdo gjë që sjell dobi për njerëzit. Nëse kjo bashkësi ndjek me përpikëri metodën hyjnore dhe sjell në vend atë që kërkohet prej saj, Allahu e lartëson këtë bashkësi në të gjitha fushat. Rruga e arritjes së kësaj pozite është e mbushur me vështirësi, megjithëse e vështirë dhe me pengesa është e domosdoshme për të formuar dhe ruajtur një sistem jete sipas vullnetit të Allahut.

Për të përcaktuar saktë të mirën dhe të keqen është i domosdoshëm besimi

për më tepër në kohën kur kriteret që përcaktojnë të keqen dhe të mirën ndryshojnë brenda ditës, është e domosdoshme të mbështetemi në kriteret hyjnore sepse mënyra e jetesës së bashkësive të tjera nuk është kriter për përcaktimin se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe. Botëkuptimi islam me burim hyjnorë qartëson pozitën dhe rolin e njeriut në tokë duke formuar marrëdhënie harmonike ndërmjet krijesit natyrës dhe njerëzve. Pra për të patur sukses duhet një besim i fort sepse gjatë rrugës bashkësia islame do përballet me vështirësi dhe armiq të shumtë dhe i vetmi tek i cili mund të mbështetet është Allahu. Nxitja për të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyrë e bashkësisë islame dhe nëse nuk e realizojnë këtë detyrë nuk e meritojnë emrin mysliman në kuptimin e plotë të fjalës. **“Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë”** kjo është shprehje inkurajuese ndaj ithtarëve të librit për të pranuar fenë islame sepse besimi në fenë islame do tu sillte dobi në këtë botë dhe në botën tjetër. **“Ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë.”** kurse nga ky citat i fundit të ajetit, Allahu xh.sh shpjegon gjendjen e atyre që besuan dhe janë veprë mirë duke i vlerësuar për aktin e kryer.

Sipas një transmetimi nga Ebu Hurejra (r.a.) Pejgamberi (a.s.) ka thënë:
"Veprat i paraqiten Allahut ditën e Hënë dhe ditën e Enjte. Unë dëshiroj që të jem agjërueshëm kur paraqiten veprat e mia"

Ndër agjërimet vullnetare është edhe agjërimi në ditët e hëna dhe të enjteve. Pejgamberi (a.s.) tregonte kujdes të veçantë në agjërimin e këtyre dy ditëve, një tjetër karakteristikë që d bën të veçantë këto ditën e hënë është lindja e Pejgamberit dhe shpallja e profetësisë në këtë ditë. Dita e hënë është një ditë e shënuar për Pejgamberin tonë (a.s.) sepse shpreh lindjen e Tij fizike por njëkohësisht është dita e shpalljes së Tij nga ana e Allahut xh.sh si një personalitet shpirtëror dhe mbartës i mesazhit hyjnorë. Si falënderim për këto dy ngjarje të shënuara Pejgamberi (a.s.) përpiquej që gjithmonë të agjëronte në këto ditë. Për rrjedhojë këto ditë mbartin një rëndësi të veçantë për çdo mysliman. Për këtë arsye ne si ndjekësit e Muhamedit (a.s.) duhet të tregojmë kujdes në agjërimin e këtyre dy ditëve duke zbatuar një tradite pro-

fetike por edhe si kujtim për këto ditë që shënojnë shfaqjen e dritës islame që do të ndriçojë horizontet. Nga ana tjetër vlera e kohës dhe hapësirës matet sipas ngjarjeve që kanë ndodhur në të. Dita e hënë duke qenë dita e lindjes së Pejgamberit (a.s.) dhe lindjes së islamit ka një vlerë të madhe për gjithë besimtarët. Një tjetër urtësi e agjërimin të këtyre ditëve është dhe paraqitja e veprave të njerëzve në këto dy ditë dhe sipas një hadithi që transmeton muslimi dita e hënë dhe e enjte janë ditët kur hapen dyert e xhenetit.

Duke vërejtur përkujdesjen e veçantë që tregonte Pejgamberi në agjërimin e këtyre dy ditëve dhe për vetë rëndësinë e ngjarjeve që ndodhin në këto janë arsye të mjaftueshme për të menduar seriozisht për agjërimin e këtyre ditëve.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Agjërimi të hënë dhe të enjte është vepër e pëlqyeshme.
2. Pejgamberi (a.s.) tregonte kujdes të veçantë në agjërimin e këtyre ditëve.
3. Ata që dëshirojnë që ti paraqiten veprat para Allahut ndërsa janë agjërueshëm duhet të agjërojnë këto dy ditë.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A X I I

KIAMETI

Allahu i madhëruar, ka vendosur që çdo gjë që ka krijuar të jetë e përkohshme. Ashtu siç ka caktuar një kohë vdekjeje për njeriun, Allahu ka caktuar edhe një kohë “Kiameti” për botën. Ashtu siç e ka bërë të panjohur kohën e vdekjes për çdo njeri, edhe informacioni se kur do të bëhet Kiameti është një lajm që i përket të fshehtës dhe dijes së Tij. Lidhur me këtë çështje, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Ata të pyesin ty (Muhamed) rreth Orës (së Kiametit). Thuaju:

«Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ajo, do ta tregojë vetëm Ai. Do të jetë e rëndë për qiejt dhe Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas.» Ata të pyesin, a thua se ti di diçka për të. Thuaj: «Këtë e di vetëm Allahu, ndërsa shumica e njerëzve nuk e dinë (pse kjo gjë është e fshehtë).» (A’raf, 187.)

“Njerëzit të pyesin për Orën (Kiametin), thuaju: «Vetëm Allahu ka dijeni mbi atë». Kush e di?! Ndoshta Kiameti mund të jetë afër?!” (Ahzab, 63.)

“Qoftë i lartësuar në lavdi Ai, të Cilit i përket pushteti i qiejve dhe i Tokës dhe gjithçka që gjendet mes tyre. Vetëm Ai ka dijeni mbi Orën (e Kiametit) dhe tek Ai do të ktheheni!” (Zuhruf, 85.)

SHENJAT E KIAMETIT

Lidhur me pyetjet që i janë drejtuar rreth Kiametit, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është përgjigjur duke thënë: *“i pyeturi nuk di më shumë se pyetësi!”*. Me këtë përgjigje ai ka dashur të bëjë të ditur se as ai nuk e dinte se kur do të bëhej Kiameti. Me qëllim që ummeti i tij të marrë mësim dhe të ruhet, ai ka dhënë informacione në lidhje me shenjat e Kiametit. Në një ajet fisnik paralajmërohet:

“A mos vallë mohuesit presin, që t’u vijë befasisht vetëm Ora (e Kiametit)? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur. Po për çfarë do t’u shërbejnë atyre këshillat, kur t’iu ketë ardhur Kiameti?!” (Muhammed, 18.)

Një pjesë e shenjave të Kiametit janë fizike, të tilla si shfaqja e Dexhallit dhe lindja e Diellit nga perëndimi. Ndërsa një pjesë tjetër janë shpirtërore, të tilla si dobësimi i fesë tek njerëzit, etj.

Disa dijetarë, shenjat e Kiametit i kanë ndarë në tre pjesë:

1. Shenjat që janë shfaqur dhe kanë kaluar, të cilat ndryshe quhen edhe “shenjat e largëta” ose “shenjat e vogla”. Këtu bëjnë pjesë dërgimi i Muhammedit (a.s.) si profet, lufta e Xhemelit dhe Siffinit, marrja e hilafetit nga Emeuitët, etj.

2. Shenjat, një pjesë e të cilave janë shfaqur por nuk kanë kaluar ende dhe janë duke shkuar drejt fundit e duke u shtuar. Këto quhen “shenjat e mesme”.

3. “Shenjat e afërta” ose “shenjat e mëdha”, pas të cilave do të vijojë menjëherë Kiameti. Këto shenja do të shfaqen njëra pas tjetrës, ashtu siç dalin nga peri rruazat e tespihve kur këputen.

Këtu do të trajtojmë shenjat e vogla dhe të mesme në një pjesë, ndërsa shenjat e mëdha në një pjesë tjetër:

a) Shenjat e vogla dhe të mesme

Ekzistojnë shumë shenja që lajmërojnë Kiametin para se ai të afrohet mirë. Këto lloj shenjash janë paralajmëruese për besimtarët dhe u kujtojnë atyre që të përgatiten sa më mirë. Ja disa prej tyre:

1. Dërgimi i Muhamedit (a.s.) si profet

Profeti (a.s.), është hallka e fundit e zinxhirit të profetëve, pra fleta e fundit e kalendarit profetik. Ai është profeti i fundit për të gjithë njerëzimin, që prej dërgimit të tij deri në ditën e Kiametit. Pra pas tij nuk do të ketë më asnjë profet tjetër. Për rrjedhojë, nderimi i botës me Muhammedin (a.s.) në të njëjtën kohë është edhe shenjë e afrimit të Kiametit.

Xhabiri (r.a.), tregon:

“Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), mbante hutbe, sytë i skuqeshin, zëri i ngrihej dhe emocionet i shtoheshin si një komandant që porosiste ushtrinë e tij: «Armiku do t’ju sulmojë në mëngjes ose në



mbrëmje, prandaj mbroni veten!». Pastaj, bashkonte gishtin tregues me gishtin e mesit dhe thoshte:

«Unë jam dërguar si Profet në një kohë kur midis meje dhe Kiametit distanca është sa kjo midis këtyre dy gishtave!» (Muslim, xhum'a, 43. Shih. Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 7.)

2. Shtimi i paditurisë në dijet fetare

Në një hadith fisnik thuhet:

«Mësojeni Kuranin dhe mësojuani atë të tjerëve! Mësoni edhe shkencën e trashëgimisë dhe mësojuani atë të tjerëve! Sepse së shpejti do të vijë një kohë, kur dy persona do të diskutojnë mbi një çështje në lidhje me trashëgiminë e nuk do të gjejnë një dijetar që do të gjykojë midis tyre dhe të zgjidhë çështjen.» (Hejthemi, IV, 223.)

Mësimi i dijeve fetare dhe të jetuarit sipas tyre është farz/e detyrueshme për çdo mysliman. Mos angazhimi mjaftueshëm në dijet Islame, për shkak të dobësimit të ndjenjave fetare tek njerëzit dhe për pasojë të mos jetuarit të fesë me sinqeritet, është një nga shenjat e Kiametit.

Në një tjetër hadith thuhet:

«Islami do të fshihet e do shkojë ashtu siç fshihet e shkon qëndisja në rrobë. Madje, nuk do të dihet çfarë është as agjërimi, as namazi, as haxhi, as umreja dhe as sadakaja. Libri i Allahut (Kurani) do të ngrihet e do të merret brenda një nate dhe mbi tokë nuk do të mbetet qoftë edhe një ajet prej tij. Do të mbeten vetëm disa burra e gra të moshuar të cilët do të thonë:

«Ne i kemi arritur (parë) të parët tanë, të cilët thoshin shprehjen: "La ilahe il-lallah!". Edhe ne e themi!»¹

Kur Hudhejfe (r.a.) transmetoi këtë hadith, Sila (r.a.) i cili gjendej pranë tij e pyeti:

«A do t'ju bëjë dobi shprehja «La ilahe il-lallah!» atyre të moshuarve, ndërkohë që nuk dinë as çfarë është namazi, agjërimi, haxhi dhe sadakaja?»

Hudhejfa (r.a.) nuk i dha përgjigje kësaj pyetje. Sila (r.a.) e përsëriti tri herë këtë pyetje dhe çdo herë Hudhejfa (r.a.) refuzoi të përgjigjej. Kur Sila (r.a.), e ripërsëriti, Hudhejfa (r.a.) tha:

«O Sila, kjo shprehje do t'i shpëtojë ata nga Xhenemi (i përjetshëm).» Këtë e përsëriti tre herë. (Ibn-i Maxhe, Fiten, 26.)

Po ashtu, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:


«Ngritja e dijes, rrënjësja e injorancës, konsumimi i alkoolit dhe shtimi i zinasë², janë prej shenjave të Kiametit.» (Buhari, Ilm, 21.)

Injoranca e përgjithshme në dijet fetare sot vihet

re shumë lehtë. Po ashtu edhe përhapja e alkoolit dhe zinasë është një realitet i hidhur që pranohet nga të gjithë. Gjendja e atyre që në këtë kohë e quajnë prapambetje konsiderimin e zinasë si krim, që nuk njohin asnjë kufi në kënaqjen e dëshirave dhe epsheve të tyre egoiste e që për rrjedhojë, siç shprehet edhe Profeti (a.s.), «janë si gomarët»³, nuk është aspak më ndryshe se gjendja e njerëzve më të këqij e më të mallkuar mbi të cilët do të bëhet Kiameti.

Përmendja këtu e këtyre gjynaheve është për shkak se ato janë tregues të qartë të prishjes së sistemit të domosdoshëm të besimit Islam, mbi të cilin qëndron në këmbë dhe ruhet dynjaja dhe Ahireti. Rënia (zhdukja) e dijes bëhet shkak i prishjes

së «fesë», përhapja e alkoolit të merr «mendjen», zinaja shkatërron «brezat», ndërsa shtimi i fitneve (trazirave) shkakton humbje «jetësh» dhe «pasurie». E në fakt detyra më e rëndësishme e myslimanëve është mbrojtja e këtyre pesë themeleve jetike. Prishja e këtyre pesë themeleve është treguesi më i madh i shkatërrimit të botës. Allahu i Madhëruar ka premtuar se njeriu nuk do të lihet të silltet gjithmonë si t'i dojë qejfi.⁴ E meqenëse pas Profetit (a.s.) nuk do të vijë më asnjë profet tjetër, tashmë njerëzit që do t'i humbasin këto amanete me siguri që do të shkatërrohen.



“A mos vallë mohuesit presin, që t'u vijë befasisht vetëm Ora (e Kiametit)? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur. Po për çfarë do t'u shërbejnë atyre këshillat, kur t'iu ketë ardhur Kiameti?!”



3. Shtimi i fitneve dhe vrasja e njerëzve

Fitnet (trazirat) në vendet Islame, kanë filluar në kohën e hilafetit të Osmanit (r.a.). Manifestimet e tyre kanë qenë të ndryshme në çdo periudhë. Domethënë, nuk është e thënë që fitnet të ndodhin të gjitha në të njëjtën kohë. Ato do të ndodhin në kohë e në forma të ndryshme deri në ditën e Kiametit. Njëherë, i Dërguari Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Do të vijë një kohë e tillë, kur kurrat (lexuesit e Kuranit) do të shtohen, ndërsa fakihët (dijetarët e vërtetë të urtë e punëmirë) do të pakësohen, dituria do të ngrihet, e herxhi do të shtohet!”

Sahabët pyetën:

“Çfarë është herxhi o i Dërguar i Allahut?”

Profeti (a.s.) u përgjigj:

“Vrasja juaj me njëri-tjetrin!..”

Më pas do të vijë një kohë, kur njerëzit do të këndojnë Kuran, por çka këndojnë nuk do t’u zbresë më poshtë se gurmazi (pra nuk do të kenë ndikim në zemër e nuk do të praktikohen).

Më pas do të vijë një kohë kur hipokriti, mohuesi dhe idhujtari do të flasin si besimtarë dhe do të debatojnë në lidhje me Allahun!” (Hakim, Mustedrek, IV, 504/8412. Shih. Buhari, Ilm, 24.)

Sot vërejmë se janë shtuar shumë hoxhallarët apo teologët me etiketën e dijetarëve, modernistë e historicistë⁵, që e interpretojnë Kuranin dhe Sunnetin sipas mendjes së tyre e që flasin për reforma në fe. Po ashtu janë shtuar edhe tekfivistët,⁶ të cilët luftojnë me myslimanët në emër të Islamit dhe sufistët (mistikët) e paditur që e dobësojnë rrugën e vërtetë. Të gjitha këto, e vërtetojnë më së mirë fjalën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Paralajmërim që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka bërë Abdullah ibn Omerit (r.a.) në lidhje me këtë çështje, është një kriter i rëndësishëm për orientimin tonë:

“O Ibn-i Omer! Kapu mirë pas fesë tënde, kapu mirë pas fesë tënde! Sepse ajo është edhe mishi edhe gjaku yt. Bëj kujdes se prej kujt e mëson fenë! Dijet dhe gjykimet fetare merri prej dijetarëve që janë në

rrugë të drejtë, e jo prej atyre që anojnë majtas-djathtas!”⁷

Nëse në një shoqëri dobësohen dijet fetare (Islame), është e natyrshme të shtohen edhe problemet e fitnet (trazirat). Njerëzit përditë e më shumë po bëhen egoistë dhe interesaxhinj, gjë e cila shkakton verbimin e ndjenjave të mirësisë dhe i hap rrugën animit nga e keqja në çdo moment. Kjo e bën shoqërinë si një kazan fitnesh, ku askush nuk gjen paqe e siguri.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

“Betohem në Allahun, i Cili mban në dorën e Tij të fuqishme shpirtin tim, se do të vijë një kohë kur vrasësi nuk do ta dijë përse ka vvarë e i vrari nuk do ta dijë se përse është vvarë.” (Muslim, Fiten, 55.)

Sahabët pyetën:

“Si është mundur kjo?”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u përgjigj:

“Kjo është herxh (fitne, anarki, trazirë)! Edhe vrasësi edhe i vrari janë në zjarr!” (Muslim, Fiten, 56.)

Tabloja e përgjithshme në çdo vend, ku sot mbi-zotëron terrori dhe anarkia, e vërteton edhe më mirë këtë realitet. Grupet terroriste që shpesh organizohen dhe menaxhohen prej forcave të errëta prapa skene, bëjnë gjakderdhje pa e ditur se kujt i shërbejnë. Për rrjedhojë vrasësi nuk e di se përse vret e i vrari nuk e di se përse është vvarë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Betohem për Allahun, i Cili mban shpirtin tim në dorën e Tij të fuqishme se jetës në dynja nuk do t’i vijë fundi, derisa një njeri i cili kalon pranë një varri nuk do hidhet mbi varr e të thotë: «Ah sikur të isha unë në këtë varr në vend të personit që prehet këtu!» Ai do të veprojë kështu, jo për shkak të fesë, por për shkak të fatkeqësive që i kanë rënë.” (Buhari, Fiten, 22; Muslim, Fiten, 54.)

Nga kjo kuptohet se jeta, në kohën para se të bëhet Kiameti, do të jetë shumë e vështirë për njerëzit. Në atë kohë jeta do të jetë aq stresuese, sa njeriu do të bëhet pishman që është gjallë. Njëko-



hësisht jeta do të jetë aq e pavlerë, sa vrasësi nuk do ta dijë përse vret e i varri nuk do ta dijë përse vritet. Madje edhe njerëzit që s'kanë asnjë lidhje me fenë e besimin, do ta urrejnë këtë botë e do të dëshirojnë vdekjen.

Në një situatë të tillë do të jetë e vështirë edhe të orientohesh nga e mira, edhe të bësh vepra të mira. Për këtë arsye, ne duhet ta vlerësojmë mirë kohën e paqes dhe sigurisë para se të vijnë ato kohë të vështira dhe të përpiqemi që këto mundësi t'i shndërrojmë në një kapital për lumturinë e botës së përjetshme.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nxitoni në bërjen e punëve të dobishme, sepse në një të ardhme të afërt vendin do ta kaplojnë disa fitne (trazira) si netët e errëta. Në atë kohë, njeriu gdhihet besimtar dhe ngruset mohues (qafir); ngruset besimtar dhe gdhihet mohues. Ai do ta shesë fenë për pak gjë të kësaj bote.” (Muslim, Iman, 186.)⁸

“...Personi që do të kapet fort pas fesë në një kohë të tillë, do të jetë si ai që mban në dorë prush (ose gjemba).” (Ahmed, II, 390.)⁹

Në kohë të tilla, njerëzit me karakter të dobët nuk do t'i japin rëndësi Kuranit dhe Sunnetit dhe do të veprojnë sipas mendjes së tyre. Kur të interpretojnë ajetet dhe hadithet, gjithmonë do të vënë në plan të parë interesat e tyre. Lidhur me këtë, Profeti (a.s.) ka thënë:

“Robërit e mirë të Allahut do të emigrojnë në Ahi-ret njëri pas tjetrit dhe pas tyre do të ngelen vetëm njerëzit pa vlerë, si mbetjet e elbit dhe të hurmave. Ndërsa Allahu i Madhëruar nuk u jep fare rëndësi atyre njerëzve.” (Buhari, Rikak, 9.)¹⁰

4. Dhënia autoritet njerëzve të paaftë e pa meritë

Ebu Hurejre (r.a.) tregon:

Ndërkohë që i Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte duke biseduar me sahabët, vjen një beduin dhe e pyet:

“- Kur do të bëhet Kiameti?”

Mirëpo, Profeti (a.s.) vazhdoi bisedën pa e ndërprerë fjalën. Për këtë arsye, një nga sahabët tha:

“Ai e dëgjo pyetjen e bedunit, por nuk i pëlqeu.”

Ndërsa një tjetër tha:

“Jo, ai nuk e dëgjo pyetjen.”

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), mbaroi fjalën tha:

“Ku është ai që pyeti rreth Kiametit?”

Beduini tha:

“Këtu jam o i Dërguar i Allahut!”

“Kur të humbasë amaneti, prite Kiametin!”- tha Profeti (a.s.).

“Si humb amaneti?”, pyeti përsëri beduini.

“Kur punët t'u besohen njerëzve të paaftë, prite Kiametin!” (Buhari, IIm, 2, Rikak, 35.)¹¹

Lënia e punëve në dorën e njerëzve të paaftë, do të thotë që punët të mos u besohen njerëzve që kanë dije, përvojë dhe meritë. Njerëzit e paaftë nuk i kryejnë ashtu siç duhet punët që kanë marrë në përgjegjësi por rendin vazhdimisht pas interesave të tyre personale. Për këtë arsye, ata bëjnë padrejtësi ndaj punëve e njerëzve, gjë e cila e shkatërron sistemin në një kohë të shkurtër.

5. Kalimi i shpejtë i kohës

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Nuk do të bëhet Kiameti pa u afruar koha! Ky afrim është i atillë që një vit do të jetë si një muaj, një muaj si një javë, një javë si një ditë, një ditë si një orë dhe një orë si një shkëndijë zjarri.” (Tirmidhi, Zuhd, 24/2332.)

Drejt fundit të botës, pasuria do të shtohet dhe për shkak se njerëzit do të angazhohen më tepër me të e do të zhyten në argëtime, ose për shkak të trazirave të shumta që do të shfaqen, ata do të shqetësohen. Në këtë mënyrë ata nuk do ta vënë re se si kalojnë ditët e netët dhe nuk do të përfitojnë aspak prej tyre. Mendohet se ky hadith fisnik ka aluduar edhe për shkurtimin e jetëgjatësisë dhe për kohën e cila do të kalojë pa begati.

Dijetari i hadithit, Hattabi, ka thënë se shkurtimi i kohës do të ndodhë pas ardhjes së Mehdiut ose

pas zbritjes së Isait (a.s.). Ndërsa dijetari i njohur Ali el-Kari, ka thënë se kjo do të ndodhë në kohën e të dyve, sepse shkurtimi i kohës do të fillojë kur të shfaqet Dexhalli. E ai do të shfaqet midis Mehdiut dhe Isait (a.s.).

6. Shtimi i pasurisë së kësaj bote

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Gëzohuni dhe shpresoni në gjëra që do t’ju gëzojnë! Beto hem në Allahun se unë për ju nuk kam frikë varfërinë. Unë kam frikë se bota do të shtrohet para jush, ashtu siç u është shtruar popujve të mëparshëm, e ju do të garoni ashtu siç garuan ata për këtë botë dhe bota do t’ju shkatërrojë ashtu siç i ka shkatërruar ata.” (Buhari, Rikak, 7; Muslim, Zuhd, 6.)

“Për ju kam frikë se pas meje do t’ju hapen mirësitë dhe stilitë e kësaj bote, e ju do t’ia jepni zemrën atyre!” (Buhari, Zekat, 47, Xhihad, 37; Muslim, Zekat, 121-123.)¹²

“Dy njaja është e ëmbël dhe ka pamje të bukur. Padyshim se Allahu do t’ju japë juve drejtimin e botës dhe do të shohë se si do të silleni e çfarë punësh do të bëni. Prandaj ruhuni prej dynjasë dhe grave (mendjelehta)!” (Muslim, Dhikr, 99.)

Pasuria do të vijë duke u shtuar vazhdimisht dhe në kohën pranë Kiametit do të shtohet në mënyrë të jashtëzakonshme, aq sa do t’i ngopë syrin edhe njerëzve të pangopur. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Në ditët e fundit të botës, një prej halifeve tuaj do ta ndajë pasurinë me grushte pa pasur nevojë ta numërojë.” (Muslim, Fiten, 68, 69.)¹³

Të gjitha këto janë paralajmëruar nga Profeti (a.s.). Mbase me kalimin e kohës do të shtohen edhe më shumë, por raste të tilla dëshmohen edhe në ditët tona.

7. Dobësimi i përshëndetjes me selam

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Para Kiametit do të shfaqet selami i veçantë¹⁴. Tregtia do të përhapet mjaft, aq sa edhe gruaja do ta ndihmojë burrin e saj në tregti. Lidhjet fafëfisnore do të shpëputen. Dëshmia e rreme do të shtohet e do të fshihet e vërteta...” (Ahmed, I, 407, 419; Hakim, IV, 110/7043.)

“Një nga shenjat e Kiametit, është edhe dhënia e selamit vetëm për të njohurit.” (Ahmed, I, 405. Shih. Abdurrezzak, Musannef, III, 154.)

8. Disa shenja të tjera të Kiametit për të cilat ka lajmëruar Profeti (a.s.)

“Nuk do të bëhet Kiameti pa luftuar dy ushtri të mëdha me njëra-tjetrën. Megjithëse të dyja këto dy grupe ushqejnë të njëjtat ideale, mes tyre do të

zhvillohet një luftë e madhe.

Nuk do të bëhet Kiameti pa u shfaqur rreth tridhjetë dexhallë gënjeshtarë e të mallkuar. Të gjithë këta dexhallë do të deklarojnë se janë të dërguarit e Allahut...

Nuk do të bëhet Kiameti pa u shtuar tërmetet dhe pa u afuar koha mes tyre...

Po ashtu, nuk do të bëhet Kiameti pa u shtuar pasuria midis jush, e pa rrjedhur si lumë. Pasuria do të shtohet aq shumë sa njeriu do të shqetësohet se kush do t’ia pranojë zekatin. Njeriu do të mundohet t’ia japë zekatin dikujt, por ai do t’i thotë: «Unë nuk kam nevojë për këtë!»...” (Buhari, Fiten, 25.)

Pamundësia e gjetjes së dikujt që do të pranojë zekatin ka ndodhur në kohën e Omer ibn Abdulazizit. Megjithatë kjo do të ndodhë edhe në të ardhmen. Madje, edhe sot e kësaj dite, për shkak të shtimit të pasurisë, në disa vende mund të jetë e vështirë të gjesh dikë që e meriton zekatin në kuptimin e vërtetë të fjalës. Në këtë pikë duhet bërë kujdes, sepse për shkak të mos sensibilizimit ndaj nevojtarëve dhe të të parit vetëm në ambientin përreth, disa persona mund të mendojnë se në shoqëri nuk kanë mbetur të varfër, dhe ky është tregues për një indiference shumë të theksuar. Besimtarët e pasur, sipas kriteve Islame, e kanë për detyrë t’i kërkojnë vetë të varfrit, t’i gjejnë ata dhe ta çojnë në vend detyrën e tyre të zekatin në mënyrën më të bukur.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Beto hem në Allahun Dhulxhelal që ka në dorë jetën time se nuk do të bëhet Kiameti pa vararë imamin (prijësin, kryetarin e shtetit) tuaj, pa nxjerrë shpatat për të luftuar njëri-tjetrin dhe pa e trashëguar botën të këqijtë tuaj!” (Tirmidhi, Fiten, 9/2170.)

“Nuk do të bëhet Kiameti pa shtuar uji i lumit Eufrat dhe pa u zbuluar në shtratin e tij një mal floriri, pa vdekur nëntëdhjetenëntë ndër njëqind që përleshën me njëri-tjetrin, duke thënë: «unë duhet të shpëtoj e të fitoj!»” (Buhari, Fiten, 24; Muslim, Fiten, 29)¹⁵

“Së shpejti, në shtratin e tharë të lumit Eufrat do të zbulohet një thesar floriri. Kush ia arrin asaj dite, të mos marrë asgjë prej atij thesari!” (Buhari, Fiten, 24; Muslim, Fiten, 29-32; Ebu Davud, Melahim, 13; Tirmidhi, Sifatu’l-Xhenne, 26)

Në këto hadithe lajmërohemi se lumi Eufrat do të shterojë dhe në shtratin e tij do të dalë në pah një mal me flori ose ndonjë minierë ari. Fjala “mal” mund të jetë përdorur edhe për të shpjeguar më mirë madhësinë e thesarit që do të zbulohet. Mendohet se kjo do të ndodhë në një kohë afër Kiametit.

Gjithashtu, në një hadith tjetër që tregon për shfaqjen e këtyre ndodhive para Kiametit, i Dër-

guari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Toka do t’i kthejë të gjitha thesaret e veta në formën e kolonave të arit e të argjendit.”*¹⁶ Në atë kohë, njerëzit e mbushur me lakmi, do të hyjnë aty dhe nëntëdhjetenëntë në njëqind (sipas një transmetimi tjetër nëntë në dhjetë) veta do të vdesin në këtë përpjekje.

Në një hadith fisnik, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Femrat do të shtohen, ndërsa meshkujt do të pakësohen aq shumë sa pesëdhjetë gra do të kenë vetëm një person (burrë) që do të kujdeset për to.” (Buhari, Ilm, 21.)

Kjo shprehje në këtë hadith fisnik, Allahu e di më mirë! - mund të jetë edhe në formë figurative. Por nga kjo kuptohet qartë se, në kohën afër Kiametit, një burrë do të jetë i detyruar të kujdeset për disa gra.

Përveç kësaj, për shkak se me afrimin e Kiametit do të shtohen fitnet/ trazirat, po ashtu do të shtohen edhe vrasjet, edhe luftrat, gjë e cila do të çojë në pakësimin e numrit të burrave.

Në hadithin fisnik, që njihet edhe si “Hadithi i Xhib-rilit”, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është pyetur për shenjat e Kiametit, për të cilat ai është përgjigjur kështu:

“Kur nënat të lindin fëmijë të cilët do t’i trajtojnë ato si skllave dhe kur barinjët e deleve këmbëzbathur e të zhveshur të garojnë me njëri-tjetrin në ndërtimin e pallateve të larta (prite Kiametin).” (Muslim, Iman, 1, 5.)¹⁷

Shenja, e cila tregon se “skllavja do të lindë zotërinë e saj”, mund të shpjegohet në këtë mënyrë:

1. Nënata mund të lindin fëmijë të këqij që i trajtojnë ato si skllave dhe abuzojnë me prindërit e tyre.

2. Kur zotëria shkon me skllaven e tij dhe ajo lind një fëmijë, i cili do të kalojë në vend të babait vet. Në këtë rast fëmija bëhet zotëria i nënës së vet.

3. Kur një grua me fëmijë merret e shitet si skllave dhe duke kaluar dorë më dorë, pas një farë kohe, blihet nga fëmija i saj.

Ndërsa shenja që tregon “garën e barinjve këmbëzbathur e të zhveshur në ndërtimin e pallateve të larta”, aludon në rritjen e mirëqenies dhe pasurisë, aq sa edhe njerëzit që më parë kanë qenë shumë

të varfër do të garojnë në ndërtimin e pallateve të larta.

I dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“...Nuk do të bëhet Kiameti derisa njerëzit të garojnë në ndërtimin e pallateve të larta...” (Buhari, Fiten, 25.)

Profeti (a.s.) ka lajmëruar se midis shenjave të Kiametit, të cilat janë si zërat e hapave të tij, janë edhe shtimi i “zinasë” dhe “ndërtesave”. Nëse shohim tablonë e përgjithshme të kohës sonë, për fat të keq do të vërejmë se zinaja dhe ndërtesat e larta janë shtuar shumë.

Zinaja dhe imoraliteti janë duke helmuar qetësinë dhe shpirtin e shoqërive. Ndërsa ndërtesat e larta të kujtojnë gurët e varrit të qyteteve të pajetë, të cilëve u është dobësuar aspekti shpirtëror.

9. Do të vijë një kohë e tillë që...

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka lajmëruar ummetin e tij në lidhje me disa fitne dhe fenomene të këqija që do ndodhin në të ardhmen, duke dëshiruar që ata të tregohen më të kujdesshëm në këtë çështje. Disa prej haditheve që bëjnë të ditur një pjesë prej këtyre ndodhive, të cilat cilësohen si lajmëtare të Kiametit, janë edhe këto:

*“Mbi njerëzit do të vijë një kohë e tillë që askush nuk do të mbetet pa ngrënë kamatën! Edhe nëse nuk e përfiton direkt prej saj, atë do ta prekë pluhuri”*¹⁸ i saj.” (Ebu Daud, Buju, 3/3331.)¹⁹

“Do të vijë një kohë e tillë që njeriu nuk do t’i interesojë aspak nëse pasurinë e ka fituar hallall apo haram!” (Buhari, Buju, 7, 23.)

“Do të vijë një kohë e tillë që kush thotë të vërtetën do të përgënjeshtrohen, e gënjeshtarët do të besohen. Njerëzit e besueshëm do të konsiderohen tradhtarë, e tradhtarët do të konsiderohen të besueshëm. Njeriu do të dëshmojë pa iu kërkuar të dëshmojë dhe do të betohet pa iu kërkuar të betohet.

Njerëzit më të lumtur në botë (duke përfituar tepër prej mirësive të kësaj bote) do të jenë ata më të poshtrit, që nuk besojnë as Allahun e as të Dërguarin e Tij!” (Taberani, el-Mu’xhemu’l-Kebir, XXIII, 314; Hejthemi, VII, 283.)

“Do të vijë një kohë e tillë që njerëzit nuk do të këshillojnë më të mirën dhe nuk do të pengojnë as-

“Nuk do të bëhet Kiameti pa shtuar uji i lumit Euftrat dhe pa u zbuluar në shtratin e tij një mal floriri, pa vdekur nëntëdhjetenëntë ndër njëqind që përleshën me njëri-tjetrin, duke thënë: «unë duhet të shpëtoj e të fitoj!»”



kënd nga e keqja.” (Hejthemi, Mexhmau’z-Zeuaid, VII, 280.)

Theubani (r.a.), tregon se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Është e afërt koha kur popujt e huaj do t’ju sulmojnë si egërsirat e uritura drejt ushqimit.”

E pyetën:

“A është kjo për shkak se do te jemi pak, o i Dërguari i Allahut?”

Ai tha:

“Jo, ju do të jeni të shumtë, por atëherë do të jeni të pavlerë si shkuma e detit. Allahu do të nxjerrë nga zemrat e armiqve tuaj frikën prej jush e do të fusë dobësinë në zemrat tuaja?”

“Ç’është dobësia, o i Dërguari i Allahut?”- u pyet.

“Dashuria ndaj dynjasë dhe frika nga vdekja!”- tha ai.” (Ebu Daud, Melahim 5/4297; Ahmed, V, 278.)

Siç e kuptojmë edhe nga ky hadith fisnik, armiqtë e Islamit do t’i sulmojnë myslimanët të bashkuar për të thyer forcën e tyre, për t’i përçarë dhe si përfundim për t’i eliminuar ata. Dhe këtë do ta bëjnë me shumë lehtë, sepse çka u jep guxim atyre, nuk është numri i pakët i myslimanëve, por përkundrazi, edhe pse numri i tyre do të jetë i madh, ata do të jenë të dobët në besim në aspektin e devotshmërisë dhe do të jenë të dhënë shumë pas kësaj bote. E në fakt kush e ka frikë vdekjen dhe është i dhënë tepër pas kësaj bote, nuk mund të bëjë sakrifica, nuk mund të durojë vështirësi dhe e braktis luftën kundër armikut me jetën dhe pasurinë e tij. Kështu myslimanët do ta humbasin madhësitinë e tyre që dikur mbillte frikën në zemrën e armiqve. E për këtë arsye armiqtë e Islamit nuk do të kenë më frikë prej myslimanëve.

Zubejr ibn Adi (r.a.) tregon:

Shkuam tek Enes ibn Maliku (r.a.) dhe iu ankuam për padrejtësitë që na bënte Haxhaxhi. Ndërsa Enesi (r.a.) na tha:

“Bëni durim deri sa të takoheni me Zotin tuaj, sepse çdo ditë që vjen do të jetë më e keqe se ajo që shkon. Këtë e kam dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut, (a.s.).” (Buhari, Fiten, 6)

Abdullah ibn Omeri (r.a.) ka rrëfyer:

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u drejtua nga ne dhe tha:

“O muhaxhirë! Ekzistojnë pesë gjëra pas të cilave ju mund të jepeni, strehohem tek Allahu që ju të mos i arrini këto:

1. Kur në një popull përhapet zinaja dhe prostitucioni, derisa ata e kryejnë këtë gjynah publikisht, tek ta do të shfaqet patjetër sëmundja e murtajes dhe sëmundje të tjera që nuk janë parë në popujt që kanë jetuar para tyre.

2. Populli që mat dhe peshon mangët, patjetër që do të ndëshkohen me uri, vështirësi jetese dhe padrejtësi të kryetarëve të tyre.

3. Çdo popull që i ikën pagesës së zekatit të pasurisë së vet, patjetër që do të privohet nga shiu dhe po të mos ishte për kafshët e tyre, nuk do t’u lëshohej fare shi.

4. Çdo popull që do të braktisë urdhrat e Allahut dhe sunnetin e të Dërguarit të Tij, patjetër që Allahu do t’u vërsul një armik që nuk është prej tyre, i cili do të marrë një pjesë të zotërimeve të atij popull.

5. Drejtuesit (e një populli) që nuk punojnë me Librin e Allahut, por zgjedhin ato që u vijnë përshatë nga gjykimet e tij, Allahu do t’i ndëshkojë duke i përplasur me njëri-tjetrin (përfshihen nga trazirat dhe anarkia).”

(Ibn-i Maxhe, Fiten, 22; Hakim, IV, 583/8623; Bejhaki, Shuab, III, 197.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Një popull që drejtohet nga gratë (në çështjet e drejtimit dhe gjykimit) nuk ka shpëtim!” (Buhari, Megazi, 82.)

“Nëse drejtuesit tuaj janë njerëz të mirë, nëse të pasurit janë njerëz bujarë, nëse çështjet i zgjidhni duke u këshilluar mes jush, atëherë mbitoka është më e mirë se nëntoka (vdekja). Por nëse drejtuesit tuaj janë njerëz të këqij, nëse të pasurit janë korracë dhe nëse çështjet tuaja janë në dorë të grave, nëntoka është më e mirë se mbitoka.” (Tirmidhi, Fiten, 78/2266.)

E në fakt, në një popull të tillë është e pamundur të mbizotërojnë urdhrat e Islamit...

Aliu (r.a.), tregon:

“Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

«Kur populli im të bëjë këto pesëmbëdhjetë gjëra, mbi të do fillojnë të bien fatkeqësitë!»

“Do të vijë një kohë e tillë që njerëzit nuk do të këshillojnë më të mirën dhe nuk do të pengojnë askënd nga e keqja.”



Të pranishmit pyetën:

«Çfarë janë këto o i Dërguar i Allahut?»

Profeti (a.s.) i rreshtoi kështu:

«1. Kur pasuria publike qarkullon vetëm midis të pasurve dhe njerëzve me pushtet, pa rënë kurrë në dorë të të varfërve e nevojtarëve.

2. Kur amaneti (detyra) shihet si plaçkë dhe shpërdorohet.

3. Kur zekati nuk shihet si adhurim por si një peshë e rëndë dhe humbje.

4. Kur njeriu i bindet gruas (në punë të këqija).

5. Kur njeriu tregohet i pabindur ndaj nënës së vet.

6-7. Kur njeriu sillet ashpër me babanë e tij, ndërkohë që sillet mirë me shokun.

8. Kur në xhami të kumbojnë zërat (të humbasë përkushtimi në adhurim).

9. Kur drejtuesit e një populli janë nga më të poshtrit e tyre. (Në kohën tonë, ky është një fenomen që vërehet shpesh në shumë vende të botës).

10. Kur dikush respektohet nga frika e së keqes së tij.

11. Kur të lejohen pijet alkoolike të prodhuara nga emra të ndryshëm.

12. Kur meshkujt të veshin rroba prej mëndafshi.

13-14. Kur të rritet interesi për këngëtarët dhe veglat muzikore. (Për fat të keq, fenomene të tilla janë më të përhapurat në ditët tona.)

15. Dhe kur brezat e rinj të këtij populli të mallkojnë brezat e mëhershëm të tij.

Ja pra, pikërisht atëherë pritëni erën e kuqe (që merr shpirtat e besimtarëve), fundosjen në tokë ose shndërrimin në derra apo majmunë²⁰, tërmetin dhe rënien e gurëve nga qielli!

Më pas, do të shfaqen shumë shenja të tjera, njëra pas tjetrës, të cilat do ta ndjekin njëra-tjetrën si rruazat e një gjerdani të vjetër të cilit i është këputur peri.” (Tirmidhi, Fiten, 38/2211.)

Të fshehtën e di vetëm Allahut. Por me shumë gjasa, këto janë shenja që do të ndodhin si rezultat

i shtimit të së keqes me afrimin e Kiametit.

Në një hadith fisnik thuhet:

“Së shpejti do të shfaqet një fitne e tillë që, prej saj njeriun mund ta shpëtojë vetëm Allahu dhe një lutje si ajo e njeriut i cili është duke u mbytur...” (Bejhaki, Shuab, II, 367-1077.)

Ndërsa Hudhejfe (r.a.), ka thënë:

“Mbi njerëzit do të vijë një kohë e tillë, nga e cila mund të shpëtojë vetëm ai person që lutet si dikush që është duke u mbytur në det.” (Ibn-i Ebi Shejbe, Musannef, VI, 22/29173; Hakim, IV, 471/8308.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Do të vijë një ditë që njerëzit do ta braktisin Medinën ndërkohë që ajo është në gjendjen më të mirë e më të bukur. Aty do të mbeten vetëm kafshët e egra dhe zogjtë.

Njerëzit që do të vdesin të fundit në botë janë dy barinj prej fisit Muzejne. Ata i thërrasin delet e tyre duke dashur të hyjnë në Medinë. Mirëpo, ata e gjejnë atë të shkretuar e të mbushur me kafshë të egra. Kur arrijnë në kodrën e lamtumirës, edhe ata bien me fytyrë në tokë e vdesin.” (Buhari, Fedailu'l-Medine, 5; Muslim, Haxh, 498, 499; Muvatta, Xhami, 8.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Mehdiu do të jetë prej sojit tim, prej fëmijës së Fatmas!” (Ebu Daud, Mehdi, 1/4284; Ibn-i Maxhe, Fiten, 34.)

“Mehdiu është prej sojit tim. Ai ka ballë të gjerë e hundë të hollë. Ai do ta mbushi me drejtësi botën, siç ishte mbushur me mizori e padrejtësi, dhe do të sundojë për shtatë vjet.” (Ebu Daud, Mehdi, 1/4286.)

Të gjitha këto që janë lajmëruar në hadithet fisnike, janë realizuar ose në mënyrë të njëjtë ose të ngjashme. Mirëpo për shkak se çasti i Kiametit nuk mund të dihet në mënyrë të prerë, është e mundur që këto shenja të realizohen edhe në të ardhmen në forma edhe më të ashpra. Ne si myslimanë duhet të jemi gjithmonë të kujdesshëm dhe të përgatitemi sa më mirë për botën tjetër.

■ **REFERENCAT:** 1) Situata të ngjashme kanë ndodhur në kohën e komunizmit në disa vende të botës, si Kina, Rusia dhe Azia e Mesme. (E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Shqipëri gjatë regjimit komunist, i cili e ndaloi fenë me ligj në vitin 1967, duke u shpallur kështu i vetmi vend ateist në botë.) 2) Zina: Marrëdhënie seksuale jashtëmartesore. 3) shih. Muslim, Fiten, 110; Tirmidhi, Fiten, 59; Ibn-i maxhe, Fiten, 33. 4) shih. Kuran, el-Kijame, 36. 5) **Historicizm:** Rrymë relativiste, që refuzon idenë e interpretimeve universale, fundamentale dhe të patjetërsueshme. 6) **Tekfir:** Akuzimi i të tjerëve për veprën e mohimit të Allahut, të kushteve të besimit dhe Islamit. 7) Hatib el-Bagdadi, el-Kifaje fi ilmi'r-Riuaje, el-Medinetu'l-Muneuere, el-Mektebetu'l-Ilmijje, fq. 121. 8) shih. Tirmidhi, Fiten, 30, Zuhd 3; Ibn-i Maxhe, Ikame 78; Ahmed, II, 303, 372, 523. 9) shih. Muslim, Iman, 186; Tirmidhi Fiten, 30/2196. 10) shih. Darimi, Rikak, 11. 11) shih. Ahmed, II, 361. 12) Shih. Nesai, Zekat, 81; Ibn-i Maxhe, Fiten, 18. 13) shih. Ahmed, III, 317. 14) Atë kohë, njeriu do të përshëndesë me selam vetëm të njohurit, ose kur shkon pranë një grupi, përshëndet vetëm disa persona të caktuar prej tyre. 15) Ibn-i Maxhe, Fiten, 25. 16) Muslim, Zekat, 62. 17) Shih. Buhari, Iman, 37; Tirmidhi, Iman, 4; Ebu Daud, Sunnet, 16; Nesai, Meuakit, 6; Ibn-i Maxhe, Mukaddime, 9. 18) Në transmetimin e Ebu Daudit, përmendet fjala “avull”. 19) Shih. Nesai, Buju, 2/4452; Ibn-i Maxhe, Tixharat, 58; Ahmed, VV, 494; Bejhaki, Sunen, IV, 275. 20) shih. Tirmidhi, Fiten, 38/2210.



EL-HAFIDH

MBROJTËSI DHE KUJDESTARI I ÇDO GJËJE

— Ilir Hoxha —

“El-Hafidh”, rrjedh prej rrënjës “hifdh”, që do të thotë “të ruash, të mbrosh” dhe është një mbiemër i hiperbolizuar që shpreh vazhdimësi. Si një prej cilësive të Allahut të Madhëruar, el-Hafidh na njeht me, “Atë që kujdeset për çdo gjë dhe ruan ekuilibrin e gjithçkaje në gjithësi”. (shih. Bekare, 255; Enbija, 32; Kaf, 4.) Në sajë të manifestimit të emrit hyjnor el-Hafidh, arrihet përsosmëria në funksionimin e gjithësisë, duke e ruajtur atë në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që gjithçka, që prej të më të voglës, e deri tek më e madhja, të jenë një sistem i vetëm që mbështetet tek njëra-tjetra. Kështu, me anë të këtij ekuilibri në gjithësi, gjërat që duken të kundërta me njëra-tjetrën, në fakt i shërbejnë ekzistencës së njëra-tjetrës. Dhe, kur ky ekuilibër të prishet, atëherë çdo ekzistencë shkatërron njëra-tjetrën. (Njeriu është e vetmja qenie në këtë botë, e cila ka potencialin ta prishë këtë ekuilibër të krijuar prej Allahut) shih. (Rum, 41.)

Çfarë ruan el-Hafidh-i?

Instinktet dhe reflekset që i janë dhënë gjallesave në mënyrë të gatshme sapo vijnë në këtë botë, me qëllim që të vazhdojnë jetën e tyre, janë mirësi e Allahut. Ashtu siç kemi nevojë për emrin Hafidh që të ruajmë ekzistencën tonë fizike, ne kemi nevojë për të që të mbrojmë edhe zemrën tonë prej dyshimeve dhe vesveseve, mendjen tonë prej gabimeve dhe ecurinë tonë prej devijimeve. Po ashtu, edhe mbrojtja e jetës, familjes, atdheut dhe pasurisë sonë

prej çdo lloj rreziku (shih. Jusuf, 64.) edhe ruajtja e Fjalës së Allahut prej prishjes dhe transformimit (Hixhr, 9.), janë në sajë të këtij emri hyjnor. Çfarëdo gjëje prej fesë dhe kësaj bote që kemi nevojë për ta ruajtur, aty kemi nevojë edhe për emrin el-Hafidh. Atë që nuk e ruan Allahu, nuk mund ta ruajë askush. Po ashtu, atë që e ruan Ai, nuk mund ta dëmtojë askush. (shih. Junus, 107.)

Për shkak se njeriu është e vetmja krijesë ndër të gjitha që mund të paramendojë rrezikun që e pret, ai është edhe krijesa që e ndjen më fort nevojën për siguri. Vetëdija se mbrojtësi i vërtetë është vetëm Allahu dhe se kur Ai nuk të ruan, nuk mund të të ruajë askush dhe asgjë tjetër, na ruan neve prej trokitjes në dyer të tjera jashtë derës së Tij për të kërkuar mbrojtje dhe dorëzimit të vetes sonë tek ta. Hyrja në mbrojtjen e Allahut, është e vetmja mënyrë për të ruajtur personalitetin dhe dinjitetin tonë. Allahu është Ai që na ruan edhe prej çdolloj devijimi me anë të ndërgjegjes që ka vendosur brenda nesh dhe shpalljes hyjnore që është i vetmi burim i sigurt i dijes sonë. (shih. Tarik, 4.) Kjo është edhe urtësia e faktit që Zoti ynë i Madhëruar nuk na ka lënë pa shpallje që prej njeriut të parë. Ai na ka bërë të dallojmë të mirën nga e keqja dhe na pajisi me një dije të shenjtë e cila do të ekuilibrojë presionin e fortë të egos sonë, duke mos na lënë vetëm në këtë përpjekje. Mirëpo, nëse përsëri një rob e refuzon këtë ndihmë dhe dëshiron të ecë i vetëm, atëherë për

të nuk mund të bëhet gjë, sepse në këtë jetë, askush nuk mund ta mbajë askënd me zor larg gjynaheve dhe as që është i detyruar të jetë roje i të tjerëve. (shih. Nisa, 80; Shura, 48.) Përkundër kësaj, ata që orientohen tek Allahu dhe janë në rrugën e Tij, bëhen njerëz mbi të cilët manifestohet direkt emri Hafidh (shih. Kaf, 32.)

Përveç këtyre, edhe ruajtja dhe përcimi i trashëgimisë njerëzore në çdo fushë, arrihet po në sajë të këtij emri hyjnor. Fahreddin er-Razi, duke tërhequr vëmendjen në faktin se ky emër e mbron njeriun nga rreziqet shpirtërore, është shprehur se shumë dijetarë dhe mendimtarë janë larguar prej së vërtetës për shkak të dyshimeve të rëndomta dhe për rrjedhojë ka theksuar se trashëgimia e paçmueshme njerëzore në emër të së mirës, të bukurës dhe të drejtës, është vepër e manifestimit të emrit Hafidh. Kjo, sepse ruajtja e së vërtetës dhe kuptimi i saj në mënyrë të drejtë, përfshin edhe ruajtjen e saj me trimëri dhe zgjuarsis, edhe përcimin e saj në mënyrë të sigurt. Dhe kjo është një punë që mund të bëhet vetëm nga dikush që zotëron një mendje dhe karakter të fortë e të ruajtur prej çdo dobësie.

Tre ajetet e Kur'anit, ku përmendet ky emër (Hud, 57; Jusuf, 64; Sebe, 21) kanë zbritur në periudhën e Mekës, në vitet më të vështira për myslimanët, gjë e cila na tregon qartë se në cilat kohë duhet të kapemi më fort pas këtij emri hyjnor. Pra, në kohët kur e ndjejmë veten më të dobët dhe armiqtë tanë më të fortë...

Ashtu siç ndodh edhe me shumë emra të tjerë

të Allahut, edhe emri el-Hafidh, nga një anë të jep qetësi dhe gëzim, e nga një anë tjetër përcjell paralajmërim dhe të bën të mendosh. (shih. Shura, 6.) Kjo, sepse "hifdh", ashtu siç nënkupton ruajtjen prej belave, shkatërrimit dhe humbjes, përfshin edhe kuptimin e shënimit dhe ruajtjes së gjithçkaje pa anashkaluar asgjë, qoftë e vogël apo e madhe, e hapur apo e fshehtë. Nga kjo pikëpamje, ringjallja në botën tjetër dhe llogaridhënia për çdo gjë që është vepruar në këtë botë, kanë lidhje të ngushtë me emrin Hafidh. Ata që janë të vetëdijshëm për këtë kuptim të emrit Hafidh, e dinë shumë mirë se çdo veprim i tyre, madje edhe qëllimet e tyre, shënohen dhe ruhen. Ky nivel i lartë vetëdijeje u jep atyre edhe një disiplinë të fortë vetjake.

Sipas dijetarëve, njeriu ka nevojë për manifestimin e këtij emri, edhe për të mbajtur veten nën kontroll, edhe për të ruajtur ato që i lihen amanet. Njerëzit tek të cilët manifestohet ky emër hyjnor, pikësëpari i përdorin shumë mirë mjetet e ruajtjes që u ka dhuruar Allahu. Ata e ruajnë jetën, shëndetin mendor dhe fizik, fenë, pjesëtarët e familjes, pasurinë dhe pronën e tyre prej çdolloj rreziku. Po ashtu, ata nuk ruajnë vetëm të drejtat, nderin dhe dinjitetin e vet, por të çdokujt që kanë nën kujdesin e vet si mirësi e Allahut.

Njeriu që pajiset me moralin e këtij emri hyjnor, beson pa mëdyshje se asnjë grimcë e mirësive apo të këqijave që bën, nuk do të humbë, por do t'i dalë përpara një ditë. Për këtë arsye, ai i shton mirësitë dhe ruhet nga gjynahet. (shih. Haxh, 41.)



KARA MURAT PASHA

KRYEMINISTRI I PARË OSMAN NGA OXHAKU I VLORAJVE

— Dr. Ardian Muhaj —

Kara Murat Pasha ose Dev Murat Pasha (1596-1655): ka qenë kryeministër i shtetit osman dy herë, nga 21 maji 1649 deri më 5 gusht 1650 dhe nga 11 gushti deri më 19 gusht 1655. Mendohet të ketë lindur rreth vitit 1596. Gjatë periudhës së Ahmetit I u bë pjesë e trupës së jenicerëve.

Ishte me formim solid ushtarak veçanërisht në flotën osmane, ku edhe kishte qenë kryeadmiral, ose Kapudan Pasha, para se të vinte në postin e kryevezirrit. Epitetet që ka mbartur gjate jetës si “kara”, trim dhe “dev”, trupmadh tregojnë për cilësitë e tij.

Të gjitha burimet dëshmojnë se Murati ishte shqiptar, i lindur në trojet shqiptare i edukuar në trupën e jenicerëve.¹ Nga fakti që i ati quhej Mustafa, kjo deri diku e vë në dyshim të ketë qenë kontingjent i devshirmesë. Në këtë periudhë shumica e jenicerëve vinin nga familje myslimane pasi inkuadrimi në një trupë të tillë të elitës ushtarake shihej si një privilegj. Ka dëshmi se ishte një nga paraardhësit më të shquar të familjes së Vlorajve dhe i pari që mbërriti në postin e kryevezirrit. Sipas udhëpërshkruesit osman Evlija Çelebi, nga kjo familje në mes të shekullit XVII, Hysen Pashë Vlora ishte në krye të sanxhakut të Vlorës, kurse po në atë kohë, në Stamboll kryeministër ishte xhaxhai i Hysenit, Kara Murat Pasha.²

U shqua si një nga komandantët ushtarakë më të shquar në fazat e para të luftës së Kretës. Në vitin 1648, kur në fron erdhi si sulltan Mehmeti IV, u ngrit në rangun e rëndësishëm ushtarak të komandantit të jenicerëve, “yeniçeri agasi”. Në vi-

tet 1648-1649 mori pjesë në fushatën e Muratit IV në Irak dhe në rimarrjen e Bagdadit nga osmanët. Kur veziri i madh Sofu Mehmed Pasha vrau again e jenicerëve dhe përflitej se po komplotonte për të eliminuar edhe sulltaneshën Kosem Sulltan, Murati që asokohe mbante titullin aga, dhe jo akoma pasha, vuri në dijeni sulltanin. Erdhi për herë të parë në postin e kryeministrit gjatë luftës së Kretës pas humbjes së flotës osmane në betejën detare të Foçës të 12 majit 1649. Për këtë humbje të rëndë përgjegjës kryesor u bë kryeministri Sofu Mehmed Pasha dhe për pasojë u shkarkua nga posti dhe në vend të tij erdhi shqiptari Murat Pasha.³ Hetimet e mëvonshme bënë që Sofu Mehmed Pasha fillimisht u internua dhe më pas u ekzekutua.

Për vetë faktin se kur erdhi për herë të parë si kryevezir, sulltani Mehmeti IV ishte vetëm shtatë vjeç në moshë rivaliteti për pushtet në portë ishte i lartë, kryesisht mes fraksioneve të së ëmës Turhan Hatixhe dhe gjyshes së sulltanit e njohura Kosem. Murati kishte mbështetjen e fraksionit të udhëhequr nga Kosemi, kurse kundërshtarët e tij ishin nga mbështetësit e Hatixhes. Për shkak të këtij rivaliteti dhe për shkak se edhe në trupën e jenicerëve e kishte humbur ndikimin që kishte pasur dha dorëheqjen nga posti më 5 gusht 1650. Kështu i doli para rënies së postit në dorën e fraksionit kundërshtar, dhe menjëherë propozimi i tij për të emëruar në vend të tij Melek Ahmed Pashën u miratua nga sulltani.⁴ Duke qenë në miqësi me kryevezirin e ri,

1. Evlija Çelebi, *Narrative of Travels in Europe, Asia, and Africa in the Seventeenth Century*, Cambridge University Press, 2012, f. 152.

2. Në Vlorë Evlijai përshkrua xhaminë e sapondërtuar nga Hysejin Pasha, i cili thotë se ishte nipi i Kara Mura Pashës. Machiel Kiel, *Ottoman architecture in Albania, 1385-1912*, Research Centre for Islamic History, Art and Culture, 1990, f. 50.

3. Sipas tregtarit anglez Robert Bargrave që ishte edhe dëshmitar i ngjarjeve, jenicerët u mobilizuan kundër kryevezirrit Sofu Mehmed Pasha dhe kërkuan vendosjen në detyrën e kryeministrit të komandantit të tyre, Muratit. Michael G. Brennan, ed. *The Travel Diary of Robert Bargrave, Levant Merchant, 1647-1656*, Volume 3, Part 4, Issue 3, Hakluyt Society, 1999, f. 21-22.

4. *The Intimate Life of an Ottoman Statesman, Melek Ahmed Pasha (1588-1662): As Portrayed in Evliya Çelebi's Book of Travels (Seyahat-name)*, translation and commentary by Robert Dankoff, Neë York: SUNY

kërkoj gjithashtu të emërohej bejlerbe i Hungarisë me qendër në Budin ose Budapest dhe kjo kërkesë iu plotësua.⁵ Në postin e guvernatorit të Hungarisë qëndroi për 3 vite e gjysëm. Arkeologët hungarezë i kanë nxjerrë në dritë që në vitet 1960 themelet e sarajit të tij në kalanë e Budës, që sot ndodhet përballë manastirit karmelit. Kara Murad Pasha si duket e rinovoi dhe e zgjeroi rezidencën e pashallarëve të Budës, çka tregon tërthorazi se pavarësisht largimit nga posti kryeministrior, nuk e konsideronte veten në rangun e thjeshtë të pashait.⁶

Në nëntor të vitit 1653, u thirr në Stamboll dhe u ngrit në postin shumë të rëndësishëm të kryeadmiralit të flotës osmane ku nuk vonoi organizimin e përforcimit të rrethimit të Kretës. Që prej betejës së Foçës flota venedikase kishte bllokuar Dardanelet dhe për pasojë anijet osmane nuk mund të hynin e dilnin përmes ngushticës së Dardaneleve që lidhte Detin e Zi, Detin Marmara dhe Stambollin me Kretën e detin Mesdhe. Kështu osmanët e kishin të pamundur të dërgonin trupa, pajisje dhe ndihma ushqimore në ishullin e Kretës.

Nën komandën e Kara Murat Pashës, flota osmane e përbërë nga 115 anije luftime mes të cilave edhe katër anije franceze, sulmoi anijet veneciane dhe në një betejë detare që zgjati gjashtë orë korri sukses të plotë, duke e shpartalluar flotën venedikase dhe duke hapur rrugën detare në atë që quhet si Beteja e parë e Çanakkalesë, ose e Dardaneleve. Zgjuarsia e Murat Pashës ishte vendimtare në fitoren osmane. Ai në vend që të drejtonte flotën osmane nga anija e tij, që mbante edhe flamurin e flotës, u maskua si një ushtar i thjeshtë dhe qëndronte në një anije tjetër në afërsi të saj. Venedikasit e përqëndruan krejt forcën e sulmit të tyre për të futur në dorë anijen flamurtare, por kur pas shumë përpjekjesh ia dolën, panë se Murati nuk kishte qenë aty dhe duke pritur kundërsulmin e tij, u demoralizuan dhe humbën betejën.⁷ Menjëherë pas kësaj fitoreje vendimtare, dërgoi përforcimet e shumëpritura drejt Kretës dhe u kthye në Stamboll në nëntor të viti 1654 me disa anije veneciane të kapura.

Këto suksese të padiskutueshme bënë që ai të emërohej për herë të dytë si kryevezir më 11 Maj 1655. Kjo erdhi pasi veziri i madh Ibsir Mustafa Pasha, duke e ndjerë veten të kërcënuar nga popullariteti i Muratit, filloi ta shihte si rival që duhej mbajtur larg Stambollit. Përpjekjet e kryevezirit për ta larguar nga Stambolli nuk patën sukses, sepse më 8 Maj 1655 Murati mblodhi në afërsi të Topkapisë mbështetësit e tij nga jeniçerët dhe agallarët të

cilët u treguan të gatshëm të këkonin dorëheqje e kryeministrit. Kaq mjaftoi që sulltani Mehmeti IV t'i dorëzojë menjëherë vulën Kara Murad Pashës dhe e bëri atë kryevezir.⁸

Qëndrimi i tij në këtë post nuk zgjati shumë megjithatë. Shteti osman i kishte humbur ekuilibrat për shkak të rivalitetit në oborr mes fraksioneve të ndryshme si edhe për shkak të situatës ekonomike që rëndojë nga shpenzimet kolosale për luftën e Kretës. Sërish dha dorëheqjen prej postit më 19 gusht 1655. Pas dorëheqjes u emërua në postin e rëndësishëm të bejlerbeut të Damaskut. U sëmur nga malarja dhe përkeqësimi i gjendjes së tij shëndetësore gjatë rrugës e bëri të qëndrojë për ca kohë në Hama të Sirisë në sarajin e shqiptarit Arnavut Mehmed Pasha që njihej ndryshe edhe si Imamzade. Nuk arriti t'i mbijetojë sëmundjes dhe vdiq në Hama pa mundur të mbërrijë në Damask. Ishte 65 vjeç në kohën e vdekjes së tij⁹ dhe sipas Evlija Çelebiut, u varros në tyrben e ndërtuar nga Mehmed Pasha në Hama.¹⁰

Gjykuar nga situata e paqëndrueshme politike, karriera e tij mund të konsiderohet shumë e suksesshme po të kemi parasysh se mes dy periudhave të kryeministrit të tij, pra në rreth 5 vite gjashtë pashallarë të ndryshëm u emëruan në post.

Syrja Vlora pohon se “ky qe ndër asi aventurierësh guximtarë që koha i favorizonte. Por trimnija e tij qe shkak që pati pozita të nalta. Ia doli me fitim ndër marrjeve që morri ne luftën e Gjiritit dhe kundër venedikasvet që kishin rrethue Stambollin me flotë të tyne. Kur për të tretën herë dha dorëheqjen si kryeministër dhe po shkonte në Sham, i emënuem atje, si vali, vdiq rrugës.”¹¹

Sipas Uzunçarsılıut, Murati ishte i guximshëm dhe i hijshëm. Ishte edhe orator kur e lypte nevoja. U tregua i aftë që t'i mbijetonte me aftësi edhe armiqësisë mes dy fraksioneve ne oborin sulltanor.¹² Në përgjithësi burimet dhe dëshmitarët e kohës e karakterizojnë si njeri i thjeshtë, inteligjent, i mençur, i guximshëm, gjakftohtë, zemërgjerë dhe i aftë për të gjetur mbështetjen e njerëzve përreth me fjalët e tij të matura.¹³

8. Abdurrahman Abdi Pasa, *Vekayi'nâme*, ed. Fahri Çetin Derin, iÜ Sosyal Bilimler Enstitüsü, 1993, f. 30.

9. Mehmet Canatar, “Kara Murad Pasa'nin bilinmeyen vakfiyesi”, *Osmanlı araştırmaları*, vëll. 24, İstanbul, 2004, f. 87-90.

10. Evliya Çelebi, *vëll. III*, 78.

11. Syrja Vlora, “Historia e pashallarëve shqiptarë në Perandorinë Osmane”, *AQSH*, Fondi S. Vlora, Dosja 9.

12. İsmail Hakkı Uzunçarsılı, *Osmanlı Tarihi* vëll. III. Pj. 2. XVI. *Yüzyıl Ortalarından XVII. Yüzyıl Sonuna kadar*, Ankara: Türk Tarih Kurumu, 1954, f. 397-398.

13. Abdülkadir Özcan, *TDV İslâm Ansiklopedisi'nin*, vëll. 24; Abdülkadir Özcan, “Murad Pasa (Kara)”, *Yasamları ve Yapıtlarıyla Osmanlılar Ansiklopedisi*, vëll. 2 f. 253.

Press, 1991, f. 13-132.

5. Kenneth M. Setton, *Venice, Austria, and the Turks in the Seventeenth Century*, American Philosophical Society, 1991, f. 158.

6. Iure Kovács *The Hungarian Quarterly*, Volume 4, 1963, f. 82.

7. Setton, *Venice, Austria, and the Turks*, f. 170-174.

Islami në Spanjë

NJË HISTORI E COPËZUAR, NJË IDENTITET I COPËZUAR

— Alisia Rodriguez Mejuto —

Islami u është paraqitur europianëve si diçka e huaj dhe kërcënuese, por, në fakt, ata ndajnë një histori të 1300 viteve. Spanja, në veçanti, ka një lidhje të veçantë me botën muslimane: *el-Andaluzi* ishte rezultati i kontaktit të parë të Islamit me Europën.

Por, që me rënien e Granadës, një aparat i suksesshëm propagande po i mbulon dhe po i shtrembëron ngjarjet historike, duke krijuar kështu një identitet kolektiv të copëzuar dhe të lëndueshëm, të paaftë për ta brendatrupëzuar dhe shprehur qartë pjesën e së shkuarës së një populli të tërë, dhe kjo traumë vazhdon sot në shoqërinë spanjolle.

“Spanja bashkëkohore u bën fuqimisht publicitet Alhambrës dhe monumenteve të tjera të el-Andaluzit si atraksione të mëdha turistike. Ndonëse promovuesit dhe udhërrëfyesit e turneve nuk e vënë plotësisht në dukje se këto janë trashëgimi të gati tetë shekujve, gjatë së cilëve muslimanët jo vetëm e morën Spanjën, por mbollën rrënjët e Rilindjes Europiane përmes bartjes së pashoqe të dijes në thujtë çdo fushë të njohur. Me fjalë të tjera, ndërsa Spanja dhe Perëndimi janë të lumtur të jenë trashëgimtarë të trashëgimisë së Spanjës islame dhe të përfitojnë prej saj, kanë një ngurrim të paepur për ta pranuar se si ajo trashëgimi ndihmoi për ngjitjen e Europës. Udhëtari amerikan, Uashington Irving (Washington Irving), e vuri re këtë paradoks kur vizitoi Spanjën gjatë fillimit të shekullit të tetëmbëdhjetë. Spanjollët, u shpreh ai, i konsideronin muslimanët vetëm si ‘pushtues dhe uzurpues’; dhe kështu duket të jetë ende dhe tani...”

Në ditët e sotme ka rreth 200 xhami në Spanjë, 50 prej tyre në rajonin e Andaluzisë. Dikur, sigurisht, kishte mbi 1600 xhami vetëm në Kordovë!”

Përshkrimi i mësipërm përmbledh në mënyrë të përkryer identitetet paragjyquese spanjolle dhe përrëndimore. Por le të bëjmë një udhëtim të shkurtër

në të shkuarën dhe të shohim jehonat dhe rrjedhojat e atyre ngjarjeve historike në të tashmen.

Spanja ishte përpjekja e parë për të vënë këmbën në Europë në kërkimin për ta universalizuar mesazhin e Islamit dhe për të treguar se si formula e tij e thjeshtë dhe e pastër, teuhidi, ashtu si shiu, mund të bënte të lindnin një larmi shprehjesh kulturore, kërkimi shkencor dhe aktiviteti tregtar. Hapja e Spanjës është përhapja e natyrshme e një force të zgjerueshme të vënë në lëvizje nga bërthama e bashkësisë muslimane që kishte lindur gjatë jetës së Profetit (a.s.).


Unë huazova disa paragrafe të kronologjisë vijuese për të treguar ngjarje të rëndësishme gjatë kësaj periudhe 800-vjeçare që ndihmuan në formimin dhe mbajtjen gjallë të gjendjes aktuale konfliktuale shoqërore, fetare dhe kulturore.

Periudha nën sundimin islam në Spanjë dhe në Portugali nisi më 19 korrik 711 dhe përfundoi më 1 janar 1492. Kronologjia është si vijon:

19 korrik 711 gjer në vitin 714: çlirimi dhe konsolidimi musliman.

912-961: sundimi i Abdurrahmanit III, më i madhi i omejadëve iberikë. El-Andaluzi është vendi më në lulëzim në tërë Europën. Vetëm Konstandinopoja e rivalizon Kordovën. El-Medinetu’z-Zehra (qyteti i lulëzuar) është ngritur si një qytet mbretëror.

“El-Andaluzi ishte midis manifestimeve më të mëdha të qytetërimit që ka parë ndonjëherë Europa. Andaluzianët ishin në mënyrë të vetëdijshme europianë, dhe e kultivuan atë identitet në poezinë e tyre. Nga pikëpamja etnike, muslimanët andaluzianë nuk dallonin në mënyrë domethënëse nga fqinjët e tyre krishterë në veri. Qytetërimi andaluzian qe tolerant dhe kozmopolitan; ai i përqafoi muslimanët,



të krishterët dhe hebrenjtë. Popullsia e tij muslimane ishte e ndryshme: iberikë [latinë dhe keltë], berberë, arabë, teutonë, afrikanë nënsaharianë, sllavë, persianë, e të tjerë. El-Andaluzi njohu në kohët e veta më të errëta ndarjet e shëmtuara racore, veçanërisht midis berberëve dhe arabëve, por ia doli shpejt ta arabizonte popullsinë e vet dhe t'i bashkonte ata në një trup”.

1095: Iberia është bërë teatri perëndimor i luftës së Europës katolike kundër Islamit. Ka një ndërhyrje të shtuar të huaj kishtarë dhe ushtarakë (europianoveriore) në jug të Pirenejve. Me fillimin e kryqëzatave të mëdha pas Klermontit, rishtënia në dorë e Spanjës dhe Portugalisë është bërë një fazë thelbësore në rrugën për në varrin e Shenjtë të Jerusalemit. Papët e Romës do të përkrahin nga shekulli i 11-të deri në shekullin e 15-të një luftë të armatosur tërësore kundër Islamit në Iberi dhe në Lindjen e Mesme.

1 janar 1492: rënia dhe dorëzimi i Mbretërisë së Granadës mbretërve katolikë (Isabelës dhe Ferdinandit).

Shekujt e 15-të dhe 16-të: inkuizicioni spanjoll bëhet instrumenti kryesor i shtetit për sjelljen e hegjemonisë dhe të unifikimit kulturor, gjuhësor e politik të Spanjës nën një besim të vetëm, të bashkuar, katolik. Inkuizicioni shërbeu si aparat sigurimi shtetëror dhe si mjet i enkulturimit spanjoll. Gjuha arabe, veshjet dhe zakonet muslimane janë ndaluar me ligj.

1609: zgjidhja përfundimtare. Edikti i Dëbimit të moriskëve nga Spanja.

1834: Inkuizicioni spanjoll është zhdukur për jetë të jetëve. Në vitet 1830, një morisko i zonave malore të Sierra Nevadës në Granadë ishte muslimani i fundit që do të ekzekutohej në Spanjë nga Inkuizicioni.

Fillimi i shekullit të 20-të: është e zakonshme për kumbarat në fshatrat spanjolle t'u thonë prindërve të një fëmije pas pagëzimit nën patronazhin e tyre: “Miq, këtu është djali juaj. Ju ma dhatë atë një maur, dhe unë ua ktheva si një të krishter.”

Propaganda zyrtare e vënë në punë menjëherë nga sundimtarët gjatë Inkuizicionit depërtoi në tërë shprehjet e shoqërisë, duke i dhënë trajtë një miti dhe perceptimi të rremë në vend të një realiteti historik. Ajo u kristalizua në moton e tashme kombëtare: *“Spanja u pushtua nga arabët (muslimanët), dhe pas 800 viteve lufte ne ishim në gjendje ta rimarrim Spanjën prej atyre “pushtuesve dhe uzurpuesve”.*

Por, nëse e zbulojmë këtë qasje ideologjike ndaj historisë, ngjarjet na tregojnë se:

– Spanja nuk ekzistonte si entitet politik në ato kohë; ato ishin mbretëritë vizigote në luftë civile.

– Ai nuk ishte një pushtim. Gjeneral Tarik bin Zijadi u thirr për ndihmë. E shpjeguar kjo qoftë me arsyen e historisë legjendare të Kont Julianit, qeverisësit vizigot të Ceutës, dhe humbjes së nderit të vajzës së tij prej mbretit Roderik, apo me versionet e ndryshme historike që tregojnë se bijtë e shpronësuar të mbretit vizigot të vdekur së fundi, Vitizës, iu drejtuan muslimanëve për ndihmë në luftën civile.

– Ata nuk ishin arabë: Tarik bin Zijadi dhe ushtria e tij ishin në shumicë dërrmuese berberë.

– Ata nuk dëbuan “maurët” apo “moriskot”: më 1609, pas 800 vitesh, dëbimi ishte për spanjollët, muslimanët spanjollë, jo për të huajt apo për të ardhurit rishtas.

– Ideja e rreme e një *Rekonkuiste*: mbretëritë krishtere ishin ngritur pas arritjes së Islamit. Do të ketë qenë me tepër një çështje e legjitimitetit politik të këtyre mbretërve, që e konsideronin veten pasardhësit dhe trashëgimtarët e vërtetë të vizigotëve, dhe përpjekje e mbretërve krishtere (veçanërisht të Kastiljes) për të justifikuar pushtimet e tyre. Historianë me emër, të tillë si Ignacio Videla Olague të “Revolucioni islam në Perëndim”, besojnë se pushtimi ushtarak arab është një mit, dhe janë të mendimit se krijimi i el-Andaluzit ishte rezultat i konvertimit në Islam të shumë prej popullsisë hispanike. Këto teza janë studiuar nga arabisti i famshëm Gonzales Ferrin të punimi i tij, “Historia e përgjithshme e el-Andaluzit”, ku, duke folur për Rekonkuistën, ai thotë “se nuk ekzistoi kurrë vërtet”, dhe sugjeron gjithashtu që el-Andaluzi “është një hallkë e domosdoshme në historinë europiane”.

Sot në shoqërinë spanjolle ka një tension të dukshëm ndaj bashkësisë muslimane, të përbërë kryesisht nga marokenë dhe pakistanezë, dhe shpesh konfliktet dhe polemikat lindin për shkak të një vendi të ri adhurimi apo për arsye të hixhabit të grave. Muslimanët janë gjithmonë të dyshimtë, dhe një prani e bezdisshme, edhe muslimanët spanjollë madje. Në imagjinatën popullore, “maurët janë duke u kthyer”; paradoksi është se maurët kurrë nuk ikën plotësisht, ata po rrjedhin në gjakun e tyre, në pritje për t'u njohur!

Je i lodhur, e di

— Neslihan Nurturk —

A ka ndonjë punë më fisnike se të lodhurit për hir të Allahut Teala?

Kjo lodhje sublime është më e këndshme se çdo mirësi tjetër.

Kur e them këtë, jam e vendosur në veten time. Ndjehem një pjesë e jotja, dëshiroj të jap këshilla dhe në këtë mënyrë shpresoj të pushoj pak me prehjen që të jep kjo punë e mirë.

Në të vërtetë, nuk na lodh të punuarit, por të qëndruarit pa punuar duke thënë: “Sa shumë punë kam!” Kujt i ka bërë dobi lodhja e të folurit bosh? Borxhi nuk paguhet duke fjetur, shtëpia nuk ngrihet duke mos punuar dhe rrugët nuk pastrohen vetëm duke i parë. Nëse njeriu dëshiron t’ia dalë mbanë ndonjë çështjeje, atëherë duhet të punojë. Jo vetëm hekuri, por edhe njeriu që nuk punon zë ndryshk, sëmuret dhe kaplohet nga halli. Një njeri mund ta konsumojë veten edhe vetëm duke ndenjtur pa bërë asnjë gjë. Nevoja që natyrshmëria jonë ndjen për begatinë që vjen nga puna nuk është më e pakët se nevoja që ndjen ai për ujin dhe ushqimin. Siç bëhet i rëndë uji i ndenjtur, me kalimin e kohës edhe njeriu rëndohet si shpirtërisht ashtu edhe materialisht.

Je i lodhur, e di.

Atëherë bëj diçka të mirë për veten tënde dhe lëviz.

Po, kjo botë është mjaft e lodhshme. Në njërën anë luftë, zi buke, tragjedi dhe vdekje, ndërsa në anën tjetër papërgjegjshmëri, harxhim i tepërt dhe padrejtësi. Përveç të tjerash, edhe shikimi nga larg i këtyre është tepër lodhës. Brejtja që të jep në shpirt pamundësia për t’ia zgjidhur hallin dikujt dhe për ta ndihmuar atë që është në nevojë, nuk është aspak për t’u nënvlerësuar. Neglizhimi ndaj falënderimit të Zotit (xh.sh.), e lodh tepër zemrën.

Je i lodhur, e di.

Atëherë mos u mjafto me imagjinatën dhe ankesën, por drejtoju punëve të dobishme!

Në të vërtetë, çfarë është jeta përveçse një lodhje që nga lindja e deri në vdekje? A nuk

është e lodhshme çdo punë duke filluar që nga futja e kafshatës në gojë për ta përtypur e deri te mbartja e një peshe për ta shpjerë diku? Nisur nga fakti se çdo vepër kërkon mund dhe përpjekje, atëherë a nuk është e kotë që të mos e duash lodhjen? Nisur nga kjo, e gjithë çështja është se me çfarë do të lodhemi. E gjithë çështja është që ta dimë se Allahu Teala e bën shkak për faljen e gabimeve të besimtarit çdo lodhje e mundim duke filluar që nga sëmundjet kronike, fatkeqësitë, vështirësitë dhe problemet e deri te ngulja e një gjembi në këmbë.¹

Je i lodhur, e di.

Atëherë dija mirë vlerën vetes dhe falënderoje Zotin (xh.sh.), për lodhjet.

Kur të kesh mundësi dhe dëshirë, fal namaz nafle. Kur të ndjesh lodhje dhe këputje, shtrihu dhe fli.² Çdo makinë që ka punuar për orë të tëra, çdo karvan që ka udhëtuar për ditë të tëra dhe çdo tokë që ka dhënë prodhim përgjatë çdo vere, e meriton të pushojë. Nëse edhe ti dëshiron ta dish se ke të drejtë apo jo për të pushuar, atëherë shiko punët që ke bërë, rrugët që i ke kaluar dhe frytet që ke dhënë. Nganjëherë nuk mund t’i mbarosh punët sado që të lodhesh, nuk mund të përparosh sado që të përpiqesh dhe nuk mund të fitosh sado që të mundohesh.

Në situata të tilla vërja veshin ndërgjegjes e cila gjithmonë të tregon më të drejtën.

Mos vallë ke punuar dhe je lodhur, por Allahu nuk ta ka vlerësuar? Mos vallë e ke mashtruar veten duke pandehur se ke punuar? Prandaj mendo, mos vallë rezultati ka qenë humbje për shkakun tënd? Nëse fajin për dështimin tënd ia vë Allahut dhe robërve dhe nëse përgjegjësitë i kërkon gjithmonë te të tjerët në vend se të shohësh dhe t’i rregullosh mangësitë e kusuret e tua, asnjëherë nuk mund të pushosh.

Je i lodhur, e di.

Atëherë shikoj me nënshtrim ndaj Zotit (xh.sh.), ato që kanë ndodhur dhe ato që nuk kanë ndodhur.

Me të vërtetë, vetëm në këtë mënyrë mund të

shpëtosh edhe nga lodhja prej ngjarjeve dëshpëruese që ndodhin në këtë botë. Atëherë jepja hakun nefsit tënd. Haku i nefsit nuk është që ta lodhësh me ankime e mëkate, por me vepra të mira. Vërja veshin dhe dëgjoje, përse po të dhemb kurrizi? Nganjëherë mendo, përse të dhemb koka? Cili është shkaku i lodhjes së dorës, krahut, këmbës, zemrës, gjuhës dhe trurit? Pyeti një herë, në mënyrë që edhe ata të të përgjigjen. Nëse gjymtyrët i ke lodhur me punë boshe e të padobishme, qetësoji ato me namazin e pendimit. Nëse i ke lodhur me punë të mira e të dobishme, qetësoji me namazin e falënderimit.

Je i lodhur, e di. Atëherë mbaje kokën në sexhde me një frikërespekt më të madh ndaj Allahut Teala.

Pastaj mos u ndal. Puno për ta vlerësuar sa më mirë kohën tënde e cila në të vërtetë është shumë e kufizuar. Mësohu të veprosh me çdo gjymtyrë tënden brenda kornizës së Kuranit dhe Sunetit. Kur të vish në një gjendje që të të jenë konsumuar të gjitha fuqitë, përqafo mirësinë të quajtur gjumë. Bëje me nijet të mirë, në mënyrë që edhe gjumi të të bëhet ibadet. Lodhjen ta heq edhe një bisedë me mikun, një vizitë e të afërmit dhe një soditje e qiellit. Siç e di, edhe ushqyerja e të varfrit, veshja e jetimit të shpëton nga lodhja. Për dikë që është lodhur në vepra të mira, një pjatë supë, një filxhan kafe, një gotë qumësht është edhe shërim, edhe haku i tij.

Je i lodhur, e di.

Atëherë dhuroji vetes dhe të tjerëve.

Nëse i kushton rëndësi çdo lajmi që të intereson ose jo dhe çdo problemi që mund ta zgjidhesh ose jo, do t'i shtosh edhe më shumë lodhjet. Në vend që të veprosh kështu, të nënshtruarit ndaj më të fuqishmit duke e pranuar dobësinë, të jetuarit me një këndvështrim me real duke u dhënë më shumë ndaj detyrave bazë, të pranuarit se nuk mund t'i ndihmohet të gjithë dhe të pranuarit se nuk mund ta arrish çdo gjë në çdo vend, do të të ndihmonte që të mos biesh në lodhje të panevojshme. Njeriu shpesh herë e konsumon energjinë e tij duke u dëshpëruar ngaqë nuk i ndihmon dot njerëzit larg. E kështu, privohet edhe nga mirësitë që mund t'ua bëjë njerëzve që janë afër. Siç e kupton edhe vetë, kjo është në kundërshtim edhe me mendjen, edhe me ndërgjegjen. Mbi të gjitha është edhe dëshmimi apo zhytja në mëkate. Kjo ndoshta është lodhja më rraskapitëse.

Je i lodhur, e di.

Atëherë mbroji sytë, pendohu shumë dhe ji realist.

Në të vërtetë, njeriu çuditërisht gjithmonë është i prirë për t'u lodhur. Njeriu lodhet duke lexuar libra, duke falur namaz, duke bërë pastrimin, duke fituar para, duke mbartur ngarkesë, duke fjetur, duke ndenjur, duke ecur dhe duke vrapuar. Kjo është një gjendje e

çuditshme, por ja që për njeriun është lodhje edhe ta përgatisë ushqimin dhe ta hajë atë ushqim që ka përgatitur. Kështu është edhe të shkruarit, të thururit, të ndërtuarit e murit, të gatuarit e ushqimit, të qepurit e rrobave, të bërët e llogarive, të folurit, të heshturit, etj... Njeriu lodhet kur pret për të përfunduar një punë, kur pret për të ardhur dikush, kur nuk dashuron dot dhe kur nuk mund të falë dot. Përfundimisht, të qenët në këtë jetë është një veprim i lodhshëm në këtë apo atë lloj mënyre. Ndërsa gjëja që e bën atë të lodhet më pak është përpjekja për të jetuar sipas kënaqësisë së Allahut të Madhëruar. Në këtë mënyrë, lodhja bëhet e këndshme dhe fisnike.

Je i lodhur, e di. Atëherë dua, bëji të tjerët të të duan dhe mëso të falësh.

Kur të të lodhet zemra, vër në punë trupin. Kur të të lodhet trupi, vër në punë trurin. Në të vërtetë, ata të gjithë punojnë së bashku, por nganjëherë njëri punon më shumë se tjetri apo i duhet të lodhet më shumë se tjetrit. Nganjëherë rruga e vetme dhe më e mirë për ta qetësuar mendjen është të vrapuarit deri në pikën e fundit të fuqisë si një kalë pa frerë. Të zgjedhurit e rrugës shpesh herë nuk është në dorën tënde. Nëse beson se ajo që të ka takuar është më e mira, do të pushosh. Nëse ankohesh dhe përpëlitesh duke e kundërshtuar caktimin e Zotit (xh.sh.), do të vësh re se vetëm do ta vështirësosh edhe më shumë punën tënde. Mbi të gjitha, përpara teje është edhe shtegu i tmerrshëm i vdekjes që po të pret. Në këtë shteg me shumë mundësi të pret një lodhje e madhe. Atëherë, mos vallë po thua se ia vlen të preokuporesh me lodhjet e padobishme të kësaj bote?

Je i lodhur, e di. Atëherë pranoje caktimin e Zotit (xh.sh.) dhe vdis para se të vdesësh, në mënyrë që të të lehtësohet puna në të dyja botët.

Referencat: 1. Muslim, birr, 49. / 2. Buhari, Tehexhahud, 18.



Parasitë E PROFETIT (a.s.)

— Ferit Piku —

Zoti ynë na urdhëron në Kuranin Famëllartë duke thënë: **“Atë gjë që ua jep Muhamedi, merreni, atë që ua ndalon Muhamedi, ndalohuni prej saj, kini frikë Allahun, se dënimi i Tij është i ashpër”**. (Hashr, 7).

Figura e profetit (a.s) është madhështore. Sado që të flasin gjuhët, sado që të shkruajnë librat, ai mbetet madhështor, sepse të tillë e krijoi Zoti i gjithësisë.

Ai nuk ishte vetëm profet, ai nuk ishte vetëm njeri i madh, por ishte një vëlla i mirë, një shok i mirë, një edukator i jashtëzakonshëm.

Ishte nga ata njerëz, që kur e shikonte një të keqe, i digjej zemra dhe me urtësinë më të madhe e korrigjonte atë. Ishte nga ata njerëz, që kur e pyesje për diçka të mirë, me zellin më të madh që mund të ketë ndonjë mësues, ia shpjegonte nxënësit më së miri atë që pyeste. Fjalët e tij ishin të pakta, por kishin kuptim të thellë. Kur dora e tij e butë vihej mbi supin e njërit prej shokëve të tij, fjalët që dilnin nga goja e profetit (a.s) futeshin thellë nëpër zemra e nuk harroheshin asnjëherë. E merrte shokun e tij anash dhe i fliste dy – tre fjalë. Ishin fjalë me peshë, sepse dilnin nga zemra e atij personi, që e donte çdo njeri. Këto porosi të vogla i mjaftonin shokut të tij për gjithë jetën. Me dy – tre fjalë ai e mësonte fenë e Zotit. Me dy – tre fjalë ai e ruante besën dhe amanetin e Zotit.

Kam zgjedhur vetëm një nga porositë e profetit (a.s), një fjalë që Muhamedi (a.s) ia tha njërit prej shokëve të tij që e donte shumë. Realisht ai i donte

të gjithë shumë, por këtë e donte, sepse ishte nxënës i zgjuar dhe pyeste vazhdimisht. Ai ishte Muadh Ibn Xhebel (r.a).

Muadh Ibn Xhebel (r.a) e donte xhenetin dhe e kishte frikë xhehenemin. Ai tregon: “Kur e pashë një ditë profetin (a.s) vetëm, larg të tjerëve iu afrova dhe i thashë: “O profet i Zotit! Kam një pyetje që s’më le të fle natën dhe më ka shqetësuar shumë. Ma trego një punë që më fut në xhenet dhe më ruan nga zjarri? Vetëm kaq dua”.

Profeti (a.s), i cili shikonte besnikëri dhe sinqeritet tek Muadhi i përgjigjet: **“O Muadh ke pyetur për një gjë të madhe, por që me lejen e Zotit është e lehtë, për ata, që Zoti ua lehtëson. O Muadh adhuroje Zotin dhe mos i bëj shok Atij. Fale namazin, jepe zekatin, agjëroje Ramazanin dhe bëje haxhin nëse ke mundësi”**.

Pastaj mësuesi e pyet nxënësin e tij, sepse ishte nxënës besnik dhe i zellshëm: **“O Muadh a ke dëshirë të t’i tregoj dyert e punëve të mira”?** “Patjetër o profet i Zotit – thotë Muadhi – m’i trego”.

Profeti (a.s) vazhdoi: **“O Muadh! Agjërimi është mburojë, sadakaja i fik gjynahet si uji zjarrin. Fale namazin në mesin e natës”**. Pastaj lexoi ajetin kuranor ku Zoti thotë: **“...dhe trupat e tyre largohen natën nga shtrati, e lusin Zotin me frikë e me shpresë dhe nga ajo që u kemi dhënë ata japin. Nuk mund ta dijë askush se çfarë shpërblimi është fshehur për ta. Është shpërblim për atë që kanë punuar”**. (Sexhde: 16-17).

Pastaj vazhdoi përsëri profeti (a.s): “**O Muadh a do ta dish kokën, shtyllën dhe kulmin e kësaj pune**”? - Muadhi i përgjigjet: “Patjetër o profet i Zotit”.

Profeti (a.s) tha: “**Koka është Islami, shtylla është namazi dhe kulmi është xihadi në rrugën e Zotit**”. Pastaj tha: “**O Muadh a do ta dish kryesoren e të gjitha këtyre që të kam thënë**”? - Muadhi i përgjigjet: “Patjetër o profet i Zotit”.

Atëherë profeti (a.s) kapi **gjuhën e tij** me dorë dhe tha: “**Mbaje fort këtë o Muadh**”. Muadhi (r.a) e pyeti: “O profet i Zotit! A do të na marrë Zotit në llogari edhe për fjalët që flasim”? Profeti (a.s) tha: “**Të pastë nëna o Muadh, po a ka gjë që i fut njerëzit në zjarr më shumë se gjuha e tyre**”?¹

Këto ishin fjalët e mësuesit, fjalët e profeti (a.s), fjalë të vogla por që lanë ndikim të madh në zemrën e Muadhit, prandaj ai ia thoshte këto fjalë çdo njeriu që takonte.

Çfarë ishin këto fjalë? E thënë shkurt, shqetësimi i Muadhit (r.a) ishte shqetësimi i sahabëve. Ata nuk ishin njerëz të fjalëve. Ata flisnin pak e punonin shumë. Pyesnin pak e zbatonin shumë. Ata nuk i zinte gjumi natën nga shqetësimi “A do të hyjmë në xhenet apo në zjarr”. Ata e kishin kuptuar situatën dhe ishin të sigurt se e ardhmja e tyre ishte xhenet ose zjarr. Për këtë e pyeti edhe Muadhi (r.a) profetin (a.s), për atë punë që të çon në xhenet. Profeti (a.s) nuk i tha thjesht: “Bëj punë të mira”, por i tha: “**O Muadh, ti po pyet për një gjë të madhe**”.

A të duket e lehtë të hysh në xhenet e të ruhesh prej zjarrit?! A nuk e di se Zotit i ka dërguar fetë për këtë punë, profetët kanë ardhur për këtë punë, librat kanë zbritur për këtë punë. Zotit thotë në Kuranin Famëlartë: “**Kush i largohet zjarrit dhe futet në xhenet, ai ka fituar**”. (Ali Imran: 185).

Nuk është e lehtë të hysh në xhenet. Vallahi është aq e vështirë, saqë kur melekët e panë xhenetin se me çfarë vështirësisht ishte rrethuar, thanë: “O Zot, askush nuk do të hyjë në xhenet”. Por Zotit tha: “Do të hyjnë ata që i përveshin krahët për këtë dhe Unë do t’ua lehtësoj”. Kush e do rrugën e mirë, sado e vështirë të jetë ajo, bëhet e lehtë me lejen e Allahut (xh.sh), sepse e lehtëson Zotit i gjithësisë.

Kush e do rrugën e keqe, ajo është e lehtë dhe Zotit nuk vështirëson për këtë, por në fund të gjithë do

të kthehemi tek Allahu (xh.sh) e do të japim llogari për atë që kemi punuar e dijeni se Zotit nuk e do të keqen dhe nuk i bën padrejtësi askujt.

Profeti tha: “**O Muadh! Adhuroje Zotin dhe mos i bëj shok Atij**”. Zotit të ka krijuar, të ushqen, të furnizon, të ka dhënë jetën. Mos i bëj shok Zotit, se atëherë ke bërë padrejtësinë më të madhe që mund të bëjë dikush. Pastaj profeti (a.s) tha: “**O Muadh fale namazin, agjëroje Ramazanin, jepe zekatin dhe bëje edhe haxhin nëse ke mundësi**”. Profeti (a.s) nuk e la me kaq, por vazhdoi edhe më tej, në mënyrë që të kemi mundësi të dëgjojmë të gjithë ne dhe tha: “**A do t’i dish rrugët e punëve të mira**”? E tha këtë, sepse donte t’i tregonte nxënësit të tij, se ka punë të mira që pak njerëz i bëjnë, por nëse do që të hysh në xhenet, duhet t’i bësh këto punë.

CILAT JANË KËTO PUNË?

AGJËRIMI - Profeti (a.s) tha: “**Të agjërosh nafile (vullnetarisht), është mburojë**”. Kur ushtari shkon në luftë, merr mburojën me vete. Po kështu kush agjëron nafile, pra jo vetëm në muajin e Ramazanit, por edhe jashtë tij, ai mbron veten e tij nga fjalët dhe punët e pahijshme. Agjërimi e mbron robin nga zjarri i xhehenemit.

Profeti (a.s) ka thënë: “**Kush agjëron vetëm një ditë për hir të Allahut (xh.sh), Allahu (xh.sh) e largon atë njeri 70 vite nga zjarri i xhehenemit**”². Agjërimi është mburojë. Kush ka mundësi le ta bëjë këtë punë, sepse Zotit do ta ruajë në këtë botë dhe në botën tjetër.

SADAKAJA- Profeti (a.s) tha: “**Sadakaja i fik gjynahet si uji zjarrin**”. Pse tha “**i fik**” dhe nuk tha “**i fshin**”. E tha kështu, sepse gjynahu është i nxehtë dhe duhet diçka për ta fikur atë. Kush ka mundësi le të japë sadaka me pasuri, me fjalë, me ndihmë, me kontribut fizik. Nëse nuk bën keq, dije se edhe kjo është pjesë e sadakasë. Sadakaja e fik zemërimin e Allahut (xh.sh). Zotit na bëftë nga ata njerëz, tek zemra e të cilëve sadakaja ka vend, sepse kush ka vend në zemrën e tij për sadaka, inshallah do t’ia japë Zotit mundësinë të bëjë sadaka edhe me dorën e tij.

NAMAZI I NATËS - Profeti (a.s) tha: “**Të falësh dy rekate namaz në mesin e natës**”. Kjo të ruan në këtë jetë dhe në jetën tjetër, sepse është krenaria e besimtarit dhe pak besimtarë e bëjnë një gjë të tillë. Na bëftë Zotit nga ata njerëz, që u del gjumi dhe ngrihen e falin qoftë edhe dy rekate namaz nate.

*O Muadh
ke pyetur për një gjë
të madhe, por që me
lejen e Zotit është e lehtë,
për ata, që Zotit ua lehtëson.
O Muadh adhuroje Zotin
dhe mos i bëj shok Atij.
Fale namazin, jepe zekatin,
agjëroje Ramazanin
dhe bëje haxhin nëse
ke mundësi”.*

1. Tirmidhiu, Ahmedi dhe Nesaiu. Tirmidhiu e vlerëson hadithin të pranuar, të vërtetë

2. Buhariu dhe Muslimi.

Nëse nuk kanë mundësi të marrin abdes e të falen, të paktën të thonë njëherë me gjuhë fjalën LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH, se Zoti u thotë melekëve: “A e shihni robin Tim. Po ngrihet natën e po më kujton Mua. A keni parë ndonjëherë njeri të tillë”? Me të vërtetë është dhunti e madhe, prandaj Zoti na ndihmoftë mbi vetet tona.

Pastaj profeti (a.s) vazhdoi: “**A do ta dish kokën e kësaj pune, shtyllën dhe kulmin e kësaj pune**”?

Koka është **ISLAMI**. Islami është gjithçka. Kush ka Islam in ka gjithçka, kush ka humbur Islam in, ka humbur gjithçka. Islam do të thotë dorëzim me zemër tek Zoti i gjithësisë. Flasin për dorëzim me dëshirë, se me imponim të gjithë njerëzit dorëzohen tek Allahu (xh.sh).

Shtylla e kësaj feje është **NAMAZI**. A ndërtohet çadra pa shtyllë? Po shtëpi pa kolona e pa mure a keni parë ndonjëherë? Po kështu nuk ndërtohet feja e Zotit, për robin që nuk fal namaz. E di që mund të gjenden 1000 justifikime për të mos e falur namazin, por çfarë t’i themi Zotit, që i di punët dhe hallet tona.

O vëllezër ky problem është i sqaruar. Kush ka mëshirë për veten e tij, le të punojë. Kush nuk ka mëshirë, ai merr në qafë vetëm veten e tij. Namazi është shtylla e kësaj feje. Kush rrëzon këtë shtyllë, e ka rrëzuar fenë e Allahut (xh.sh).

Kulmi i fesë është **XHIHADI NË RRUGËN E ZOTIT**. Xhihad do të thotë të përpiqesh me gjithçka që ke, me fjalën tënde, me pasurinë tënde, me punën tënde, me penën tënde, me fjalën tënde, me trupin tënd. Të përpiqesh në rrugë të Zotit e t’ua duash njerëzve të mirën. Islami nuk është feja e rehatlinjve, feja e atyre që e jetojnë jetën si t’u vijë ose mundohen të jetojnë ndryshe nga të tjerët. Është feja e njerëzve që duan të derdhin djersë, që duan të lodhen, është feja e xhihadit vetëm për hir Zotit.

Xhihadi nuk është vetëm luftë, por është shumë më tepër se kaq. Në fund vjen edhe lufta, me qëllim që të gdhendet padrejtësia dhe të ndalet ajo.

Pastaj profeti (a.s) tha atë fjalë, që nuk e priste Muadhi (r.a) e as ne nuk e prisnim: “**O Muadh a do ta dish sekretin e gjithë këtyre punëve? Kape fort këtë (gjuhën)**”.

Muadhi (r.a) me çiltërsi e pyet profetin (a.s): “O profet a për fjalët që themi do të na marrë Zoti në llogari”? Profeti (a.s) ia kthen: “**Të pastë nëna ty o Muadh. Po a nuk e di ti se ajo që i fut njerëzit më shumë në zjarr, është gjuha?!**”

Gjuha i fut njerëzit në zjarr. Kur njerëzit e analizojnë veten e tyre thonë: “A për këtë gjuhë u futëm në zjarr? Asnjëherë nuk na paska shkuar nëpër mend kjo gjë”.

Prandaj profeti (a.s) ka thënë: “**Kush ma garan-**

ton epshin e tij dhe gjuhën e tij, unë i garantoj xhenetin”³. Garantoni nderin dhe gjuhën tuaj, t’jua garantojë profeti (a.s) xhenetin.

Pse gjuha? Me gjuhë mohohet Zoti. Me gjuhë akuzohet, me gjuhë gënjehet, me gjuhë bëhen padrejtësi, me të bëhen të gjithë të zezat. Për gjuhën sahabët kanë thënë: “Kjo (gjuha) është dashur të mbahet në burg më shumë se gjithçka tjetër”.

Zoti na bëftë nga ata njerëz, që iu mjaftojnë dy – tre fjalë. Njerëzve të mirë nuk duhet t’u mbash ligjërata. Njeriu i mirë e kupton dhe e pason të mirën. Ata njerëz i ka drejtuar Allahu (xh.sh) dhe ata me të vërtetë janë të mençur. Kjo është gjithçka në këtë jetë.

Profeti (a.s) e merr njëherë tjetër për dore Muadh in (r.a), ecën pak dhe i thotë: “**O Muadh po të jap disa porosi, prandaj kije mendjen. O Muadh kije frikë Zotin, thuaje të vërtetën, mbaje besën, dorëzoje amanetin, braktise tradhtinë, mëshiroje jetimin, ruaje komshiun, mbaje zemërimin, zbutë fjalën, jepe selamin, mos iu ndaj grupit, kuptoje Kuranin, duaje ahiretin, frikësoju llogarisë, mos iu mbështet shumë kësaj jete se është e shkurtër, punën që të besohet bëje sa më mirë. O Muadh unë po të ndaloj për diçka prandaj ki kujdes. Mos e shaj myslimanin, mos e beso gënjeshtarin, mos e përgënjeshtro të sinqertin, mos e kundërshtoj prijësin e drejtë, mos prish në tokë. O Muadh kujtoje Zotin në çdo pemë e në çdo gur. Sa herë që të bësh një gjynah, pasojë gjynahun me pendim, qoftë kur je vetëm, qoftë edhe kur je me njerëzit e tjerë**”.

Zoti na bëftë nga ata njerëz, që pyesin pak e punojnë shumë. Zoti na bëftë nga ata, që e dëgjojnë fjalën e mirë dhe e pasojnë atë në formën më të mirë.

E lus Allahun (xh.sh) të fusë në zemrat tona dashurinë për profetin (a.s), të na bëjë nxënës të mirë të këtij profeti, të këtij mësuesi.

E lus Allahun (xh.sh) t’i falë gabimet tona, të mëdhatë e të voglat, ata që duken e ata që nuk duken.

E lus Zotin e gjithësisë t’i ruajë zemrat tona, gjuhët tona dhe gjymtyrët tona.

E lus Allahun (xh.sh) të mos sillet ndaj nesh siç ne e meritojnë, por siç i takon madhësisë dhe mëshirës së Allahut (xh.sh), Ai është falës i madh, Ai e pranon pendimin e robit të Tij.

Lus Zotin të na mëshirojë ne dhe prindërit tanë, ata që janë gjallë e ata që kanë vdekur, të gjithë myslimanët kudo që janë, të gjithë njerëzit që duan mëshirën e Allahut (xh.sh).

Amin!

3. Buhariu.



PAJTIMI NDËRMJET BESIMTARËVE

— M. Sami Ramazanollu —

Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që të mëshiroheni.” (Huxhurat, 10)

Pra, për shkak se besimtarët janë të gjithë të mbledhur nën flamurin e teuhidit, ata janë si vëllezër të lindur prej një nëne dhe një babai. Prandaj, nëse midis vëllezërve shfaqen grindje dhe debate, atëherë pajtojini ata.

“...Mos e nënçmoni dhe mos e qesëndisni njëritjetrin me nofka (të këqija)! Sa e shëmtuar është të thirresh me emër të keq pas (pranimit të) besimit!..” (Huxhurat, 11) Nisur nga kjo, nëse dikush e shan ose i thërret vëllait të vet me një emër të papëlqyeshëm, ai duhet të nxitojë të bëjë teube, të pendohet tek Allahu.

Pra, o besimtarë, nëse bëni gabim dhe shani njëritjetrin me fjalë të këqija, është njësoj sikur keni sharë veten tuaj, sepse besimtarët janë si një person i vetëm në vëllazërinë islame. Për rrjedhojë, nëse një besimtar shahet ose përçmohet me diçka, është njësoj sikur janë sharë dhe përçmuar të gjithë besimtarët.

Shkaku i zbritjes së ajetit fisnik në lidhje me përgojimin, ishin përgojimet ndaj Selman Farisiut (r.a.):

Në disa udhëtime, i Dërguari i Allahut, (a.s.), e caktonte Selman Farisiun (r.a.), si ndihmës të dy personave që përgatitnin ushqimin. Njëherë, Selman Farisiun (r.a.), e kishte marrë gjumi dhe nuk e kishte përgatitur ushqimin. Dy personat e dërguan Selman Farisiun (r.a.), te Profeti (a.s.), që të merrte ndonjë ushqim që mund të kishte tepruar. Selman Farisiu (r.a.), shkoi tek Usame bin Zejdi (r.a.), i cili përgatiste ushqimin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Kur Usame bin Zejdi (r.a.), i tha se nuk kishte ngelur më ushqim, Selman Farisiu (r.a.), u kthye dhe u tha

se nuk kishte ngelur më asgjë për të ngrënë.

Më pas, këta dy persona filluan ta përgojnin Selman Farisiun (r.a.), duke thënë: “Edhe nëse e çon në një pus me ujë, kthehet pa ujë!”. Madje thanë edhe se, gjoja i Dërguari i Allahut, (a.s.), paska pasur ushqim, por Usame bin Zejdit (r.a.), nuk i paska dhënë.

Kur këta dy persona erdhën para të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ai tha:

“Ç’po ndodh me mua, që po shoh copa mishi jeshile në gojën tuaj!?” Ata thanë:

“Ne nuk kemi ngrënë mish o i Dërguar i Allahut!” Mirëpo, Profeti u tha:

“Keni përgojuar Selmanin. Nëse një besimtar përgojo vëllain e tij, është njësoj sikur t’ia ketë ngrënë mishin!”

Ja pra, sipas Haizit dhe Bejdaviut, pas kësaj ngjarjeje u zbrit edhe ai ajet fisnik.

Njëherë, Ebu Dherri (r.a.), i foli rëndë Bilal Habeshiut (r.a.), duke e thirrur: “O biri i gruas së zezë!” Menjëherë pas kësaj, Bilali (r.a.), u ankua tek i Dërguari i Allahut, (a.s.), i cili tha:

“O Eba Dherr! A po e shan për shkak të nënës së tij? Domethënë, ti paske ende prej moralit të injorancës brenda teje” Më pas vazhdoi e tha:

“Ka nga ata vëllezër që janë nën urdhrat tuaja, të cilët Allahu i Madhëruar ua ka besuar juve!” (Buhari) Pra, Profeti (a.s.), ka urdhëruar që edhe pse janë ende robër, me ta duhet të silleni si vëllezër!

Më pas, për t’i fituar përsëri zemrën Bilal Habeshiut (r.a.), Ebu Dherri (r.a.), e vendosi faqen në tokë dhe tha: “Nuk do të ngrihem nga këtu derisa Bilali të më shkelë me këmbën e vet në fytyrë!”

Ja pra, në këtë hadith fisnik, ka shumë këshilla mësimdhënëse për ne, umetin e Muhammedit (a.s.).

Çfarë faji kam unë?



— Psik. Tuba Sëkmen —

Fëmija vrapoi drejt dhomës, largoi mbulesën e shtratit dhe u fut brenda. E mbuloi kokën me jorgan. Zhurma e grindjeve që shtoheshin e trembte më shumë se një përbindësh i madh. Tashmë këto ngatërresa ishin bërë një pjesë e pandarë e jetës në familje. Nuk kishte një vend tjetër ku mund të qëndronte, nuk kishte as forcën për t'i ndalur britmat... I mbylli veshët dhe zhurmat iu zvogëluan pak, por nuk ndodhi e njëjta gjë me dhimbjen që ndjente. Më në fund grindja u ndal. Fëmija mori frymë i lehtësuar, por zemra iu dridh përsëri kur dëgjoi zhurmën e derës që po përplasej. Lotët e tij të nxehtë humbeshin në jastëk. Nuk mund ta ndalonte dënesën dhe lotët që po e mbysnin.

Një qetësi e frikshme kishte zënë vendin e grindjes së potershme. Nga njëra anë ishte mbytur në djersë e nga ana tjetër vazhdonte të qante me ngashërim. Nuk kishte guxim ta largonte pak jorganin për të marrë frymë më lirshëm.

Vallë kush e kishte përplasar derën e shtëpisë? Kush ishte larguar prej tij, nëna apo babai? A ishte e vërtetë e gjithë kjo? Vallë cilin prej tyre e donte më shumë; nuk arriti që t'i jepte përgjigje kësaj pyetjeje. Mos vallë të gjitha këto po ndodhnin për faj të tij? A e kishte mërzhitur nënën, a kishte nervozuar babain? Në qoftëse ato do të ndaheshin, me kë do të jetonte? A nuk do ta donin më njëri-tjetrin

nëna dhe babai? A do të kishte njerë apo njerë? Asnjë prej këtyre pyetjeve nuk gjenin përgjigje...

Nuk dëshironte t'i mendonte këto gjëra prandaj u mundua që të kujtonte piknikun që kishin bërë vitin e kaluar. Sa herë që mërzhitej kujtonte atë piknik, atë ditë të bukur që kishin kaluar të gjithë së bashku. Ky kujtim i bukur sikur e qetësoi pak dhe më në fund e zuri gjumi.

Kur u zgjua në mëngjes i hapi sytë e fryrë nga të qarët me vështirësi dhe ndjeu një mërzi që i mbyste shpirtin. Po kujtonte ngjarjet e mbrëmshme. Nëna dhe babai ishin grindur me njëri-tjetrin dhe pastaj ishte dëgjuar zhurma e derës së shtëpisë tek përplasej. Kujtimet e natës së kaluar ia shtuan mërzhinë. Tashmë kishte ardhur koha që të dilte nga dhoma dhe të mësonte se kush i kishte braktisur. Në fillim shkoi në banjo për të shikuar sytë që i ndjente të rëndë. Sytë i ishin fryrë dhe kishin marrë një ngjyrë rozë por nuk ishin aq keq sa e kishte pritur. Dëgjoi zërin e nënës që po fliste në telefon me nënën e vet. Nga kjo kuptoi që natën e kaluar ishte larguar babai.

Vendosi që ta dëgjonte bisedën e nënës në fshehtësi. Hapi pak derën e banjos dhe mbajti frymën. Fatkeqësisht të gjitha ato që i kujtoheshin nga nata nuk ishin mankthe por ishin të vërteta sepse nëna



po fliste në telefon për to. Babai ishte larguar nga shtëpia dhe nëna ime me një zë të sigurtë thoshte se do të ndahej nga ai sa më shpejt. Nuk mund të dëgjonte një lajm më të keq se ky.

Fëmija shkoi në dhomën e ndenjës dhe priti që nëna ta mbyllte telefonin. Mori një fletore dhe në një faqe boshe të saj filloi të shkarraviste diçka në të. Nuk kishte dëshirë të hante, të vishej apo të shkonte në shkollë. Nëna nxori pak kokën tek dera dhe i tha që po bëhej vonë. Fëmija shkoi i mërzitur drejt kuzhinës dhe vendosi pak reçel në pjatë sa për t'i thënë nënës që kishte ngrënë mëngjes. Kishte dëshirë ta pyeste atë për ngjarjen e mbrëmshme, sepse donte të dinte se si mund t'i bashkonte përsëri prindërit e vet; por nuk arriti ta hapte gojën për të folur.

Bashkë me nënën shkuan në këmbë deri në shkollë. Fëmija bënte përpjekje që të merrte vesh se çfarë kishte ndodhur duke e pyetur nënën për gjëra të ndryshme por ajo i jepte vetëm përgjigje të shkurta. Dukej shumë qartë që ajo ishte e mërzitur dhe fëmija mendoi se nëna nuk do ta donte më si përpara. Po babai si ishte vallë, a do të luante me të si dikur? Ai mërzitej për veten, për nënën dhe për babain.

Teksa po ndaheshin nëna i uroi një ditë të mirë me një zë automatik dhe u largua prej tij. Fëmija shkoi me zori drejt klasës dhe u ul në bankën e vet pa folur me askënd. Nuk i interesonte asgjë nga

bota e jashtme. Ai ishte i shqetësuar për ngjarjet që e prisnin. Mësuesja e kishte vënë re qetësinë dhe mërzitjen e tij të kohëve të fundit dhe në fakt këto gjëra sikur e kishin larguar pak nga shokët.

Kur doli nga shkolla shkoi nënën që po e priste tek dera. Fytyra e saj ishte edhe më e ngrysur se në mëngjes. Kjo do të thoshte që asgjë nuk ishte rregulluar. Kur mbërritën në shtëpi ai shkoi se nëna kishte përgatitur një valixhe me rroba. I tha që do të shkonin pak te shtëpia e gjyshit dhe gjyshes për t'i vizituar ato. Ai e dinte shumë mirë që kjo nuk ishte një vizitë, por gjithsesi e pyeti nënën:

“Po babai?”

Nëna i tha se ai kishte punë dhe nuk mund të largohej dot. Fëmija e kuptonte gjendjen shpirtërore të nënës prandaj heshti në mënyrë që të mos e shqetësonte më shumë atë. Edhe në qoftëse do të fliste ishte i sigurtë që do të mbytej në lot sepse nuk ishte gadi të dëgjonte përgjigjet e nënës.

Kur po hypnin në autobus djali mendoi për dhomën e vet, lojërat, rrobat, babain... Po largohej prej tyre pa e ditur se kur do të kthehej. Ëndërroi prishjen e autobusit, ardhjen e babait për ta rregulluar atë dhe kthimin në shtëpi. Autobusi filloi të ecte më shpejt. Kur mbërriti atje shkoi se po i priste gjyshi. Djali u emocionua kur shkoi gjyshin të cilin e donte shumë por në të njëjtën kohë i premtoi vetes se kur të rritej nuk do ta linte djalin e vet në këtë gjendje.



Pijet qetësuese me burim shërimi

— Nexhla Bash —

Është gjithmonë e rëndësishme që t'i rigjallërojmë kulturat e pijeve të cilat brezi i ri nuk i njeh shumë mirë. Madje, kjo është detyrë e secilit prej nesh për të mbajtur gjallë kulturën tonë.

Këto njëzet-tridhjetë vitet e fundit, përhapja me shpejtësi e pijeve aromatike, acidike, me esencë frutash, veçanërisht kola dhe pijeve me gaz, është bërë shkak që brezi i ri të rritet larg lëngjeve të vërteta të frutave dhe në sofrat pa komposto e hoshaf.

Vendosja e kolave dhe pijeve me gaz në mes të sofrave në çdo drekë apo darkë pune dhe në çdo dasmë, ua shton edhe më shumë vlerën këtyre pijeve. Këto pije të cilat nuk lëshohen nga dora e të eturve në shkolla apo vende pune, të cilat nuk mungojnë në vaktet e ushqimit të çdo punëtori, për fat të keq kanë zënë një vend të rëndësishëm në vaktet e ushqimit.

Nuk mund të mos mërzhitesh ndërkohë që firmat kapitaliste të pijeve me gaz, nëpërmjet furisë së reklamave, po përhapen me shpejtësi në vendin tonë dhe në të gjithë botën. Prandaj çdo individ

normal duhet ta lodhë kokën dhe të mendojë se ç'duhet të bëjë. Të paktën të mos i mësojmë fëmijët dhe ta mbajmë veten larg këtyre pijeve duke futur në shtëpitë tona pijet alternative.

Në fakt ne kemi shumë pije të shijshme, me lloje e aroma të ndryshme të cilat e kanë burimin kryesor nga kuzhina Osmane. Sa keq që përpjekjet për t'i shkëputur lidhjet nga e kaluara, e kanë treguar veten edhe në kulturën e të ushqyerit. Që kjo kulturë kaq e pasur të mos zhduket plotësisht, gratë tona duhet ta marrin më seriozisht çështjen e kuzhinës dhe me kënaqësi të bëjnë një sërë përpjekjesh. Në këtë mënyrë, duke u paraqitur fëmijëve dhe të afërmve disa lloje pijesh alternative, mund t'ia dalin që t'i mbajnë larg pasionit që kanë për pijet e gazuara.

SHERBETET

Kjo është një pije që nuk mungonte në sofrat popullore të kuzhinës së sarajeve Osmane. Sherbetet ishin qerasjet më të rëndësishme të çdo shtëpie që u shërbeheshin mysafirëve të cilët vinin papritur. Meqë feja jonë është e ndjeshme ndaj ushqimeve dhe pijeve, si dhe për shkak se është haram që ato të përmbajnë alkool, kultura e pijes në botën islame është mbështetur te lëngjet e frutave dhe sherbetet. Konsumimi i lëngjeve frutore është një zakon që e praktikon e gjithë bota, por sherbeti është shfaqur dhe zhvilluar nga popujt islamë në gjeografinë e Mesdheut lindor, Lindjes së Mesme dhe Azisë qendrore.





Fjala sherbet në arabisht ka kuptimin “piu”, rrjedh nga folja “she-ri-be” duke marrë si përfundim formën “pije”.

Meqë esenca e sherbetit është shurupi, është marrë ashtu siç është në arabisht. Në arabisht përsëri “shurup” do të thotë “sherbet” dhe “pije me sheqer”. Meqë Anadoli është afër me pozitën gjeografike të Arabisë, fjala “sherbet” përdoret ashtu siç është përdorur në të kaluarën nga Osmanët.

Njohja e udhëtarëve dhe lajmëtarëve anglezë me sherbetin në periudhën Osmane u bë në sajë të përhapjes në të gjithë botën që osmanët i kishin bërë këtij produkti dhe fjalën “sherbet” e kanë marrë në gjuhën e tyre ashtu siç është. Historiani i njohur i gatimeve Alan Davidson bën të ditur se sherbeti ka hyrë në kuzhinën italiane me emrin “sorbetto” në periudhën e lidhjes Osman-Bizant-Venedik.

Sherbet lulesh

“Kuzhina helvane (ëmbëltore)” që iu shtua më vonë Sarajit të Topkapësë, u përdor pothuajse si një laborator ëmbëlsirash, shurupesh dhe sherbetesh. Sherbeti më i zgjedhur i sarajit, ishte sherbeti i luleve. Ky sherbet përgatitej veçanërisht nga trëndafili, zambaku, manushaqja, jasemini, hideja dhe zambaku i ujit. Sidomos sherbeti që bëhej nga sasia e kufizuar e zambakut të ujërave të ëmbla, bëhej shumë rrallë dhe me një recetë marramendëse.

DISA RECETA SHERBETI

Sherbeti i luleshtrydhes ose i manit të zi

Përmbajtja: 500 gr luleshtrydhe ose man të zi, 1 lt ujë, 130 gr sheqer pluhur (100% sheqer panxhari).

Përgatitja: pasi pastrohen luleshtrydhet ose manat e zi, që në mbrëmje përzihen me sheqer dhe lihen deri në mëngjes në frigorifer. Pastaj hidhen në tenxhere, i shtohet uji dhe lihen të ziejnë në zjarr të ulët. Pasi ziejnë për pesë minuta, hiqen nga zjarri dhe lihen të ftohen. Pasi ftohen, kullohet lëngu dhe serviret i ftohtë.

Sherbeti i trëndafilit

Përmbajtja: 500 gr petale trëndafili, 130 gr sheqer (100% sheqer panxhari), 1 lt ujë.

Përgatitja: Përzihen petalet e trëndafilin me sheqer dhe lihen për 2-3 orë derisa të marrin ngjyrë dhe aromë të njëjtë. Pastaj i shtohet uji dhe zihen në temperaturë të ulët. 3 minuta pas zierjes, hiqet nga zjarri dhe lihet të ftohet. Pas kësaj e kullojmë dhe e shërbejmë të ftohtë.

Sherbeti i manaferrës

Përmbajtja: 500 gr manaferra, 130 gr sheqer pluhur (100% sheqer panxhari), 1 lëvozhgë kanelle, 1 lt ujë.

Përgatitja: Pasi pastrohen manaferrat, përzihen me sheqer pluhuri dhe lihen në pritje për 2-3 orë. Pastaj i shtohet uji e kanella dhe vendosen në zjarr për t'u zier. Ziejnë për pesë minuta dhe hiqen nga zjarri. Pas kësaj, i kullojmë dhe lëngun e shërbejmë të ftohtë. Gjatë servirjes, sherbetit mund t'i hedhim edhe manaferra të freskëta.

Sherbet thanash

Përmbajtja: 500 gr thana, 300 gr sheqer pluhur (100% sheqer panxhari), 2 lugë çaji lëng limoni, 1 lt ujë.

Përgatitja: Lahen thanat dhe zihen në një tenxhere me gjysmën e ujit. Thanat e ziera i kalojmë në kullojë duke ua nxjerrë lëngun. Pjesën e ngelur të ujit e ziejmë me sheqer. Pasi uji me sheqer zien, i shtojmë edhe lëngun e thanave dhe i lëmë për pak kohë të ziejnë së bashku. Më vonë i shtojmë edhe lëngun e limonit. Pastaj e heqim nga zjarri dhe e lëmë të ftohet. Shërbehet i ftohtë.



Gështenja

DHE EFEKTET E SAJ

Janë një simbol i vetë vjeshtës: gështenjat janë shije e vërtetë dhe kanë shumë vlera të dobishme.

Njëherë e një kohë kanë qenë ushqim i të varfërve, por sot janë mjaft të çmuara dhe mund të shijohen në mënyra të ndryshme, të ziera, të pjekura, të thata apo dhe marmelatë.

Kush i konsumon është i sigurt për diçka: gështenjat na japin mjaft substanca të vlefshme që janë shumë të mira për ata që vuajnë nga sëmundjet e zorrëve, duke pasur parasysh se nuk ka fare gluten. Por nuk mbaron këtu, vlerat e tij janë të nevojshme dhe në kozmetike për bukurinë e lëkurës dhe flokëve.

Pikërisht pasuria e saj me antioksidantë i kthen këto fruta në aleatë të mirë të bukurisë. Për shebull, ekstrakti i gështenjave përdoret për të hidratuar lëkurën dhe për të riparuar dëmet e rrezeve

ultravjollcë. Vitamina C është e nevojshme për prodhimin e kolagenit, aleat i elasticitetit të lëkurës.

Ja se si mund ti përdorim gështenjat për bukurinë tonë të përditshme.


PËR FYTYRËN

Tuli i gështenjës ka fuqi zbutëse dhe është e nevojshme në përgatitjen e maskave për fytyrën, sidomos për ata që kanë lëkurë të yndyrshme. Mjafton të ziesh gështenjat dhe të nxjerrësh tulin. Mund të shtoni lëng portokalli për të fuqizuar vlerat zbutëse të maskës, apo qumësht dhe mjaltë për një efekt ushqyes, apo akoma më shumë kos natyral për të ndriçuar lëkurën.

PËR FLOKËT

Me lëvozhgën e gështenjës apo me ujin që i zieni mund të përgatisni një sasi uji që do e përdorni për





të shpëlarë flokët, për një flokë të shndritshëm dhe të butë. Por kujdes: trajtimi është i përshtatshëm për ata që kanë flokë të errët apo gështenjë pasi ajo jep një pasqyrim refleksi. Për femrat me flokë bionde apo ngjyrë të hapur përdorni më mirë një sasi lëngu duke zierë për 20 minuta gjethet e gështenjës,

filtroni më pas e përdorni për shpëlarje.

PËR TRUPIN

Me miellin e gështenjave, përzier me ujë termal, me disa pika vaj bajamesh apo me mjaltë, dhe mund të përgatisni një skrub që lë lëkurë të butë dhe të ndritshme.

Shega

Shega është një ndër frutat më të rrallë në tokë për nga vlerat që ka për shëndetin. Ajo është fryti “shërues” i pasur me antioksidantë, gjithmonë vlerësuar si simbol i shëndetit.

Shumë studime kanë vërtetuar që bëhet fjalë për një nga frutat më shëruese në botë për shkak të ndikimit të dobishëm në sistemin kardiovaskular, nervor dhe eshtëror, shkruajnë mediat. Është treguar që edhe doza ditore e ekstraktit të shegës nga i cili më së shpeshti konsumojmë çaj ose pekmez, mund të ndihmojë në uljen e tensionit të gjakut dhe nivelit të kolesterolit.

Shkencëtarët konsiderojnë që kjo mund të reduktojë rrezikun nga sëmundjet e zemrës te personat e trashë për 17 për qind. Përveç dobive për zemrën dhe enët e gjakut, përbërësit e shegës pengojnë rritjen e kancerit të gjirit, prostatës, zorrës së tra-

shë, leukemisë dhe parandalojnë ndryshimet të cilat nxisin rritjen e tumorit.

DOBITË:

Studimet shkencore të ditëve të sotme po hedhin dritë mbi të vërtetat; përse kjo bimë është bërë kaq e dashur deri mitike nga të gjithë popujt e botës!? Që në lashtësi, rreth 3000 vjet më parë, njerëzimi i ka pikasur cilësitë e veçanta të kësaj bime në drejtim të luftimit të sëmundjeve dhe përmirësimit të shëndetit njeriut.

Studime shkencore rreth përfitimeve mjekësore nga shega kanë qenë të pakta. Vitet e fundit këto studime janë intensifikuar, shumë shkencëtarë po kryejnë kërkime shkencore, të cilat janë në stadin e epruvetave, të provave në kafshë dhe pak aplikime janë bërë në njerëz.

Deri tani, shkencëtarët e mjekësisë moderne janë befasuar nga të dhënat e para që kanë zbuluar në drejtim të dobive shëndetësore për njeriun, dhe e kanë cilësuar si një bimë “çudibërëse”. Në kokrrat e shegës është zbuluar një lëndë që quhet punicalagins, një antioksidant që e përmban vetëm shega.

Qendrat shëndetësore prestigjioze në SHBA e rekomandojnë shegën dhe lëngun e saj për disa sëmundje:

1. Parandalimin e sëmundjeve të zemrës.
2. Parandalimin e Kancerit, veçanërisht kancerin e prostatës dhe të gjirit tek femrat.
3. Për uljen e kolesterolit në gjak.
4. Parandalon mbipeshën.
5. Lufton dëmtimin e qelizave; parandalon degradimin e ADN-së qelizore

NGROHJA GLOBALE MUND TË SHKAKTOJË ÇEKUILIBRIM TË KLIMËS

Shkencëtarët kanë paralajmëruar se Toka mund të përballet me një çekuilibrim të klimës në rast se rritja e mesatares së ngrohjes globale arrin në nivelin që shkakton çlirimin e rezervave kritike të karbonit.

Shkencëtarët nga Instituti “Stockholm Resilience Centre” kanë theksuar se nëse disa nga depozitat kritike të karbonit në tokë shpërndahen dhe në rast se karboni i ruajtur këtu përhapet në atmosferë, efekti “domino” që do të krijohet mund të tërheqë tokën në një mosbalancim të pakthyesëm klimaterik.

Shkencëtarët theksojnë se pyjet, oqeanet dhe toka absorbojnë 4,5 miliard tonë karbon dhe nëse kjo përhapet në atmosferë do ta kthente tokën në një “tokë serë”.

Në një botë të tillë, thuhet se temperaturat mesa-

tare mund të rriten me 4-5 gradë dhe niveli i detit mund të rritet me 10 deri në 60 metra.

Profesori për klimën që kryeson studimin, Johan Rockström, është shprehur se nëse rritja e temperaturës globale arrin 2 centigradë, ne i japim direkt planetit tonë mekanizmin tonë të kontrollit.

“Për momentin kemi kontrollin, por vetëm nëse tejkalojmë 2 gradë, bota nuk do të jetë më miqësore me ne, por do të bëhet një armik. Ne do ta kemi dorëzuar fatin tonë në duart e një planeti që ka filluar të humbasë ekuilibrin e tij”, theksoi Johan Rockström.

Rezultatet e studimit janë publikuar në revistën e Akademisë Amerikane të Shkencave “Proceedings of the National Academy of Sciences”.

VRIMA E OZONIT

Vrima e ozonit që hapet çdo vit mbi Antarktidë është duke shkuar rrugës që të bëhet më e vogla në tre dekadat e fundit, thonë shkencëtarët, shkruan Independent.

Megjithatë, ajo çfarë nuk është assesi të qartë është forma e saj e çuditshme – e cila po kthehet me shpejtësi kah Amerika e Jugut në vend që të përqendrohet te Poli i Jugut, transmeton Telegrafi.

Kjo formë e rrallë që nuk është vërejtur kurrë më parë, tregon shtrembërimin e vorbullës së zakonshme polare, që është përgjegjëse për ruajtjen e temperaturave të ulëta në stratosferë.

Vrima aktualisht është sa afro gjysma e madhësisë së saj që zakonisht duhet të jetë gjatë shtatorit, dhe ndoshta për këtë mund të ketë arritur tashmë madhësinë e saj maksimale, pak më e vogël sesa

vetë kontinenti i Antarktidës.

Ozoni është një molekulë që përbëhet nga tre atome të oksigjenit, dhe është përgjegjëse për filtrimin e rrezatimit të dëmshëm ultravjollcë nga dielli. Gazi krijohet nga dekompozimi në stratosferë, 20 deri në 30 kilometra mbi Tokë.

Në një atmosferë të pastër, cikli i prodhimit dhe dekompozimit është brenda ekuilibrit. Megjithatë, kimikatet që përmbajnë klor dhe brom e nxjerrin nga ekuilibri, duke rezultuar kështu një rënie të përqendrimeve të ozonit në unazën e Antarktikut gjatë shtatorit dhe tetorit.

Protokolli i Montrealit i nënshkruar në vitin 1987, tenton ta përmirësojë situatën duke ndaluar prodhimin dhe përdorimin e kimikateve që shkatërrojnë shtresën e ozonit.

Kushtet për dekompozimin e ozonit ndodhin çdo vit kur Antarktida del nga dimri, kurse reagimet nxiten nga rishfaqja e motit me diell në stratosferën e ftohtë.

Derisa procesi i tkurrjes këtë filloi më herët se zakonisht, atë e ka shkruar një ngjarje e papritur e nxehtësisë që ngriti temperaturën e stratosferës

nga 20 deri në 30 gradë.

“Herë pas herë në Antarktidë ka anomali, por askush nuk e di saktësisht se çfarë po e shkakton formën e pazakontë të vrimës së ozonit gjatë këtij viti. Sigurisht se është një fenomen i ri”, ka deklaruar Anna Jones.

ZBULOHET BAKTERI QË ASGJËSON PLASTIKËN

Shkencëtarët kanë zbuluar një enzimë natyrale që asgjëson plastikën, një ndër materialet më ndotës të planetit pasi nuk shpërbëhet lehtë. Enzima prodhohet nga një bakter që eksperimentet e fundit e kanë zhvilluar edhe në laborator, duke i dhënë shpresë industrisë së riciklimit.

Me plastikën, shkenca arriti të zhvillonte atë që u konsiderua si materiali i mrekullueshëm; tani një enzimë natyrore e përmirësuar mund të ndihmojë pastrimin e ndotjes së njerit prej llojeve më të vështira të saj.

Polietilen tereftalate, apo ndryshe PET, një lloj plastike e fortë e përdorur zakonisht për prodhimin e shisheve, kërkon vite të tëra që të shpërbehet në ambient.

Por një enzimë, e modifikuar aksidentalisht në laborator, mund ta shpërbejë këtë material brenda disa ditësh.

Një zhvillim i tillë premtan të revolucionarizojë procesin e riciklimit dhe të lejojë një ripërdorim më efikas të plastikës në të ardhmen. Enzima që ha plastikën është zbuluar fillimisht pak vite më parë në një qendër riciklimi në Japoni.

Tani, hulumtuesit e Universitetit Britanik të Portsmouthit, krijuan një model 3D të saj të definicionit të lartë, duke përdorur rreze të fuqishme X dhe sapo e kuptuan strukturën e enzimës, vunë re se mund t’ia përmirësonin performancën duke rregulluar vetëm disa mbetje në sipërfaqe.

Në këtë mënyrë krijuan një enzimë të re akoma edhe më efikase në shkatërrimin e plastikës PET. Rezultatet janë mahnitëse, megjithatë edhe sfidat që presin aplikimin e tyre në botën reale nuk janë të vogla.

Zhvillimi i një teknike për prodhimin e enzimës me çmim të ulët do të jetë një pengesë kryesore; një tjetër do të jetë shfrytëzimi i fuqisë së tij në një shkallë industriale.

Sipas një studimi trevjeçar të botuar në revistën Raportet Shkencore muajin e kaluar, një grumbull gjigant mbeturinash në Oqeanin Paqësor, i njohur si fasha e plehrave të paqësorit, po rritet më shpejt se sa pritej dhe tani është tre herë më e madhe se Franca, e më shumë se dyfishi i madhësisë së Teksasit.





Ju ofron:

Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

- 1 Staf arsimor cilësor
- 2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta
- 3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive
- 4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar
- 5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR
(djem dhe vajza)
1
NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Bindjuni Allahut
dhe të Dërguarit të Tij
dhe mos u grindni
ndërmjet jush,
sepse do të humbni
guximin e do t’ju
lërë fuqia.

Bëhuni të durueshëm,
se Allahu, me të vërtetë,
është me të durueshmit.”

(Enfal, 46)